

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS Numri i rastit 144/13

[Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë në formën së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm]

(HYRJJE)

Ky aktgjykim është i datës 21 shtator 2015.

AKTGJYKIM NË EMËR TË POPULLIT

Në bazë të neneve 359 *et seq.* të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPPK) *ex vi* neni 541, paragrafi (në tekstin e mëtejshëm, par.) 1, KPPK (KPPK i ri, që hyri në fuqi më 1 janar të vitit 2013, do të zbatohet për këtë rast, pasi që aktakuza e datës 05/11/2012 ishte ngritur më 13/11/2012, kjo sipas neni 541, par. 1, KPPK).

Seanca fillestare u mbajt më 28/03/2013 dhe më 18/06/2013, e kryesuar nga Jonathan Welford-Carroll, Gjyqtar i EULEX-it. Gjersa në seancën e parë ishin identifikuar të pandehurit dhe ishin trajtuar disa çështje administrative, në të dytën u diskutuan gjerësisht parashtresat e dorëzuara me shkrim në lidhje me provat, tabelat që sqaronin akuzat për secilin të pandehur, lidhjet e kodit të mëparshëm penal dhe me atë të riun dhe aktakuza e ndryshuar (e dorëzuar më 28/03/2013). Gjithashtu u diskutuan çështje procedurale, si nevoja për një ekspertizë lidhur me prokurimin, të pretenduar nga i pandehuri K. - për të cilën kundërshtoi i pandehuri Z.

Më 18/06/2013 u morën deklaratimet e të pandehurve dhe të gjithë u deklaruan të pafajshëm për secilën akuzë.

Më 17/10/2013 u lëshua një aktvendim në lidhje me çështjet në fjalë - përmbajtja e të cilit nuk është e nevojshme që të përsëritet tani.

Gjykata Themelore e Prishtinës në këtë rast ka një trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it Jorge Martins Ribeiro (si Kryetar i trupit gjykues) dhe Arkadiusz Sedek, së bashku me gjyqtarin kosovar Beqir Kalludra, me Driton Musliun, i caktuar si këshilltar ligjor në këtë rast. Gjyqtari ndërkombëtar Arkadiusz Sedek e zëvendësoi gjyqtarin tjetër ndërkombëtar, i cili ishte anëtar i trupit gjykues, Petar Stoitsev, që prej seances së mbajtur më 04 nëntor 2014. Në mbështetje të nenit 311, par. 1, KPPK, pas dëgjimit të palëve, u ra dakord nga të gjithë që provat që tashmë ishin paraqitur përgjatë seancave të mëparshme të merreshin si të lexuara, të administruara ose të shqyrtuara.

Siç u konstatua më parë, kjo gjykatë është kompetente për gjykimin e çështjes, sipas neneve 1, 2, par. 1.2, 9 par. 2.1, 15 par. 1.20 dhe 15, par. 2 i Ligjit për Gjykatat (L. 03 / L-199 që ishte në fuqi në kohën kur filluan procedurat) dhe sipas neneve 3, par. 1 dhe 7 (ky i fundit në lidhje me shumicën e Gjyqtarëve të EULEX-it) të Ligjit mbi juridiksionin, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (L. 03 / L-053 që ishte në fuqi në atë kohë) *ex vi*. Neni 442 KPK.

Ky rast penal (fillimisht PPS 30/10) është kundër të pandehurve N.K. (me numër të letërnjoftimit ...), A.Z. (me numër të letërnjoftimit ...), S.H. (me numër të letërnjoftimit ...), S.F. (me numër të letërnjoftimit) dhe H.B. (me numër të letërnjoftimit ...), të akuzuar fillimisht me një aktakuzë të datës 05/11/2012, të ngritur në gjykatë nga Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës, PSRK, Besim Kelmendi.

Më 28/03/2013 kjo aktakuzë u ndryshua në lidhje me dispozitat përkatëse të kodit penal që kishte hyrë në fuqi më 01/01/2013, pasi që PSRK-ja ishte i

mendimit se dispozitat e reja do të ishin më të favorshme për të pandehurit, duke deklaruar se "*(...) në vend të veprës penale të Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit në kundërshtim me nenin 339, paragrafi 3 lidhur me nenin 23 të (ish) Kodit Penal të Kosovës (KPK), ajo duhet të jetë - Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa në të gjitha rastet kur përmendet vepra penale Dhënia e ryshfetit sipas Nenit 344, paragrafi 1, të (ish) Kodit Penal të Kosovës, ajo duhet të jetë - Dhënia e ryshfetit nga neni 429, paragrafi 1, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës "*.

Akuzat më poshtë tashmë korrespondojnë me sqarimin e PSRK-së, të datës 14/04/2014, në lidhje me versionin anglisht të aktakuzës, duke pasur parasysh që në versionin fillestar të aktakuzës ku shkruhet "Shpërdorimi në detyrë, në shkelje të nenit 341, paragrafët 1 dhe 3, me nenin 23 të KPK-së ", ajo duhet të shkruhet - duke ndjekur versionin shqip -" Mashtrimi në detyrë, nga neni 341 (...) të KPK-së "Dhe gjithashtu përmbajnë ndryshimet e bëra, në atë kohë, nga Kryetari i trupit gjykues më 17/10/2013, në lidhje me dispozitat më të favorshme të aplikueshme për të dy veprat penale ("Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar ", tani Neni 422 , par. 1, dhe neni 31 i Kodit Penal të Kosovës, jo më neni 339, par. 3, dhe nenit 23 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, dhe "Dhënia e ryshfetit", tani Neni 429 i Kodit Penal të Kosovës , jo më Neni 344, par. 1, i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës), në abstrakt, pasi është mbajtur seanca fillestare. Ndryshimet e datës 29/10/2014, të bëra në përkthimin në gjuhën angleze të aktakuzës gjithmonë do të konsiderohen gjatë këtij aktgjykimi.

Në seancën e mbajtur më 17 prill 2015, gjatë fjalës përfundimtare, Prokuroria hodhi një nga akuzat (Mashtrimi në detyrë, në shkelje të nenit 341, paragrafët (në tekstin e mëtejme par) 1 dhe 3, në lidhje me nenin 23 të ish-Kodit Penal të Kosovës, KPK). Në fakt, dhe duke cituar prokurorin, "(...)ne veprimet e të akuzuarit N.K. , S.F. , A.Z., S.H. ekzistojnë elementet e veprës penale Shpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422, paragrafi 1 në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa nuk qëndrojnë elementet e veprës penale, Mashtrimi në detyrë, në shkelje të nenit 341 paragrafi 1 dhe 3 lidhur me nenin 23 të ish Kodit Penal të Kosovës (KPK), pasi që veprimet e të akuzuarit për Keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar i konsumojnë edhe veprimet e veprës penale të Mashtrimit në detyrë (...) ".

Në pajtim me nenin 52 të KPPK-së, "prokurori i shtetit mund të tërhiqet nga ndjekja deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor pranë gjykatës themelore (...)".

Prandaj, edhe kjo tërheqje nga ndjekja penale gjithmonë do të merret parasysh përgjatë këtij aktgjykimi.

Prandaj, secili nga të akuzuarit tani akuzohet me sa vijon:

1- N.K.:

- Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, të kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenet 422.1 i lexuar me nenin 31 KPK);
- Marrja e ryshfetit (në kundërshtim me nenin 343.1 i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës) dhe
- Lidhja e kontratave të dëmshme (në kundërshtim me nenin 237.1 dhe 2 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës).

2 - A.Z.:

- Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, të kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenet 422.1 i lexuar me nenin 31 KPK).

3- S.H.:

- Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, të kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenet 422.1 i lexuar me nenin 31 KPK)dhe
 - Marrja e ryshfetit (në kundërshtim me nenin 343.1 i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës) dhe
- ### **4 - S.F.:**

- Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, të kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenet 422.1 i lexuar me nenin 31 KPK)dhe
- Marrja e ryshfetit (në kundërshtim me nenin 343.1 i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës)

5 - H.B.:

- Dhënia e ryshfetit (në kundërshtim me nenin 429 të KPK-së) dhe
- Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi (në kundërshtim me nenin 236 1.2 dhe 2 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës)

Seancat e shqyrtimit gjyqësor, të hapura për publikun, u mbajtën më 14 prill 2014, 13, 14, 27 dhe 28 maj 2014, 04 dhe 05 qershor 2014, 16, 17 dhe 18 korrik 2014, 12, 26 dhe 30 shtator 2014, 4 nëntor 2014, 12 dhjetor 2014 05 dhe 23 janar

2015, 16 shkurt 2015, 17 prill 2015, 22 qershor 2015, 24 qershor 2015, 31 gusht 2015 dhe 17 shtator 2015, në prani të prokurorit të shtetit, Z. Besim Kelmendi dhe pas 31 gushtit 2015 Znj. Merita Bina Rugova, të pandehurit në fjalë dhe avokatët e tyre mbrojtës, Z. B.T.(për N.K.), Z. H.L.(për A.Z.n), Z. S.G. (për S.H.n), Z. D.R.(për S.F.n) dhe Z. A.A.(fillimisht GJ.D., për H.B.) dhe përfaqësuesi i të palës së dëmtuar , Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (kur ishte i pranishëm); në disa prej seancave ishin zëvendësuesit e mbrojtësve dhe ishin dorëzuar autorizimet e kërkuara.

Seancat e caktuara për datën 20 mars 2015 dhe 11 maj 2015 u desh të anulohen; e para, për shkak të grevës së gjyqtarëve vendës dhe e dyta, për shkak të festës së Ditës së Evropës (9 maj) në ditën e parë të punës pas saj (e hënë, 11 maj 2015).

Asnjë përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës nuk i ndoqi seancat, përveç asaj të datës 31 gusht 2015.

Trupi gjykues u këshillua dhe votoi më 17 dhe më 18 shtator 2015.

Këshillimi dhe votimi është bërë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 365 dhe nenet 470 deri në nenin 473 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

Gjykimi siç u shpall (është duke u) gojarisht në 21 shtator 2015, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 366 KPPK, në prani, domethënë, të Prokurorit të PSRK-së, të të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës, në bazë të dispozitave të përmendura më lart, të lexuara së bashku me nenin 470 *et seq.* KPPK.

(DISPOZITIV)

Më 21 shtator 2015, Gjykata Themelore e Prishtinës në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it Jorge Martins Ribeiro, si Kryetar i trupit gjykues, gjyqtari i EULEX-it Arkadiusz Sedek dhe Gjyqtari Beqir Kalludra, si

anëtarë të kolegjit, në çështjen penale P. Nr. 144/13 - PPS. Nr 30/2010 i ndjekur penalisht nga Prokurorët Special Z. Besim Kelmendi dhe, pas 31 gushtit 2015, nga Znj. Merita Bina Rugova, nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, shpall në publik si më poshtë:

NË EMËR TË POPULLIT

Të akuzuarit janë:

1-N.K.

2- A.Z.

3 - S.H.

4 - S.F.

5- H.B.

Të gjithë ata fillimisht të ngarkuar me një aktakuzë të datës 5 nëntor 2012, të paraqitur në Gjykatën Themelore të Prishtinës më 13 nëntor 2012, dhe me ndryshimin e aktakuzës të datës 28 mars 2013 dhe **tani të akuzuar për veprat penale në vijim** (tani sipas aktakuzës së ndryshuar dhe tërheqja nga ndjekja penale për një akuzë gjatë fjalës përfundimtare nga ana e Prokurorisë):

1- N.K.:

- Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, të kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenet 422, par. 1, e lexuar me nenin 31 KPK);
- Marrja e ryshfetit (në kundërshtim me nenin 343, par. 1 i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës) dhe

- Lidhja e kontratave të dëmshme (në kundërshtim me nenin 237, par.1 dhe 2 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës).

2 - A.Z.:

- Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, të kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenet 422, par. 1, e lexuar me nenin 31 KPK); **3- S.H.:**

- Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, të kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenet 422, par. 1, e lexuar me nenin 31 KPK);

- Marrja e ryshfetit (në kundërshtim me nenin 343, par. 1 i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës) **4 - S.F.:**

- Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, të kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenet 422, par. 1, e lexuar me nenin 31 KPK);

- Marrja e ryshfetit (në kundërshtim me nenin 343, par. 1 i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës) **5-H.B.:**

- Dhënia e ryshfetit (në kundërshtim me nenin 429 të KPK-së) dhe

- Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi (në kundërshtim me nenin 236 1.2 dhe 2 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës)

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, të hapura për publikun, më 14 prill 2014, 13, 14, 27 dhe 28 maj 2014, 04 dhe 05 qershor 2014, 16, 17 dhe 18 korrik 2014, 12, 26 dhe 30 shtator 2014, 04 nëntor 2014, 12 dhjetor 2014, 05 dhe 23 janar 2015, 16 shkurt 2015, 17 prill 2015, 22 qershor 2015 24 qershor 2015, 31 gusht 2015 dhe 17 shtator 2015, në prani të prokurorit të shtetit, Z. Besim Kelmendi dhe, pas 31 gushtit 2015, Znj. Merita Bina Rugova, të pandehurit në fjalë dhe avokatët e tyre mbrojtës, Z. B.T.(për N.K.n), Z. H.L.(për A.Z.n), Z. S.G. (për S.H.n), Z. D.R.(për S.F.n) dhe Z. A.A.(fillimisht Z. GJ.D., për H.B.) dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar , Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (kur ishte i pranishëm); dhe pas këshillimit dhe votimit nga ana e trupit gjykues të mbajtur më 17 dhe më 18 shtator 2015 (zyrtar për mbajtjen e procesverbalit gjatë seancës së këshillimit dhe votimit ishte caktuar A.Xh.).

Dhe në pajtim me nenet 359 deri në 366 dhe 370 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, në këtë 21 shtator të vitit 2015, në seancë të hapur dhe në praninë e të pandehurve, avokatëve mbrojtës, prokuroritë PSRK-së dhe palës së dëmtuar, nxjerr këtë

AKTGJYKIM

Deklaroj ndalesën absolute mbi ndjekjen penale në lidhje me veprën penale të dhënies së ryshfetit, në kundërshtim me nenin 429 KPK, me të cilën ka qenë i ngarkuar i pandehuri H.B. (**pika 2**). Ndalesa absolute mbi ndjekjen penale ka ndodhur tashmë në dy momente: më 15/09/2011 (në lidhje me ryshfetin e dyshuar për të bashkë-pandehurit N.K. dhe S.F. - do të thotë se ajo tashmë kishte ndodhur kur aktakuza e datës 05 / 11/2012 ishte paraqitur, më 13/11/2012) dhe më 31/12/2013 (në lidhje me ryshfetin e dyshuar për të bashkë-pandehurin S.H.).

Prandaj, në përputhje me nenet 362, par. 1, dhe 363, par. 1.3, KPPK, pasi që afati i parashkrimit ka skaduar shumë më herët, gjykata e hedh poshtë këtë akuzë në lidhje me veprën penale të dhënies së ryshfetit.

Dhe:

Në lidhje me akuzën 1, në përputhje me nenet 359, 361, 362, par. 1, 365, dhe 366, dhe 370, par. 3, KPPK, gjykata shpall **fajtorë** të pandehurit N.K., A.Z., S.H. dhe S.F. për Keqpërdorim të pozitës zyrtare apo autoritetit, të kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenet 422, paragrafi 1, i lexuar me nenin 31 të KPK-së), sepse¹ është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprime², me të cilat ata janë akuzuar, pra, është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit gjatë ekzekutimit të kontratës për projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës në parkun industrial në D. Nr. MTI /22/07/2005, që do të kryhej nga Kompania "E." në pronësi të H.B., më 25/07/2006 kanë lejuar një pagesë prej 135.278,20 euro për

¹Faktet në dispozitiv janë vetëm një pasqyre për të mundësuar që të kuptohet vendimi. ²

"Veprime" përfshin "veprime" dhe "mosveprime".

kompaninë "E.", që përfshinte 50.000 euro që nuk duhejt'iu paguheshin, pasi që kjo shumë e fundit tashmë ishte paguar paraprakisht më 07/06/2006, si pjesë e paradhënies në vlerë prej 140.689,62 eurosh, sipas dokumentit me titull "situacioni i pare avansuas" i datës 31/05/2006, paradhënie që ishte lejuar nga i pandehuri N.K. më 07/06/2006 dhe që në atë kohë ushtrues detyre i sekretarit të përhershëm ishte tashmë i pandehuri A.Z., i cili nuk e ka ndaluar atë. Në vend që të paguajnë 135.278,20 euro më 25/07/2006, 50.000 euro duhej të ishin zbritur prej saj. Në ekzekutimin e kësaj kontrate nuk ka mundur të ketë ndonjë paradhënie dhe për këtë arsye nuk asnjë paradhënie nuk mund të ishte bërë më parë, për shkak se kontrata, në kushtet e përgjithshme (në seksionin e pagesave, paragrafi 20) thotë se "shuma e paradhënies do të jetë 0% ". I pandehuri N.K., si XXX i departamentit të prokurimit e aprovoi këtë pagesë prej 135.278,20 euro më 25/07/2006, i pandehuri S.H. e aprovoi atë, si zyrtar certifikues gjithashtu më 25/07/2006 dhe i pandehuri A.Z., si ushtrues detyre i sekretarit të përhershëm, nuk e ndaloi pagesën, pavarësisht se në atë kohë ishte dokumenti para-ekzistues situacioni numër 33, gjithashtu i datës 21/07/2006, por e nënshkruar nga kompania mbikëqyrëse "N.", në të cilën është deklaruar qartë se 50.000 Euro duhej të zbriteshin. I pandehuri S.F., si shef i Divizionit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimin Rajonal, sipas kontratës ai e nënshkroi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë më 07/06/2004, gjithashtu nuk arriti për të mbikëqyrur procesin dhe punimet në lidhje me Parkun Industrial në D. dhe si një zyrtar i Ministrisë në fjalë, i përfshirë në Departamentin e Zhvillimit të Sektorit Privat, të cilës i përkiste projekti, dhe ashtu siç ishte paraparë në kontratë (neni 6, e drejta e inspektimeve dhe mbikëqyrjes së punimeve në Parkun Industrial në D.) nuk i ka kryer detyrat e tij udhëheqëse në projekt sipas kontratës së tij me Ministrinë, në lidhje me dokumentet që kanë të bëjnë me këtë pagesë, që ai nuk e ka ndaluar apo nuk ka raportuar në lidhje me të, pra duke e lejuar atë, pasi që ai ishte i ngarkuar edhe me mbikëqyrjen e projektit.

Duke vepruar siç u tha, ata e keqpërdorën pozitën e tyre zyrtare dhe e dëmtuan buxhetin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që tejkalon 2.500 euro dhe këto pagesa rezultuan në dobi pasurore që tejkalon 5.000 euro për kompaninë "E.". Pas një auditimi të brendshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, të kryer në vitin 2007 nga tani i pandehuri A.Z., operatorit ekonomik "E.", në pronësi të H.B., i ishte kërkuar që të kthejë shumën e lartpërmendur prej 50.000 Eurove,

nga të cilat deri më sot vetëm 5.000 euro janë kthyer nga i pandehuri H.B., më 10/04/2007.

Të pandehurit në atë kohë kanë mbajtur poste zyrtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe me veprimet e tyre të përbashkëta, veprimet dhe mosveprimet, ata i kanë shkelur detyrat e tyre dhe kanë kontribuar ndjeshëm në kryerjen e veprës penale. Në atë kohë të pandehurit u sollën në mënyrën e përshkruar më lart, ata ishin në gjendje për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tyre, të cilat ata i dëshironin, duke e ditur se veprimet e tyre ishin të ndaluara dhe të dënueshme me ligj.

Gjithashtu në lidhje me akuzën 1, dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fjalë, por tani të lexuara së bashku me nenet 359, 360, paragrafi 2, 361 dhe 363, par. 3, KPPK, gjykata konstaton se i pandehuri H.B. ka kryer një pjesë të veprave, me të cilat ai ishte ngarkuar, sepse është vërtetuar se i akuzuari, si pronar i kompanisë "E.", gjatë ekzekutimit të kontratës për projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës në parkun industrial në D. Nr. MTI /22/07/2005, në bashkëpunim dhe koordinim të paktën me tjetër të pandehur zyrtar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, i pandehuri N.K., si kreu i departamentit të prokurimit dhe nënshkrues i kontratës së datës 07/10/2005, dhe duke mos përjashtuar zyrtarë të tjerë në këtë Ministri, i pandehuri B. kishte paraqitur në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në emër të kompanisë së tij "E.", dokumente me logon dhe vulën e kësaj kompanie, dhe që mbante nënshkrimin e tij, dokumente që deklarorin fakte që nuk ishin të vërteta në lidhje me punët e kryera dhe koston e tyre, duke e ditur se përmbajtja e dokumenteve të paraqitura ishin e rreme, që nuk përputheshin me realitetin dhe do të përdorreshin në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për të mundësuar zyrtarisht pagesën e paradhënies dhe pagesa të tjera, duke përfshirë ato ku paradhënia do të kthehej me zbritje në këste, në lidhje me kontratën në fjalë për projektimin dhe ndërtimin e Parkut Industrial në D.. Gjegjesisht, i pandehuri

B. ka paraqitur në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dokumentet e mëposhtme:

A) – e datës 31/05/2006 "Situacioni i Pare Avansuas", duke deklaruar në rreshtin 6, sasia e punës së kryer në përputhje me këtë situacion: 156,321, 80 euro, në rreshtin e 7 zbritet në bazë të marrëveshjes: 15.632,18 euro, në rreshtin 9 për pagesën në përputhje me këtë situacion 140.689,62; **B)** "Situacioni I Pare 20/06", pa datë, nën pikat A, B, C puna në vlerë prej 116.339,26 euro plus 15% të taksave dhe shuma

totale e 135.278, 20Euro; C) – e datës 21/07/2006 "Situacioni i dyte 3/2006", "dokumenti 33", duke deklaruar në rreshtin 6 sasinë e punës së kryer në përputhje me këtë situacion: 150.309,11 euro, në rreshtin e 7 zbritet në bazë të marrëveshjes: 15.030,11 euro, në rreshtin e 8 për pagesë mbetet 135.278, 20 euro, në rreshtin 9 paradhënia 140.689,60 euro, në rreshtin 9A e zbritur nga situacioni i tanishëm 50.000 euro, në rreshtin 9B paradhënia që mbetet për t'u zbritur 90.689,60 Euro dhe në rreshtin e 10 për pagesën sipas këtij situacioni 85.278,20 euro dhe D) fatura 39/06, datë 21/07/2006, e përgatitur në një letër me "E." në krye të letrës, që mbante dy vula të "E."-t (një në krye dhe një në fund), ku deklaroheshn punimet në vlerë prej 127.762,74 euro, të shtuara nga tatimi 15% në vlerë prej 22.546,11 euro, në shumën e përgjithshme prej 150.309,11 euro, duke zbritur nga ajo 10% në vlerë prej 15.030,91 euro, dhe duke pretenduar për t'u paguar shuma totale prej 135.278,20 euro.

I pandehuri u soll në mënyrën e përshkruar më lart, edhe pse ai ishte në gjendje për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tij, të cilat ai i dëshironte, duke e ditur se veprimet e tij ishin të ndaluara dhe të dënueshme me ligj.

Në aktakuzë Prokuroria e akuzoi të pandehurin B. për Keqpërdorim të autorizimeve në ekonomi (në kundërshtim me nenin 236, paragrafët 1.2 dhe 2, të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës)), por ekziston një element përbërës në veprën penale, që nuk përputhet me faktet e vërtetuara ("**dhe në në këtë mënyrë ve në lajthim organet drejtuese brenda organizatës së biznesit ose personit juridik që të gabojë në vendimmarrje**", - **thexsimi i shtuar**) dhe për këtë arsye vepra penale në fjalë nuk është ajo që është kryer, duke pasur parasysh se këto dokumente të falsifikuara nuk ishin ato që çuan (ose për të thënë më mirë, që "vënë në lajthim") në pagesat; më tepër dokumentet ishin vetëm mjetet e nevojshme për t'i dhënë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (dhe më vonë Ministrisë së Financave) një pamje se pagesat ishin të ligjshme, në përputhje me ligjet në fuqi dhe posaçërisht në përputhje me kontratën - me të cilin pagesa e paradhënies nuk u lejua, pas që përqindja për të ishte 0%.

Prandaj, për shkak të mungesës së një prej elementëve të veprës penale përbërëse të "Keqpërdorimit të autorizimeve ne ekonomi", gjykata rikualifikon (neni 360, par. 2 KPPK, "*Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës*) aktet e kryera nga i pandehuri H.B. në lidhje me veprën penale të falsifikimit të dokumenteve-në pajtim me nenin 332,

par. 1, i KPPK, *"Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal dënohet me gjobë apo burgim deri në një vit "(ligji i ri nuk është më i favorshëm, pasi sanksioni i paraparë është tani një" gjobë ose me burgim deri në tre vjet "*, neni 398 i KPK).

Pasi që kemi arritur në këtë fazë, dhe në pajtim me nenin 90, par. 1, nënparagrafi 6 i KPPK- së, ne shohim se afati i parashkrimit është 2 vite dhe ndalesa absolute mbi ndjekjen e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve është 4 vjet, sipas nenit 91, par. 6. KPPK (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës) dhe një afat i tillë prej 4 viteve ka kaluar tashmë (më 21/07/2010), ndërsa dokumenti i fundit i dokumenteve të përmendura më sipër² është i datës 21/07/2006; ky afat kishte kaluar edhe para dates, në të cilën prokurori e lëshoi aktvendimin për fillimin e hetimeve, 10/12/2011.

Prandaj, në përputhje me rrethanat, në bazë të nenit 363, par. 1.3, KPPK, **gjykata e hedh poshtë këtë akuzë.**

Në lidhje me akuzën 2, sipas neneve 359, 361, 362, par. 1, 364, par. 1.1.3, dhe 370, par. 3, KPPK, gjykata i shpall **të pafajshëm** të pandehurit N.K., S.H. dhe S.F. për veprën penale të marrjes së ryshfetit (në kundërshtim me nenin 343, paragrafi 1, të KPK-së Përkohshme), për shkak se nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se këta të akuzuar kanë kryer veprat, për të cilat ata janë akuzuar, pra, nuk është vërtetuar se³ "nga 14.09.2005, kur komisioni i vlerësimit e bëri raportin mbi vlerësimin dhe rekomandimin e ofertave për dhënien e kontratës në lidhje me tenderin për ndërtimin e infrastrukturës në pjesën industriale në D. Nr.MTI / 22/07/2005, pas së cilës kompanisë "E." - kompani në pronë të H.B.– iu është dhënë kontrata dhe deri në përfundimin e punëve të kontraktuara nga kjo kompani më 31.12.2007, të pandehurit N.K., si një person zyrtar - Drejtor i

² Ne i përmendem vetëm këto dokumente, pasi që gjykata nuk duhet të shkojë përtej aktakuzës, neni 360, par. 1 KPPK *"Aktgjykimi mund t'i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor.*

³ Ne këtu rast faktet do të kopjohen drejtperdrejte nga përkohshmi i tyre në aktakuzë

Departamentit të Prokurimit - dhe S.F., si një person zyrtar - XXX i Sektorit për Bizneset dhe Zhvillim Rajonal – të dy në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, duke vepruar në bashkërendim dhe bashkëpunim me njëri me tjetrin, kanë marrë ryshfet nga i pandehuri H.B., në mënyrë që të mos i kryenin detyrat zyrtare, që ata ishin të obliguar t'i kryenin, ndërsa i pandehuri H.B., si pronar i kompanisë "E.", i dha ryshfet të pandehurve N.K. dhe S.F. në këtë mënyrë: një ditë pas përfundimit të vlerësimit të ofertave dhe rekomandimeve për dhënien e kontratës për ndërtimin e infrastrukturës së parkut industrial në D., e ftoi të pandehurin H.B. në restorantin "T." në P.. Aty ishin të pranishëm edhe i pandehuri tjetër, S.F., si dhe dëshmitari H.Z. Ai e informoi atë se kompania e tij "E." e kishte fituar tenderin në fjalë. Megjithatë, në mënyrë që të vazhdojë me kryerjen e punimeve, ai i kishte thënë H.t se ky i fundit duhet t'ua jep atyre 180.000 euro, për të cilën shumë H. kishte rënë dakord që ose t'ia jepte S.F.t ose dëshmitarit Haki Zabërgja në këtë mënyrë: brenda dy ditëve, shumë prej 130.000 eurove, ndërsa shumën e mbetur gjatë pagesave të tjera. Dhe, sipas kësaj marrëveshjeje, H.B., përmes punëtorit të tij Y.C., po në të njëjtën ditë, ia kishte dërguar N. shumë prej 100.000 eurove në P. në vendin e quajtur "K.". Paratë ishin futur brenda një qese plastike të zezë dhe Y.C. nuk e dinte se çfarë kishte aty. Shumën tjetër prej 35,000 eurove H. ia kishte dhënë personalisht N. në "A.B." që gjendet në autostraden Prishtinë-Pejë në S. dhe gjatë kryerjes së punimeve shumë prej 45.000 eurove në Hotel "P." në M., në prani të shoferit të kompanisë "E.", A.SH.. Shumën e fundit duhej ta merrte S.F., por ishte vetë N.K., i cili shkoi për t'i marrë paratë. H.B. ia dha personalisht S.F.t 50,000 euro në restorantin "Q. e Ll." që gjendet në hyrje të P., pranë shtëpisë së S.F.t. Pra, gjithsej i pandehuri H.B. i dha si ryshfet shumë në vijim: N.K.t një shumë të përgjithshme prej 180,000 Eurove; dhe të pandehurit S.F. shumë prej 50.000 eurove. Po kështu, i pandehuri S.H., duke vepruar në cilësinë e një zyrtari financiar ka marrë një ryshfet nga H.B. në mënyrë që të mos kryejë detyrat zyrtare, për të cilën ai ishte i obliguar t'i përmbushte, në mënyrën si mëposhtë: nga fundi i vitit 2007, S.H. i bëri një thirrje telefonike H.B. dhe i tha: "A doni që t'ua transferoj të gjitha paratë", dhe pasi që i pandehuri H.B. tha se kjo nuk ishte e mundur, S.H. iu përgjigj "Kjo është e mundur, por ju duhet të m'i jepni 3000 euro". H.B. i tha atij se ky nuk ishte një problem. S.H. shkoi në zyrën e H.B. në parkun industrial dhe i kishte marrë 3,000 euro. S.H. pastaj ia transferoi të gjitha paratë H.B. ".

Në lidhje me akuzën 3, në bazë të neneve 359, 361, 362, par. 1, 365, dhe 370, par. 3 dhe 4, KPPK, por tani lexohet së bashku me nenin 360, paragrafi 2,

KPPK, gjykata e shpall **fajtor** të pandehurin N.K. pas rikualifikimit (sipas Nenit 360, par. 2, KPPK) të fakteve të vërtetuara, pasi që faktet e vërtetuara, në lidhje me çfarëdo lartësie të dëmit, nuk përputhen me të gjitha elementet që janë përbërëse të veprës penale të lidhjes së kontratave të dëmshme (në kundërshtim me nenin 237.1 dhe 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, sipas të cilit "*kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet*"), por janë përbërëse të veprës më të butë penale keqpërdorim të pozitës zyrtare ose autorizimit, në kundërshtim me nenin 422, paragrafi 1 dhe par. 2.1, KPK, sepse është vërtetuar se i akuzuari ka kryer një pjesë të veprave, me të cilat ai ka qenë i ngarkuar, që do të thotë se është vërtetuar se⁴ pas shpalljes së tenderit në 22/07/2005 për "Projektimi dhe ndërtimi i infrastrukturës së Parkut Industrial në D. ishin vlerësuar ofertat për "Projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së Parkut Industrial në D." dhe ishte zgjedhur Kompania "E.", më 07/10/2005 ishte nënshkruar kontrata për projektin dhe ndërtimin e infrastrukturës së Parkut Industrial në D., në mes të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Kompanisë "E.", e përfaqësuar nga H.B., në vlerë prej 144.000 euro / çmimi për njësi 69.825,25 Euro (pa përmendur numrin e njërive). Pa ndonjë tender tjetër, kjo kontratë u ndryshua me anë të aneks kontratës së parë të datës 20/07/2006, në mes të Kompanisë "E." dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, të nënshkruar nga të pandehurit N.K. në emër të Ministrisë, në të cilën thuhet: "Duke pasur parasysh se palët e përmendura më lart kanë lidhur një kontratë për kryerjen e punimeve në projektin Parku Industrial në D., (...) Duke u bazuar në punimet e kryera nga kontraktori dhe kërkesës së tij në ndryshimin e kushteve të pagesës dhe me miratimin nga MTI-ja, ku palët bien dakord për të ndryshuar reciprokisht kushtet e pagesës (...), Kanë rënë dakord si më poshtë: (...) Neni 1 (në lidhje me ndryshimin e klauzolave 17.3 deri në 17.5), nenin 2 (rreth pagesave të bëra sipas "situacioneve") (...) Neni 4: Vlera e përgjithshme e kontratës do të jetë 1.730.000 euro (...) "Pas këtij ndryshimi të kontratës përmes aneks kontratës në fjalë të datës 20/07/2006, u lidh një aneks kontratë tjetër në mes të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, të nënshkruar përsëri nga i pandehuri N.K., dhe Kompania "E.", e përfaqësuar nga ... i saj, H.B., më 28/09/2006, ku thuhet: "Duke pasur parasysh se palët e përmendura më lart kanë lidhur një kontratë për kryerjen e punimeve në projektin Parku Industrial në D., duke u bazuar në punimet e kryera që erdhën pas miratimit të kërkesës për procedurë të negociuar para shpalljes së kontratës në APP, ne lidhim këtë aneks kontratë (...) Neni 1: Kontrata

⁴ Faktet në dispozitiv janë vetëm nje pasqyre për të mundësuar që të kuptohet ky vendim.

originale, datë 07/10/2005 si marrëveshje e përbashkët mes palëve, vlera e përgjithshme e të cilave është 1.730.000 euro (...) Neni 2 Vlera e përgjithshme e aneks kontratës duhet të jetë 14.580,00 euro (...). "Pavarësisht se shuma e kontratës fillestare datë 07/10/ 2005 u ndryshua vetëm me aneks kontratën e parë (neni 4 i atij aneksi), i datës 20/07/2006, një muaj më herët, më 20/06/2006 i pandehuri N.K. tashmë e kishte dorëzuar në Agjencinë e Prokurimit Publik, në bazë të Neni 34, par. 3 (mes tjerash), të Ligjit mbi Prokurimin 2003/17, një kërkesë që të përdorë procedurat e kufizuara ose të negociuara për punë shtesë, duke thënë: "vlera e përafërt e kontratës: 1.700.000 euro, vlera e parashikuar: vlerën e punëve shtesë: 14.580 euro" , kur në atë kohë (më 20/06/2006) shuma e kontratës e datës 07/10/2005 (kontrata e vetme ekzistuese) ishte 144.000 Euro / çmimi për njësi 69.825,25 Euro, jo 1.700.000 euro.

Në atë kohë i pandehuri u soll në mënyrën e përshkruar më lart, ai ishte në gjendje për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tij, të cilën ai i dëshironte, duke e ditur se veprimet e tij ishin të ndaluara dhe të dënueshme me ligj. Duke vepruar siç u përshkrua, ai e keqpërdori pozitën e tij zyrtare.

Për sa më sipër Gjykata shqipton si në vijim Dënimi:

Akuza 1 (të pandehurit N.K., A.Z., S.H. dhe S.F.): Keqpërdorim i pozitës zyrtare nga neni 422 të KPK-së, i lexuar së bashku me nenet 3, par. 2, dhe 31 të KPK-së, në lidhje me nenet 41, 45, 50, 51, 52 (nëse pezullohet) dhe 73 të KPK-së

Gjykata shqipton dënimet e mëposhtme të burgimit:

N.K.: 12 muaj burgim.

A.Z.: 10 muaj burgim.

S.H.: 8 muaj burgim.

S.F.: 7 muaj burgim.

Akuza 3 (I pandehuri N.K.):

N.K.: Keqpërdorim i detyrës zyrtare nga neni 422 të KPK-së, i lexuar së bashku me nenet 3, par. 2, dhe 31 të KPK-së, në lidhje me nenet 41, 45, dhe 73 të KPK-së.

Gjykata shqipton dënimin me burgim si në vijim: 1 vit e 6 muaj (18 muaj) burgim.

Dënimi unik me burgim i të pandehurit N.K.

Sipas neni 80, par. 2. 2. KPK, në mes të minimumit prej 18 muajve burgim dhe maksimumit prej 30 (12 + 18) muajve burgim është vendosur në 26 muaj burgim për kryerjen e dy veprave penale të Keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit, në pajtim me nenin 422 KPK.

Pezullimi i sanksioneve të burgimit të shqiptuara ndaj të pandehurve A.Z., S.H. dhe S.F.:

Në bazë të neni 52, paragrafi 2, të KPK-së, dënimet nuk do të ekzekutohen, nëse personat e dënuar nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit dhe gjykata e cakton periudhën e verifikimit në 2 vjet për të pandehurit A.Z., S.H. dhe S.F..

Sipas neneve 52, par. 3, dhe 59 të KPK-së, pezullimi përfshin gjithashtu detyrimi për mosndryshimin e vendbanimit pa e informuar shërbimin sprovues.

Dënimi (dënimet) plotësuese

Në lidhje me një dënim plotësues për të pandehurin N.K. (dënimi i të cilit nuk është pezulluar), gjykata vendosi të mos shqiptojë dënimin plotësues të paraparë në nenin 62, par. 2.1, i lexuar së bashku me nenin 65 KPK. *"Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik"*.

Konfiskimi i objekteve: Në aktakuzë nuk përmenden objekte që do t'i nënshtrohen konfiskimit.

Kërkesa pasurore juridike: Prona e kërkuar, kompensimi për dëmet, e paraqitur në Gjykatë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë më 22 maj 2012 refuzohet, pasi që në atë datë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ishte tashmë e informuar lidhur me vendimin e marrë në lëndën me numër 164 / 2008, me vendim të datës 04/05/2011, në të cilin Gjykata Supreme e Kosovës e refuzoi si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe e konfirmoi vendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut të Prishtinës, numri i rastit 272/2007, datë 18/06/2008, në të cilën paditës ishte gjithashtu Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në Prishtinë, kundër të paditurit NNP "E." dhe gjykata ka vendosur në favor të paditësit dhe si pasojë i padituri u dënua që t'ia kthente paditësit shumën prej 45.000,00 eurove me interes vjetor prej 2,5%, duke filluar nga 19/04/2007 deri në pagesën përfundimtare në afat prej 8 ditësh, nga dita kur Aktgjykimi të merrte formën e prerë (04 / 05/2011); nëse nuk do të arrinte ta bënte këtë, atëherë do të bëhej ekzekutimi me dhunë.

Shuma është e njëjtë dhe tani është çështje e ekzekutimit të Aktgjykimit civil të formës së prerë, pas që ai nuk mund t'i nënshtrohet një vendimi tjetër.

Shpenzimet e procedurës penale: Në bazë të nenit 450 KPPK.) do të paguhet nga të pandehurit, të cilët janë dënuar. Në bazë të nenit 450, par. 2.6, shuma paushalle është 150 Euro për secilin nga të pandehurit, në vlerë të përgjithshme prej 600 euro.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare, nuk sheh ndonjë nevojë për shpalljen e këtij aktgjykimi (dispozitivi) në shtyp, në radio apo televizion, neni 365, par. 1.1.6, KPPK, për të mbrojtur vlerat e Drejtësisë dhe të Interesit Publik.

Mjeti juridik: Në mbështetje të neneve 374, par. 1.1, dhe 380, par. 1, ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet brenda 15 ditëve nga dita që kopja e tij i është dorëzuar palëve. Ankesa duhet t'i drejtohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës.

ARSYETIMI

A) Trupi Gjykses dhe kompetenca:

Palët nuk paraqitën asnjë kundërshtim lidhur me përbërjen e trupit gjykses. Me ndryshimin e një anëtari të trupit gjykses të gjitha palët kanë rënë dakord që t'i konsiderojnë të gjitha dëshmitë që janë paraqitur gjer më tani " si të lexuara dhe të administruara". Kjo Gjykatë është kompetente për gjykimin e çështjes, në përputhje me nenet 1, 2 nënparagrafi 1.2, 9, nënparagrafi 2.1, 15 par. 1.20 dhe 15, par. 2, i Ligjit për Gjykatat - L. 03 / L-199 që ishte në fuqi në kohën kur kishin filluar procedurat [Gjykata Themelore do të jetë gjykata e shkallës së parë në Republikën e Kosovës, në këtë rast (paragrafi 2.). Gjykata Themelore e Prishtinës është gjykata me juridiksionin territorial dhe në përputhje me nenin 11, par. 1, i të njëjtit ligj, Gjykata Themelore është kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha rastet, përveç nëse ligji e parasheh ndryshe - dhe sipas neneve 3, paragrafët 1 dhe 7 (ky i fundit në lidhje me shumicën e gjyqtarëve të EULEX-it) të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (L. 03 / L-053 siç ishte në fuqi në atë kohë), *ex vi* Neni 442 KPK.

B) Historia e procedurës:

B.1-Ky rast penal (fillimisht PPS 30/10) është tani kundër të pandehurve N.K., (me numër të letërnjoftimit ...), A.Z. (me numër të letërnjoftimit ...), S.H. (me numër të letërnjoftimit 1003446243), S.F. (me numër të letërnjoftimit ...) dhe H.B. (me numër të letërnjoftimit ...) dhe hetimet kundër të pandehurve filluan më 05/04 /

2008, kur Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës kishte paraqitur në PSRK një informacion në lidhje me sjelljen e mundshme korruptive kundër të dyshuarve B.D., B.Z. dhe N.K..

B.2 – Më 15/11/2008 Policia e Kosovës dorëzoi në Prokurori një kallëzim penal, "2011-XI-248", kundër të pandehurve N.K., A.Z., S.H., S.F. dhe H.B., për dyshim të bazuar se kanë kryer vepra penale.

B.3 - Më 10/12/2011⁵ Prokurori Besim Kelmendi lëshoi një vendim për të filluar hetimet kundër të pandehurve të përmendur më lart, N.K., A.Z., S.F., S.H. dhe H.B., për veprat penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autoritetit, neni 339, par. 3, i lexuar me nenin 23 të KPK-së; përvetësimi në detyrë, neni 340, par. 3, i lexuar me nenin 23 të KPK- së; mashtrimi në detyrë, neni 341, par.1 dhe 3, i lexuar me nenin 23 të KPK-së, ndërsa në 21/05/2012 lëshoi një vendim për zgjerimin e hetimeve ndaj të pandehurve, N.K. dhe S.F. për të përfshirë veprën penale të marrjes së ryshfetit, nga neni 343, par. 1, të KPK-së, dhe kundër H.B. për të përfshirë veprën penale të dhënies së ryshfetit, nga neni 344, par. 1, i KPK- së. Më 20/07/2012 një vendim tjetër ishte lëshuar për të zgjeruar hetimet kundër N.K.t, për lidhjen e një kontrate të dëmshme, nga neni 237, paragrafi 2., i lexuar me par. 1. të KPK-së, dhe kundër H.B. për keqpërdorim të autorizimeve në ekonomi, nga neni 236, par. 1, nënparagrafi 2, dhe par. 2, i KPK- së.

B.4-Të pandehurit u akuzuan fillimisht nga një aktakuzë e datës 05/ 11 / 2012 e ngritur në gjykatë nga Prokurori i përmendur i Shtetit të Republikës së Kosovës - PSRK-ja më 13 nëntor 2012, dhe më 28/03/2013, kjo aktakuzë ishte ndryshuar në lidhje me dispozitat përkatëse të kodit penal, që kishte hyrë në fuqi në ndërkohë, më 01/01/2013, pasi që PSRK-ja ishte i mendimit se disa prej dispozitave të reja do të jenë më të favorshme për të pandehurit (siç është shpjeguar tashmë në detaje në fillim).

B.5- Seanca fillestare u mbajt më 28/03/2013 dhe më 18/06/2013 - në të cilën ditë të pandehurit e paraqitën mbrojtjen e tyre dhe të gjithë u deklaruan të pafajshëm për secilën akuzë. Më 17/10/2013 u lëshua një vendim për çështjet e adresuara në ato data të mëparshme - përmbajtja e të cilave nuk është e nevojshme që të përsëritet tani (por tashmë kjo u përmend më herët).

⁵ Jo 2012, sic është përmendur gabimisht në arsyetimin e aktakuzes.

B.6 - Seancat e shqyrtimit gjyqësor, të hapura për publikun, u mbajtën më 14 prill 2014, 13, 14, 27 dhe 28 maj 2014, 04 dhe 05 qershor të vitit 2014, 16, 17 dhe 18 Korrik 2014, 12, 26 dhe 30 shtator 2014, 04 nëntor 2014, 12 dhjetor 2014, 05 dhe 23 Janar 2015, 16 shkurt 2015, 17 prill 2015, 22 qershor, 2015, 24 qershor 2015, 31 gusht 2015 dhe 17 shtator 2015, në prani të prokurorit të shtetit, Z. Besim Kelmendi, të pandehurit në fjalë dhe avokatët e tyre mbrojtës, B.T.(për N.K.n), H.L.(për A.Z.n), S.G. (për S.H.n), D.R.(për S.F.n) dhe Z. A.A.(fillimisht GJ.D., për H.B.); në disa prej seancave ishin zëvendësuesit e mbrojtësve, por ishin paraqitur autorizimet e duhura.

B.7- Nuk ka kërkesë pasurore juridike dhe asnjë përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës nuk ka marrë pjesë në seanca.

B.8 – Trupi gjykues u këshillua dhe votoi më 17 dhe 18 shtator 2015.

C) Arsyetimi sipas neneve 364, 365 dhe 370 KPPK-së:

C1) –Faktet e vërtetuara, të cilat janë relevante për vendimin:

Akuza 1

C.1.1 - Më 21/07/2005 N.G.(si XXX i Departamentit për Zhvillimin e Sektorit Privat) iu drejtua N.K.t (si XXX i Departamentit të Prokurimit) që të shpallë, në pajtim me ligjin për prokurimin, një tender ndërkombëtar për projektimin dhe të ndërtimin e infrastrukturës fizike të parkut industrial në D. (dokumenti në shkresat e lëndës, dëshmia 40/1).

C.1.2 - Më 21/07/2005 S.F. (XXX i Divizionit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimit Rajonal, sipas kontratës që ai e nënshkroi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë më 07/06/2004, i përfshirë në Departamentin e Zhvillimit të Sektorit Privat) i bëri një kërkesë M. B. (si XXX e departamentit të financave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë) për zotimin e fondeve për ndërtimin e këtij parku industrial në D., kërkesë në shumën prej 400.000⁶ euro (dokumenti në shkresate lëndës, dëshmia 41/2).

⁶ Me vone e beri nje tjetër, sic do ta shohim.

C.1.3- Pas kësaj kërkesë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nisi projektin "Parku Industrial në D." Projekti Nr. MTI / 22/07/2005.

C.1.3.1. - Njoftimi në gazeta, i datës 22/07/2005, për tenderin në fjalë në titull thotë (titulli i kontratës, nga autoriteti kontraktues - Qeveria): "Projektimi dhe ndërtimi i infrastrukturës së Parkut Industrial në D. "(dokumenti në shkresat e lëndës, dëshmia 43/2).

C.1.4 - Më 12/09/2005 N.K. i dërgoi sekretarit të përhershëm, në atë kohë S.A., një propozim se kush duhej të ishin anëtarë të komisionit për vlerësimin e ofertave në projektin në fjalë; propozim i tillë ishte si vijon: N.G. (XXX), B.Z., RR.Q. H.Q. dhe S.A. (anëtarë) dhe, si vëzhgues, A.B. (edhe këshilltar i ministrit në atë kohë), S.SH., Y.M. dhe R.H. (dokumenti në shkresat e lëndës, dëshmia 47/1).

C.1.5 - Më 12/09/2005 N.K. i dërgoi gjithashtu një propozim sekretarit të përhershëm, në atë kohë S.A., se kush duhej të ishin anëtarët e komisionit që duhet të bënin hapjen e ofertave: S.F., H.K. dhe G.B. (dokumenti në shkresat e lëndës, dëshmia 45/3).

C.1.6- Më 12/09/2005 kompania "E.", në pronësi të H.B., ofroi ofertën e saj në procedurën e prokurimit në fjalë të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në lidhje me projektimin dhe ndërtimin e parkut industrial në D. (e dokumentuar me dëshminë 46/2).

C.1.7- Më 14/09/2005 komisioni vlerësues e bëri raportin e saj lidhur me ofertat (kopje e së cilës gjendet në shkresat e lëndës, si një tabelë në të cilën "E." shfaqet në vendin e fundit, në faqen 2 të tabelës) dhe e bëri rekomandimin e saj se kujt duhej t'i jepej tenderi, cila ofertë ishte fituese; raporti përfundimtar i vlerësimit, duke e caktuar kompaninë "E." si kompaninë fituese, rekomandimi është nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe vëzhguesit, përpos RR.Q., dhe dokumenti, në fund, u nënshkrua edhe nga N.K., si udhëheqës i departamentit të prokurimit (e dokumentuar me dëshminë 48/7).

C.1.8 - Më 07/10/2005 fitues u shpall zyrtarisht Kompania "E." (e dokumentuar me dëshmi 42/1).

C.1.9 - Gjithashtu më 07/10/2005 u nënshkrua kontrata për projektin dhe ndërtimin e infrastrukturës së parkut industrial në D., në mes të Ministrisë së

Tregtisë dhe Industrisë dhe Kompanisë "E.", e përfaqësuar nga H.B. (e dokumentuar në shkresat e lëndës si "Marrëveshja bazë" ose "Kontrata bazë") në vlerë prej 144.000 euro dhe 69.825,25 euro çmimi për njësi, pavarësisht se kontrata nuk ka asnjë referencë për numrin e njërive dhe në pikën 6 të nenit 4 thuhet " kjo do të jetë një kontratë e bazuar në çmimin për njësi dhe çmimit të ofruar për projektin/ kontratë me para në dorë (...) ".

C.1.10 - Gjatë kryerjes së punimeve në ndërtimin e projektit "Parku Industrial në D.", i pandehuri S.F. ishte në cilësinë e ushtruesit të detyrës të Shefit të Divizionit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimit Rajonal, i përfshirë në Departamentin e Zhvillimit të Sektorit Privat , i pandehuri N.K. ishte XXX i departamentit të prokurimit, i pandehuri A.Z. ishte ushtrues detyre sekretart tëi përgjithshëm që nga 18 maji 2006 deri më 27 nëntor 2006 dhe S.H. ishte zyrtar financiar, me kompetenca të ndryshme.

C.1.11- Kompania "N.", e cila kishte lidhur një kontratë me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë më 24/05/2006, do të mbikëqyrte punimet të kryera nga "E.", në lidhje me përputhshmërinë e punëve me projektin dhe kontratën e nënshkruar në mes të "E." dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për ndërtimin e Parkut Industrial në D..

C.1.12 - Kompania "N." gjithashtu lidhi një kontratë të mbikëqyrjes, drejtpërdrejt me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

C.1.13 - Sipas kontratës (bazë) të datës 7 tetor 2005, në mes të "E." dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe në lidhje me pagesat, në kushtet e përgjithshme të kontratës, në seksionin e pagesave, paragrafi 20, thuhet: "shuma e pagesës së paradhënies do të jetë 0%" dhe në paragrafin 21 thuhet: "Shuma e parave që do të ndalen do të jetë 10% për çdo pagesë ndaj kontraktorit" kjo e fundit si një garanci.

C.1.14 - H.B. ia paraqit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në emër të kompanisë së tij "E.", dokumente me logon dhe vulën e kësaj kompanie, dhe që përmbanin nënshkrimin e tij, dokumente që tregonin fakte që nuk ishin të vërteta lidhur me punët e kryera dhe koston e tyre, duke e ditur se përmbajtja e dokumenteve të paraqitura ishin e rreme që nuk përputheshin me realitetin dhe se këto dokumente do të përdorreshin nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për të

mundësuar zyrtarisht pagesën e paradhënies dhe kthimi i borxhit në këste, pavarësisht se kontrata ndalonte çfarëdo paradhënie.

C.1.14.1 - Paradhënia në vlerë prej 140.689,62 euro, lidhur me dokumentin e titulluar "Situacioni i Pare Avansuas" (datë 31/05/2006), u bë më 07/06 /2006⁷ dhe u miratua ("Nëpunësi Aprovues") nga tani i pandehuri N.K., si drejtor i departamentit të prokurimit 07/06/2006 dhe kjo pagesë nuk u ndalua nga ushtruesi i detyres i sekretarit të përhershëm që vepronte në atë kohë, tani i pandehuri A.Z.. Zyrtari certifikues në një pagese të tillë ishte tani dëshmitarja B.S.⁸.

C.1.14.2 – Pagesa e borxhit të paradhënies për kompaninë "E.", në pronësi të H.B., do të ndodhte përmes zbritjes së shumës së saj në këste dhe këstet e tilla do të zbriteshin në pagesat pasuese.

C.1.14.3 – Që do të thotë, i pandehuri H.B. i kishte paraqitur keto dokumente të rreme:

A) – e datës 31/05/2006 "Situacioni i Pare Avansuas", duke deklaruar në rreshtin 6, sasia e punës së kryer në përputhje me këtë situacion: 156,321, 80 euro, në rreshtin e 7 zbritet në bazë të marrëveshjes: 15.632,18 euro, në rreshtin 9 për pagesën në përputhje me këtë situacion 140.689,62, duke e ditur se kjo ishte e rreme pasi që kjo sasi përputhej me një paradhënie dhe jo për punën e kryer.

B) "Situacioni I Pare 20/06", pa datë, nën pikat A, B, C puna në vlerë prej 116.339,26 euro plus 15% të taksave dhe shuma totale e 135.278, 20Euro;

C) – e datës 21/07/2006 "Situacioni i dyte 3/2006", "dokumenti 33", duke deklaruar në rreshtin 6 sasinë e punës së kryer në përputhje me këtë situacion: 150.309,11 euro, në rreshtin e 7 zbritet në bazë të marrëveshjes: 15.030,11 euro, në rreshtin e 8 për pagesë mbetet 135.278, 20 euro, në rreshtin 9 paradhënia 140.689,60 euro,

⁷ Per kete dokument dhe situacion, si dhe per pagesen saj, do te flasim me ne hollesi me vone.

⁸ Keto fakte do te permenden ne hollesi me vone.

në rreshtin 9A e zbritur nga situacioni i tanishëm 50.000 euro, në rreshtin 9B paradhënia që mbetet për t'u zbritur 90.689,60 Euro dhe në rreshtin e 10 për pagesën sipas këtij situacioni 85.278,20 euro.

D) Fatura 39/06, datë 21/07/2006, e përgatitur në një letër me "E." në krye të letrës, që mbante dy vula të "E."-t (një në krye dhe një në fund), ku deklaroheshn punimet në vlerë prej 127.762,74 euro, të shtuara nga tatimi 15% në vlerë prej 22.546,11 euro, në shumën e përgjithshme prej 150.309,11 euro, duke zbritur nga ajo 10% në vlerë prej 15.030,91 euro, dhe duke pretenduar për t'u paguar shuma totale prej 135.278,20 euro.

C.1.15 - Në bazë të një urdhër pagese për obligim dhe pagesën me referencë 20406254, dhe numri i zotimit 33994, datë 25/07/2006, kompanisë "E." i ishte paguar fatura nr. 39 datë 21/07/2006, në vlerë prej 135.278,20 euro.

C.1.15.1 - Kjo pagesë u bë dhe u lejua nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në lidhje me faturën 39 të datës 21/07/2006, pavarësisht se ishte tashmë një tjetër dokument me të njëjtën datë, 21/07/2006, por numri 33 (më i vjetër se tjetri, i cili është 39) "situacioni i dyte", duke theksuar qartë se vetëm 85.278,20 euro duhej të paguheshin, jo 135.278,20 euro (dokumenti "C" i është përshkruar më lart në **C.1.14.3**), dhe pavarësisht se dokumenti me numrin 33 ishte ai me vulën dhe nënshkrimin nga ana e organit mbikëqyrës "Kompania e Veriut", jo numri 39.

C.1.15. 2- Përmbajtja e dokumenteve të përshkruara më lart (në **C.1.14.3 "A"**, **"B"**, **"C"** dhe **"D"**), janë të rreme, sepse, edhe në mes vete, ato janë materialisht të papajtueshme:

- Dokumentet **"A"** dhe **"C"** kanë referencë për të njëjtën shumë prej 140.689,60 euro, por kjo shumë në dokumentin **"A"** është përshkruar si punë e kryer (rreshtat 6 dhe 7), përkundër referencës në krye të " Situacioni I Pare Avansuas ", ndërsa në dokumentin **" C "**, ajo shumë përputhet me paradhënien (rreshtat 9, 9A dhe 9B dhe totali i shumave që do të zbriten janë të shënuara në rreshta 9A dhe 9B, duke e bërë totalin në rreshtin 9).
- Dokumentet **"B"** dhe **"C"** kanë referencë për të njëjtën shumë prej 135.278,20 euro, por kjo shumë në dokumentin **"B"** përputhet

me punët në vlerë prej 116.339,26 euro plus tatimi 15%, ndërsa në dokumentin "C" e njëjta vlerë është duke fituar duke thënë se puna e kryer ka qenë në vlerë prej 150.309,11 euro, të cilës i është zbritur 10% në bazë të marrëveshjes (dhe 10% është 15.030,11 euro) dhe për këtë arsye shuma për t'u paguar për punën e kryer bëhet, përsëri, e njëjta shumë, 135.278, 20 euro.

- "B", "C" dhe "D", sepse në "D" shuma që korrespondon (gjithashtu e ndryshme) me punët është e ndryshme në raport me atë të paraqitur në "B" (dhe "C") dhe pavarësisht se çmimi i punëve është i ndryshëm, dhe edhe pse tani jo vetëm tatimi 15% është shtuar, por edhe 10% e garancisë është zbritur, çdo gjë është shkruar në një mënyrë për të fituar të njëjtën shumë përfundimtare që duhet të paguhet, 135.278,20 euro, si në dokumentet "B" (dhe "C").

C.1.16 - Kompania "V." i pranonte, duke i vulosur dhe nënshkruar, situacionet e paraqitura nga kompania "E.", në të cilën ka pasur fjali të tilla si ":" paradhënie "," të zbritura nga gjendja e tanishme "dhe" Paradhënia e mbetur për t'u zbritur".

C.1.17 - Gjatë periudhës kohore A.Z. ishte duke ushtruar detyrën e sekretarit të përhershëm, nga 18 Maji 2006 deri më 27 nëntor 2006, dhe përveç pagesës së kontestuar në vlerë prej 135.278,20 euro (në të cilën 50.000 euro nuk ishin zbritur), e datës 25/07/2006, ka pasur pagesa të tjera të situatave të paraqitura nga kompania "E.", që ai nuk i ka ndaluar apo raportuar, dhe prandaj i ka lejuar ato dhe e njëjta vlen, *mutatis mutandis*, për S.F.n si XXX i Divizionit për Mbështetje të Ndërmarrjeve dhe Zhvillim Rajonal, pasi ai ishte i përfshirë në Departamentin e Zhvillimit të Sektorit Privat, të cilit i përkiste projekti, nuk i ka kryer detyrat e tij menaxhuese lidhur me projektin, pasi që ai ishte ngarkuar edhe me mbikëqyrjen e projektit:

A) - Datë 31/05/2006, "Situacioni i Pare Avansuas", duke deklaruar në rreshtin e 6 sasinë e punës së kryer sipas këtij situacioni: 156.321,80 euro, në rreshtin e 7 zbritet në bazë të marrëveshjes: 15.632,18 euro, në rreshtin 9 për pagesën sipas këtij situacioni 140.689,62.

B) -Datë 25/10/2006, "Situacioni i Katert Energjia, Ndriqimi dhe Telefonia", "dokumenti 51", duke deklaruar në rreshtin e 6 sasinë e punës së kryer sipas këtij situacioni: 146.317,90 euro, në rreshtin e 7 zbritet në bazë të marrëveshjes: 14.631,79 euro, në rreshtin e 8 për pagesë mbeten 131.686, 11 euro, në rreshtin 9 A zbritet nga gjendja e tanishme 35.000 euro, në rreshtin 9B paradhënia që mbetet për t'u zbritur 35.689,60 euro dhe në rreshtin 10 për pagesën sipas këtij situacioni 96.686,11 euro.

C.1.17.1 – Në provën 5 të aktakuzës⁹, faqe 3, në fund të tabelës (nga ana e djathtë në fund "Avansi i paguar"), pas shumës 50.000 Euro janë 20.000 euro (20.000 euro që janë duke munguar në faqen e parë të së njëjtës provë, në mes të shumës 50,000 euro dhe 35.000 euro) dhe pastaj janë 35.000 euro dhe pas kësaj:

15.000 euro, 10.000 euro dhe 10.689,60 euro; këto 3 shuma të fundit përbëjnë totalin prej 35.689,60 Euro (e njëjta shumë si në rreshtin 9B të situatës së përmendur më lart nën **C.1.17 B**).

C.1.17.2 – Në të njëjtën faqe 3 të të njëjtës provë sapa të përmendur, nga ana e majtë në fund "10%" (shuma e zbritjeve prej 10% në çdo pagesë, sipas kontratës), shuma e zbritur ishte 14.631,79 euro, si në rreshtin e 7-të të gjendjes së datës 25/10/2014.

C.1.17.3 - Shumat në faqen 3 të të njëjtës provë, në anën e djathtë në fund (pjesët e "Avansi i paguar") përbëjnë totalin prej 140.689,60 eurove, e cila është shuma që korrespondon me pagesën e gjendjes së datës 31/05/2006, gjithashtu e vulosur dhe e nënshkruar nga kompania "N." dhe pagesa e të cilit ishte lejuar nga të pandehurit (dhe të tjerët, në momente të ndryshme dhe pagesa) në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

C.1.17.4 - Kompania "N." ishte e vetëdijshme për paradhënien e përmendur, 140.689,60 euro, sipas dokumentit të quajtur "prova 5" shuma totale e paradhënies, dhe përshkrimi i pjesëve për t'a paguar përsëri, është përshkruar dhe kompania "N.", siç u tha, po vuloste dhe nënshkruante situatat e paraqitura nga "E." në të cilat, në "rreshtin "9", këto fakte ishin deklaruar.

⁹E ofruar në PSRK nga dëshmitari Agron Pajaziti, nga koha kur ai u shkarkua nga funksionet e tij në "North Company".

C.1.18—Urdhri për pagesën, që përmbante nënshkrimet e nevojshme nga zyrtarët në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ishte dërguar në Thesar në Ministrinë e Financave që të urdhërojë bankën për të ekzekutuar transferimin e parave, pagesën, për "E.n", në bazë të urdhrit të përmendur për pagesë për detyrim dhe pagesës me referencë 20406254, dhe numrit për zotim 33994, të datës 25/07/2006, me të cilën kompania "E." ishte paguar me faturën nr. 39 të datës 21/07/2006 në vlerë prej 135.278.20 €, dhe jo 85.278,20 euro, sipas dokumentit me të njëjtën datë, 21/07/2006, por numri 33 "situacioni i dytë", që qartazi thekson se vetëm 85.278,20 euro është dashur të paguhet, e jo 135.278,20 euro (sipas dokumentit të përcaktuar më lart në **C.1.14.3 "C"**, numër 33, e lëshuar nga "E." dhe e vulosur dhe e nënshkruar nga organi mbikëqyrës i Kompanisë "N." —më lart në **C.1.15.1**).

C.1.19 - Në kohën e pagesës në fjalë prej 135.278,20 Euro, zyrtarja certifikuese B.S. ishte në pushim dhe i pandehuri S.H. po e zëvendësonte atë në cilësinë e "zyrtarit certifikues" për këtë pagesë, kjo pavarësisht se ai kishte nënshkruar në fillim të njëjtin formular (formular që përgjatë projektit do të kopjohej për t'u plotësuar në pjesët e mbetura dhe për të ekzekutuar pagesat) në kapacitetet e "zyrtarit pranues" dhe "zyrtarit zotues" (pasi që ai ishte zyrtar i financave).

C.1.20—Para pagesës së shumës prej 135.278,20 euro të përmendura më herët, të tjerët ishin kryer, siç u shpjegua më lart, përkatësisht pagesën e paradhënies, të paraqitur nga "E.", në të cilën është shkruar në një kuti "SITUACIONI I PARE AVANSUAR NR. 02/2006 "në vlerë prej 140.689,62 euro (me B.S. që e kishte nënshkruar atë si zyrtar certifikuese), pagesa me referencën 20406254 dhe numrin e zotimit 33994, të datës 07/06/2006, sepse ajo lexohet, në raport me shumën e 156.321,80 se ajo është "sasia e punës së përfunduar në bazë të kësaj shtate", dhe në rreshtin vijues ajo lexon "10% e shumës të mbahet në burim sipas marrëveshjes" është e barabartë me 15.632,18 (dhe për këtë arsye pagesa prej 140.689, 62 Euro - siç është përmendur në dokumentin e përmendur më herët në **C.1.14.3 "A"**).

C.1.20.1 – Formularët e Thesarit (urdhri për blerje, "Thesarit Urdherblerje"), të Ministrisë së Financave, për pagesën e 140.689,62 euro dhe për pagesën e 135.278,20 euro janë nënshkruar nga (dëshmitari i tanishëm) H.Z. si nëpunës

pranues financiar dhe nga i pandehuri N.K. si nënpunës aprovues "Nepunesi Aprovues", dhe respektivisht ishin nënshkruar me 07/06/2006 me 25/07/2006.

C.1.20.2 - Sipas dokumentit të tillë ("A") shuma prej 504.945,80 euro ishte "sasia e punës së përfunduar nga fillimi i ndërtimit" deri në atë datë, dhe në fund ajo lexon "shumë për të paguar sipas kësaj situatë ": 140.689,62 euro.

C.1.20.3 - Deri në atë moment (07/06/2006) në të cilën ishte paguar edhe shuma 140.689,62 euro, pagesat në vijim tanimë ishin bërë më 19/10/2005 në vlerë prej 144.000 euro dhe me 15/12/2005 (përkatësisht "CPO" 's 24484, 29849, 22974 dhe 307713): 107.000 Euro, 68.984,94 euro, 256.000 euro, 72.960, 84 euro, në shumën totale prej 504.945, 78 euro¹⁰.

C.1.20.4- Duke marrë parasysh shumën (për të mos përmendur 144.000 euro) të 504.945,78 euro që ishin paguar para shumës 140.689,62 euro, 10% e saj do të ishte 50.494, 58 euro, e jo 50.000 euro - atëherë këto 50.000 euro janë një pjesë e borxhit nga paradhënia e 140.689,62¹¹ euro, siç përshkruhet dhe shpjegohet më lart.

C.1.21– Deri me 07/06/2006, deri kur të paktën këto pagesa u bënë(144.000 euro + 504.945,78 euro + 140.689,62 euro), në vlerë të përgjithshme prej 789.635,40 euro, kontrata fillestare ishte e vetmja në fuqi dhe ajo ishte vetëm në shumën prej 144.000 euro / çmimi për njësi 69.825,25 euro (pas tenderit "për projektimin dhe ndërtimin e parkut industrial në D.", ku nuk përmendet asnjë numër i njëjësive), ndërsa zotimet e fondeve për projektin e parkut industrial në D. ishin bërë në vlerë prej 400.000 euro (me 26/07/2005, pagoi 144.000 euro dhe 256.000 euro), vlerën prej 107.000 euro (me 29/07/2005), vlerën prej 72.960,84 Euro (me 12/10/2005), vlerën prej 69.867,16 (me 14/10/2005, nga të cilat vetëm 68.984,94 janë paguar në 15/12/2005 - shih faktin më lart **C.1.20.3**) dhe vlerën prej 1.040.000 euro, në të njëjtën ditë të përmendur më lart, 07/06/2006 - datën në të cilën i pandehuri A.Z. tashmë ishte duke e ushtruar detyrën e sekretarit të

¹⁰Jo 504.945,80 Euro pasi që kishte një diferencë prej 2 centëve , siç lexohet në dokumentin e dorëzuar nga "E. " për pagesën e 140.689,62 Eurove.

¹¹Ky aktgjykim nuk do të del jashtë nga fushëveprimi i aktakuzës dhe për këtë arsye referimi i shumës avans bëhet vetëm në lidhje me shumë 140.689,62 euro nga e cila 50.000 euro nuk ishin zbritur.

përhershëm¹². Kërkesat e përmendura më lart për zotimet në vlerë prej 400.000 euro dhe tjetra në vlerë prej 1.040.000Euro, përkatësisht me datë 21/07/2005 dhe 31/05/2006, janë nënshkruar nga i pandehuri S.F., në cilësinë e Shefit të Divizionit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimit Rajonal.

C.1.21.1 – Më 07/06/2006 kontrata në vlerë prej 144.000 euro (/ çmimi për njësi 69.825,25 euro) nuk ishin "plotësuar" nga një tjetër kontratë (pas tenderit tjetër) dhe kontrata fillestare me asnjë referencë në numrin e njërive (njëjtë si në njoftimin e kontratës me procedurë të hapur, ky pohim është bërë për shkak të përmendjes në "çmimin për njësi" të 69.825,25 eurove në ofertën fituese të bërë nga "E.") nuk ishte "ndryshuar" "zëvendësuar", "plotësuar" nga një tjetër.

C.1.21.2 - "Zëvendësimi" i asaj kontrate fillestare u bëvetëm me 20/07/2006 në "kontratën e parë aneks", me të cilën "*duke pasur parasysh se palët e përmendura më lart kanë lidhur një kontratë për kryerjen e punëve në Projektin e Parkut Industrial në D., (...) bazuar në punët e kryera nga kontraktori dhe kërkesës së tij në ndryshimin e kushteve të pagesës dhe me miratimin nga ana e MTI-së (...) vlera totale e kontratës do të jetë 1.730.000 euro (...)*" dhe me 28/09/2006 një "kontrata e dytë aneks", ishte lidhur duke shtuar shumën e 14.580,00 euro për punët shtesë¹³; të dyjat këto "aneks kontrata" ishin ndërmjet kompanisë "E.", dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, të nënshkruara nga i pandehuri N.K.¹⁵.

C.1.22 – Fatura me numër 39/06 mbart faksimilin që A.Z. e kishte përdorur në kohën kur shuma prej 135.278,20 eurove ishte paguar dhe fatura ishte me logon e kompanisë "E." dhe ajo kishte 2 vulat e kompanisë (njëra lart së bashku me datën) dhe një tjetër në fund, ku ishte emri i H.B.; A.Z. në atë kohë ishte duke e përdorur një faksimil të nënshkrimit të tij (vulë), pasi ai kishte krahun e tij në allçi për shkak të një lëndimi që ai e kishte pësuar në një aksident automobilistik më 2 korrik 2006.

¹²Zotimet e fondeve të përmendura janë vetëm ato që u bënë para datës 07/06/2006 dhe me 07/06/2006, siç thuhet (shih formularët e zotimit që gjenden në shkresat e lëndës; grafiku i bërë nga dëshmitarja e tanishme M.B. dhe e paraqitur në prokurori me 03/07/2014 në essence+ vërtetojë formularët e tillë të zotimit të fondeve.

¹³Këto punë dhe kontrata e dytë aneks do të përmenden me shumë detaje (pika 3)¹⁵

Këto fakte do të adresohen me përpara me më shumë detaje (pika 3).

C.1.23 - A.Z. ka punuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë si auditor i brendshëm dhe më pas, në mes të periudhës 18 maj dhe 27 nëntor të vitit 2006, ai u emërua si ushtrues detyre i sekretarit të përhershëm dhe kishte dashur që të emërohej sekretar i përhershëm dhe për këtë ai ka aplikuar për këtë pozitë, por, pasi që u krye procesi i përzgjedhjes, person i emëruar si sekretar i përhershëm ishte këshilltari i ministrit B.D., B.Z. - i cili e mori detyrën. A.Z. pastaju bëdrejtor i njësisë së auditimit.

C.1.24 - Në një auditim të brendshëm, të kryer në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, nga tani i pandehuri A.Z., në kohën kur ai ishte drejtor i njësisë së auditimit, me 21/1/2008, ishte "*vërejtur se (...) b) Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik lidhur me tenderin, i ka tejkuluar artikujt e faturuar për MTI-së për pagesë e) Sipas kushteve të kontratës, nuk ka pasur asnjë pagesë në formë të paradhënies ku MTI ka bërë të njëjtën gjë f), MTI ka paguar shumën prej 50,000.00 euro më shumë operatorit ekonomik, për të cilën MTI ka dështuar ta barazojë bilancin dhe të rishikojë kontratën dhe nuk ka formuar komisionin për pranimin e fazës së projektit (...)*".

C.1.25 - Pas auditimit të tillë të brendshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dhe pasi që A.Z. e ka informuar ministrin lidhur me auditimin, nga operatori ekonomik "E." ishte kërkuar që të kthehet shuma prej 50.000 euro, nga të cilat ai i ktheu 5.000 euro në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

C.1.26 – Pjesa e mbetur prej 45.000 euro nuk është kthyer deri më sot.

C.1.27 - Deri në përfundimin e punimeve dhe pagesave në projekt, çfarëdo pagesë e tepërt mund të jetë subjekt kompensimi për pagesën tjetër, nëpërmjet zbritjes së çfarëdo shume të tepërt të paguar më parë (si tepricë) për një pagesë e cila nuk është ekzekutuar ende.

C.1.28 - Çfarëdo pagese, në mënyra të ndryshme dhe në faza përgjatë procesit, duhej të autorizohet nga kreu i departamentit të prokurimit, duhej të certifikohet dhe lejohej nga zyrtari certifikues dhe nga sekretari i përhershëm, pasi secili prej këtyre zyrtarëve nuk ishte në gjendje për të mundësuar pagesën vetëm dhe të dy

zyrtari certifikues dhe sekretari i përhershëm e kishin fuqinë ligjore për të ndaluar çfarëdo pagesë ndaj kontratës ose ligjit. I pandehuri K., si kreu i departamentit të prokurimit, nënshkruajti urdhrin për blerje (**shih më lart C.1.20.1**) me datë 25/07/2005 lidhur me urdhërpagesën për obligimin dhe pagesën për referencën 20406254, dhe numrin e zotimit 33994 , gjithashtu të datës 25/07/2006 përmes të cilave iu kishte paguar kompanisë "E." "fatura" me numër 39 e datës 21/07/2006, në vlerë prej 135,278.20 euro. Në atë kohë, më 25/07/2006, zyrtar certifikues ishte i pandehuri S.H. dhe ai e kishte certifikuar formularin në atë cilësi dhe ushtrues detyre i sekretarit të përhershëm ishte i pandehuri A.Z. i cili nuk e kishte ndaluar një pagesë të tillë. I pandehuri S.F. nuk e kishte ndaluar apo raportuar, pra ai e kishte e lejuar pagesën në fjalë: si XXX i Divizionit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimit Rajonal, pasi ai ishte i përfshirë në Departamentin e Zhvillimit të Sektorit Privat të cilit i përkiste projekti, nuk i ka kryer detyrat e tij menaxhuese në projekt pasi që ai ishte i ngarkuar edhe me mbikëqyrjen e projektit.

C.1.29– Në lëndën 272/2007, në të cilën paditës ishte Kosova - Qeveria e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në Prishtinë, kundër tëpaditurës NNP "E.", nga fshati Rreznik, Komuna e Vushtrisë, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, më 18.06.2008, ka vendosur në favor të paditësit dhe si pasojë e paditura është dënuar për t'ia kthyer paditësit shumën prej 45.000,00 euro me interes vjetor prej 2,5%, duke filluar nga 19/04/2007, deri në pagesën përfundimtare në afat prej 8 ditësh, nga dita kur aktgjykimi do të marr formën e prerë (04/05/2011); nëse nuk vepron kështu, atëherë do të bëhet një ekzekutim me dhunë; siç u tha, shuma nuk është paguar (si në **C.1.25**).

C.1.30.1 - Nuk ka nevojë për të përsëritur këtu arsyetimin e aktgjykimit në fjalë. Sisoqoftë, gjykata kopjon këtu një pjesë të fragmentit si mëposhtë: "(...) paditësi (...)", ka përcaktuar se shuma prej 50,000.00 eurosh është paguar gabimisht shumë. Pas zbulimit të këtij gabimi, më 13.04.2007, paditësi i ka dërguar një shënim të paditurit në lidhje me gabimin e sipërpërmendur. Me 19/04/2007, e paditura, gjithashtu me një shënim, njoftoi paditësin ku ajopronon detyrimet e saj ndaj paditësit dhe në të njëjtën kohë së bashku me këtë letër pranon

obligimet dhe kishte kthyer shumën prej 5,000 euro më 10/04/2007¹⁴, duke mbështetur detyrimin për të shlyer pjesën tjetër të parave në shumë prej 45,000.00 € në një afat sa më të shkurtër të mundshme".

C.1.31 - Në lëndën me numër 164/2008, me aktgjykimin e datës 04/05/2011, Gjykata Supreme e Kosovës e ka "refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe e ka vërtetuar aktvendimin e përmendur të Gjykatës Ekonomike të Qarkut të Prishtinës, lënda me numër 272/2007 me 18/06/2008".

C.1.31.1 - Ankesa është paraqitur në bazë të "(...) përcaktimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për të hedhur poshtë aktgjykimin e ankimuar dhe (...) të kthej për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë".

C.1.31.2 - Përgjatë procedurës civile "kthimi i 45.000 euro të mbetura nëpërmjet cilitdo të pandehur" nuk ishte një argument i përdorur nga i padituri "E.", madje as në fazën e ankimimit.

C.1.32 - Deklarata e parë para Prokurorisë, në kohën në cilësinë e dëshmitarit, e dhënë nga tani i pandehuri H.B. ishte me 02/09/2011, vazhdoi me 07/09/2011, pas vendimit të shkallës së parë, me 18/06/2008, dhe pasi që aktgjykimi (i formës së prerë) mbi ankesën ishte lëshuar, me 04/05/2011 - me të cilin ai kishte qenë i dënues për të kthyer shumën prej 45.000 euro plus interesin në kushtet tani më të përmendura.

Pika 2

C.1.33 - Gjatë ekzekutimit të kontratës së projektimit dhe ndërtimit të parkut industrial në D., një ditë gjersa i pandehuri K. ka qenë së bashku me (tani dëshmitar) H.Z. duke pirë kafe në Hotel P. në M., me idenë e këtij të fundit, i

¹⁴Nuk ka asnjë dëshmi të dokumentuar për datën dhe mjetet, pavarësisht se ky fakt nuk është mohuar nga askush gjatë procedurës, se ajo ishte kthyer nga banka; megjithatë, referenca e vetme në datën e pagesës rrjedh nga deklaratat e të pandehurit H.B. e cila ishte dhënë para ekspertit R.B. i cili ishte ekspert financiar i gjykatës i caktuar nga Gjykata Ekonomike për kryerjen e ekspertizës (Faqja 3 e këtij raporti Ekspertiza financiare lidhur me 50.000 euro", ku eksperti deklaroi paragrafi i fundit- "sipas deklaratës së dhënë nga i pandehuri e cila është pjesë e shkresave të lëndës personi i njëjtë me datë 10/04/2007 ka kthyer shumën prej 5.000 eurove në llogarinë e MTI-së përmes transferit bankar, ndërsa sasia tjetër e 45.000 nuk është kthyer deri në këtë moment të ekspertizës").

pandehuri B. shkoi atje pasi kishte telefonuar dhe e kishte pyetur K. ku ishin ata, ishte ulur me ta dhe kishte biseduar për gjëra të parëndësishme.

Pika 3

C.1.34 - Njoftimi në gazeta i datës 22/07/2005, për tenderin në fjalë thotë se në titullin (titulli i kontratës, nga autoriteti kontraktues - Qeveria): "Projektimi dhe ndërtimi i infrastrukturës së parkut industrial në D." (siç u tha më lart në **C.1.3.1**, dokumenti në shkresat e lëndës, prova 43/2).

C.1.35 - Me 07/10/2005, kontrata për projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së parkut industrial në D., në mes të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe "E. Company", të përfaqësuar nga H.B., ishte nënshkruar (siç u tha më herët në **C.1.9**, e dokumentuar në shkresat e lëndës si "Marrëveshja bazë" ose "Kontrata bazë"), në vlerë prej 144.000 euro dhe 69.825,25 euro çmimi për njësi, pa përmendur numrin e njësive dhe referencën në kontratë, pika 6 e nenit 4, "kjo do të jetë një kontratë e bazuar në çmimin për njësi dhe çmimit të ofruar për projekt / paushall (...)".

C.1.36 - Pavarësisht nga kushtet e përgjithshme të kontratës të nënshkruara me "E.n", nën seksionin e pagesave (seksioni 17) në par. 1 lexohet "Pagesa e parë (144.000 euro për dizajn) duhet të bëhet (...)"; tenderi ishte për "Projektim dhe Ndërtim", jo vetëm "projektim", por edhe për punët (projektim dhe ndërtim).

C.1.37 - Procesverbali i hapjes së ofertave, në lidhje me ofertën 10, nga "E." gjendja e kompanisë lart: "Titulli i dhënëkontratës (...) Projektimi dhe ndërtimi i infrastrukturës së parkut industrial në D. "(nënshkrimi i të pandehurit N.K. poshtë, në fund të dokumentit).

C.1.37.1 - Tenderi ishte për "Projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së Parkut Industrial në D." (siç u tha më herët në **C.1.34**, dokumenti në shkresat e lëndës, prova 43/2), jo vetëm për "*projektim - në vlerë prej 144.000 euro*", pasi që kontrata në fjalë ishte ndryshuar vetëm me kontratën e parë aneks, pa tender tjetër, në mes të "E. Company" dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, të nënshkruar nga i pandehuri N.K., kontrata e datës 20 / 07/2006, në të cilën thuhet: "Duke pasur parasysh se palët e përmendura më lart kanë lidhur një kontratë për kryerjen e punimeve në projektin Parku Industrial në D., (...) Bazuar

në punët e kryera nga kontraktori dhe kërkesës së tij në ndryshimin e kushteve tëpagesës dhe me miratimin nga ana e MTI-së, ku palët bien dakord për të ndryshuar reciprokisht gjendjen e pagesës (...) janë marrë vesh si vijon: (...) Neni 1 (në lidhje me ndryshimin e klauzolave 17.3 deri 17.5), neni 2 (rreth pagesave të bëra në përputhje me "situatat") (...) Neni 4: Vlera e përgjithshme e kontratës do tëjetë 1.730.000 euro (...) ".

C.1.37.2 - Pas këtij ndryshimi të kontratës përmes aneks kontratës të datës 20/07/2006, një tjetër aneks kontratë ishte lidhur në mes të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, e nënshkruar nga i pandehuri N.K., dhe kompanisë "E.", me 28/09/2006, duke deklaruar: "Duke pasur parasysh se palët e përmendura më lart kanë lidhur një kontratë për kryerjen e punimeve në projektin Parku Industrial D. bazuar në punët e kryera që erdhën pas miratimit të kërkesës për procedurë të negociuar para shpalljes së kontrata me APP, ne e lidhim këtë aneks kontratë (...) Neni 1: kontrata origjinale e datës 07/10/2005 si marrëveshje e përbashkët mes palëve vlera e përgjithshme e së cilës është 1.730.000 Euro (...) Neni 2: Në total vlera e aneks kontratës do të jetë 14.580,00 euro (...) Neni 3: Kontraktuesi duhet të fillojë këtë punë menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe do t'i përfundojë ato brenda 7 ditëve (...)" .

C.1.37.3 – Kontrata bazë nuk i referohet ligjet mbi prokurimin dhe "aneks kontratat" nuk i referohen fare kornizës së tyre ligjore apo se nëçfarë dispozita ato janë të bazuara.

C.1.37.4 - Pavarësisht se shuma ekontratës fillestare të datës 07/10/2005 ishte ndryshuar vetëm me aneks kontratën e parë (neni 4 i aneksit të tillë), të datës 20/07/2006, një muaj më herët, në 20/06/2006 i pandehuri N.K.kishte dorëzuar në Agjencinë e Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 34, par. 3 (mes tjerash), të Ligjit mbi Prokurimin 2003/17, një Kërkesë që të Përdorë Procedurat e Kufizuara ose të Negociuara për punët shtesë duke deklaruar "vlera epërafërt e kontratës: 1.700.000 euro, vlera e paraparë: vlera e punëve shtesë: 14.580 euro "(shih kopjen e kërkesës, dokumenti në shkresat e lëndës).

C.1.37.4.1 - Në arsyetimin e Kërkesës së tillë është shkruar: "në mënyrë që të shmangen problemet eventuale që do të shfaqen pas përfundimit të projektit dhe në pamundësinë e fshatarëve për t'i larguar vetë këto tuba, nga ana e bordit mbikëqyrës për mbikëqyrjen e këtij parku është marrë vendim që duhet të paguhet

nga MTI për vendosjen e këtyre gypave jashtë hapësirave të punës së këtij parku, prandaj ne jemi duke bërë kërkesën në APP që të lejojë procedurat për publikimin e njoftimit për kontratën e punëve shtesë (Punimet do të kryhen nga kompania E.e cila ka kontratë deri në nëntor të vitit 2006) ".

C.1.37.4.2 - Punimet shtesë në vlerë prej 14.580 euro, të përmendura në kërkesën e datës 20/06/2006, nuk ishin përfshirë në kontratën e parë aneks të datës 20/07/2006 (në të cilin shuma e kontratës bazës të datës 07/10/2005 ishte vendosur, kishte ndryshuar për 1.730.000 euro - në nenin e saj 4), por vetëm në kontratën e dytë aneks të datës 28/09/2006 (në nenin e saj 2). **Fakte të tjera**

C.1.28 - Në kohën kur i pandehuri sillej në mënyrën e përshkruar më lart ata ishin në gjendje të kuptonin dhe kontrollonin veprimet e tyre (veprimet dhe mosveprimet), të cilat ata i dëshironin, duke e ditur se veprimet e tyre ishin të ndaluara dhe të dënueshme me ligj.

C.1.39 - I pandehuri N.K. ka lindur më 15/06/1968, është i ve, baba i dy fëmijëve (mosha: 11 dhe 15 vjeç), ka diplomuar në inxhinierinë mekanike, aktualisht i punësuar si drejtor i departamentit të prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës (i pezulluar për një kohë, pas një ankese u kthye në pozitën e tij nga Komisioni i Pavarur) dhe ka deklaruar gjendjen e tij financiare si mesatare.

C.1.40 - I pandehuri A.Z. ka lindur më 10/03/1957, është i martuar, baba i tre fëmijëve (mosha: 28, 32, 34 vjeç), i diplomuar në ekonomi, aktualisht ekonomist, auditor dhe profesor univerziteti dhe ka deklaruar gjendje të mirë financiare.

C.1.41 - I pandehuri S.H. ka lindur më 15/12/1974, është i martuar, baba i dy fëmijëve (mosha: 1 vit e 5 muaj dhe 3 vjeç), i diplomuar në ekonomi, aktualisht ekonomist në inspektionin e brendshëm të PTK-së dhe ka deklaruar gjendje të mirë financiare.

C.1.42 - I pandehuri S.F. u lind më 10/03/1973, është i martuar, baba i dy fëmijëve (mosha 8 dhe 10 vjeç), i diplomuar në ekonomi, aktualisht këshilltar i pavarur dhe ka deklaruar gjendjetë mesme financiare.

C.1.43 - I pandehuri H.B. ka lindur më 12/10/1967, është i martuar, baba i ... fëmijëve (mosha: ..., ... dhe ... vjec), që kanë përfunduar shkollën e mesme, pronar i korporatës "E." në Vushtrri dhe ka deklaruar gjendje të mesme financiare.

C.1.44 - I pandehuri H.B. ka të dhëna të mëposhtme penale:

- Lëndën penale P.nr.60/12 në Gjykatën Themelore në Vushtrri për veprën penale të nenit 316, paragrafi 1, "Dhënia e paarsyeshme e dhuratave", për të cilën ai është shpallur fajtor dhe dënuar me 3 muaj burgim, me kusht që nuk kryen veprë penale për periudhën prej një viti.

- Procedura penale P.551/06 në Gjykatën Themelore të Mitrovicës për veprën penale të nenit 334, par. 1, "legalizimi i përmbajtjes së rreme", për të cilën është shpallur fajtor dhe dënuar me 3 muaj burgim, me kusht për një periudhë prej një viti.

- Procedura penale P.562 /09 në Gjykatën Themelore të Gjakovës për veprën penale të nenit 332, par. 3-1, "falsifikimi i dokumenteve", për të cilën ai ushpall fajtor dhe u dënua me 3 muaj burgim për veprën penale të nenit 334, par. 1 (kodi i vjetër), "legalizimi i përmbajtjes së rreme", me kusht për një periudhë prej një viti.

C.1.45 - Në lidhje me të pandehurit e tjerë nuk ka të dhëna nga ndonjë nga gjykatat themelore në Kosovë që vërtetojnë dënime të mëparshme.

Arsyetimi i fakteve të përcaktuara:

Arsyetimi nuk ka për qëllim të jetë një përsëritje e provave materiale, funksioni i saj është që të mundësojë kuptimin e vendimit në lidhje me përcaktimin, apo jo, të fakteve.

Në fushëveprimin e arsyetimit, ne citojmë këtu nenin mbi të drejtën për gjykim të drejtë nga ana e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ", " arsyetimi i vendimeve gjyqësore "(neni 6 KEDNJ.)¹⁵ - Sipas jurisprudencës që reflekton një parim të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet të deklarohen në mënyrë adekuate arsyet mbi të cilat ato janë të bazuara (*Papon k. Francës (dec.)*). Vendimet e arsyetuara i shërbejnë qëllimit për

¹⁵Në dispozicion në linkun http://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_criminal_ENG.pdf, faqe 21

t'ia demonstruar palëve që ato janë dëgjuar, duke kontribuar në një pranim më të gatshëm të vendimit nga ana e tyre. Përveç kësaj, ato obligojnë gjykatësit që t'a bazojnë arsyetimin e tyre në argumente objektive, dhe gjithashtu ruajnë të drejtat e mbrojtjes. Megjithatë, shtrirja e detyrës për të dhënë arsye ndryshon sipas natyrës e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit (*Ruiz Torija v. Spain*, § 29). **Gjersa gjykatat nuk janë të detyruara për të dhënë një përgjigje të detajuar për çdo argument të ngritur** (*Van de Hurk k. Holandës*, § 61), **duhet të jetë e qartë nga vendimi se çështjet thelbësore të çështjes janë adresuar** (shih *Boldea k. Rumanisë*, § 30). Gjykatat vendore duhet të tregojnë me **qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat mbështesin vendimin e tyre** në mënyrë që t'ia lejojnë palës ndërgjyqëse që në mënyrë të dobishme të ushtrojnë çfarëdo të drejtë në dispozicion për ankesë (*Hadjianastassiou kundër Greqisë dhe Boldea kundër Rumani*.) [theksimi është shtuar]. "

"E vërteta", çfarëdo që mund të jetë, mund të mos koincidojë me "të vërtetën juridike", "me fjalë të tjera, e vërteta gjyqësore është themeluar mbi një përcaktim të saktë të fakteve relevante, dhe përcaktimi i saktë qëndron në *dëshmi dhe prova*; në mënyrë që të kemi një vendim të mirë gjyqësor, çdo gjykatë duhet të ketë një mënyrë të mirë të përdorimit të provave me qëllim të gjetjes dhe të provuarit të fakteve reale"¹⁶. Të gjitha faktet e përcaktuara duhet të provohen përtej dyshimit të arsyeshëm¹⁷, në qoftë se jo, *non liquet* në aspektin e provave do të përfitoj i pandehuri, *in dubio pro reo*, sepse i pandehuri prezumohet i pafajshëm.

Në lidhje me deklaratat e mëparshme të dhëna nga i pandehuri (tani), një dallim i qartë duhet të bëhet në mes të deklaratave që në fazën e procedurës paraprake janë dhënë në cilësinë e dëshmitarit dhe deklaratave që janë dhënë në cilësinë e të pandehurit. Ekzistojnë katër deklarata që janë dhënë nga individë që tani janë të pandehur, por, në kohën, kur ata janë marrë në pyetje ata nuk ishin më shumë se dëshmitarë dhe, për këtë arsye, ata ishin marrë në pyetje si të tillë: S.F. ka dhënë një deklaratë në cilësinë e dëshmitarit me 22/09/2011, A.Z. me 12/10/2011,

¹⁶ArtikullingaRrjetitTrajnimitGjyqësorEvropian,

<http://www.ejtn.eu/Documents/Themis/Written%20paper%20Italie/Themis%20written%20paper%20Romania%20.pdf> f.1.

¹⁷ "Gjatë analizimit të provave në anën substanciale të nenit 2 dhe 3, Gjykata e Strasburgut është e udhëhequr nga parimi i dëshmitarit"përtej çfarëdo dyshimi të arsyeshëm". Sidoqoftë, një konkluzion i fajësisë mund të ngritet nga bashkëekzistenca e konkluzionit të fortë, të qartë dhe të harmonishëm apo të prezumimit të njëjtë të pakundërshtuar të faktit, si në nenin 2 dhe në nenin 3 përkatësisht rezultatin e provës indirekte". *Ibidem*, faqe 16 dhe 17.

S.H. në 31/10/2011 dhe H.B. më 2 dhe 7/09/2011 (kurse i pandehuri N.K. gjithmonë është marrë në pyetje në cilësinë e të pandehurit).

Pavarësisht në çfarë kapaciteti janë dhënë deklaratat, duhet të kontrollohet nëse në kohën kur secila deklaratë është dhënë janë zbatuar dispozitat procedurale të aplikueshme, nëse deklaratat janë në pajtim me kërkesat e përcaktuara në ligj. Është shumë me rëndësi të kontrollohet, në çdo rast, në qoftë se deklaratat e dhëna, pavarësisht se në çfarë cilësie janë dhënë, të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara me ligj (e cila është lidhur me ligjshmërinë e një veprimi hetimor), dhe nëse nuk kanë qenë, atëherë nuk është rëndësishme për të diskutuar çështjen më tej; në rastet kur të gjitha formalitetet janë zbatuar, atëherë është e rëndësishme për të vlerësuar pse, në qoftë se ajo mund, ose nuk mund, të konsiderohet si një provë - në rastin tonë në fillojmë duke thënë se në secilin rast, në atë kohë, formalitetet përkatëse janë zbatuar, kështu që ka mbetur vetëm për t'u diskutuar nëse ato mund ose nuk mund të konsiderohen si prova.

Formalitetet që duhen respektuar janë ato që janë në fuqi në kohën kur personi është duke u marrë në pyetje, siç përcaktohet në ligjin në fuqi në atë kohë (kjo si pasojë e parimit *tempus regit actum* - siç thuhet nga GJA në aktvendimin e datës 10/12/2013 në rastin PN 577/2013, fq. 14, "ligjshmëria e një veprimi hetimor gjithmonë do të duhet të përcaktohet përkundrejt rregullave procedurale në fuqi në kohën kur veprimi hetimor është kryer").

Në atë kohë, dhe në lidhje me deklaratat si dëshmitar, nenet 162 dhe 164 të Kodit të Procedurës së vjetër janë zbatuar duke lexuar të drejtat e dëshmitarit në të gjitha katër rastet. Në lidhje me deklaratat e dhëna në cilësinë e të pandehurit, dispozitat ligjore të zbatueshme për të pandehurit, neni 231, par. 2, seksioni 2, janë zbatuar, përkatësisht "para çfarëdo marrjeje në pyetje i pandehuri, qoftë i ndaluar ose në liri, duhet të informohet për (...) të drejtën për të heshtur dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij ose të saj "; për më tepër, par. 4 thotëse (i pandehuri e ka), "të drejtën për të pranuar ndihmën e mbrojtësit dhe për t'u konsultuar me të para si dhe gjatë marrjes së tij apo të saj në pyetje".

Në rastin në fjalë, ku të gjitha formalitetet janë zbatuar, duhet të vlerësohet nëse dëshmia është e pranueshme kundër vetvetes së tyre si të pandehur tani si dhe për të bashkë-të pandehurit dhe kjo duhet të bëhet në përputhje me rregullat e

provave të përfshira në Kodin e (ri) Procedurës Penale të Kosovës, në pajtim me nenin 541, par. 1, KPPK.

Një gjë që duhet të merret parasysh në procesin e vendim-marrjes është grumbulli i provave që janë pranuar, administruar, dhe nuk janë refuzuar *ab initio* ose përjashtuar me çfarëdo aktvendimi, por kjo është një tjetër gjë për t'u marrë parasysh, për të diskutuar, në çfarë mase gjykata do të vlerësojë çdo provë; deri në çfarë mase gjykata do t'a vlerësojë vlerën e saj provuese, deri në çfarë mase gjykata do t'a konsideroj atë si një formë të pranueshme të provave për të përcaktuar, apo jo, një fakt të caktuar. Gjatë leximit të nenit 361, par. 1, i KPPK-së ne shohim se "gjykata do t'a bazojë aktgjykimin e vet vetëm në faktet dhe provat që janë proceduar në shqyrtimin gjyqësor", që do të thotë nga njëra anë prova që është proceduar në shqyrtimin gjyqësor dhe, nga ana tjetër, prova që nuk është hedhur poshtë ose përjashtuar. Paragrafi i dytë i të njëjtit nen jo vetëm qësqaron kuptimin e paragrafit 1, por edhe konfirmon atë që ne kemi qenë duke e thënë: duke pohuar se "gjykata do të jetë edetyruar që të vlerësojë me ndërgjegje çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë njëpërfundim nëse një fakt konkret është përcaktuar apo jo".

Në lidhje me deklaratat e dhëna në cilësinë e dëshmitarit nga dikush i cili më vonë u bë një i pandehur, ato nuk mund të konsiderohen prova të pranueshme si "deklarata të mëparshme nga një dëshmitar", sepse ai person nuk është mënjë dëshmitar, dhe nuk mund të konsiderohet si "deklarata e mëparshme nga i pandehuri"- si në kohën kur personi nuk ka qenë duke u marrë në pyetje në njëkapacitet të tillë dhe, për këtë arsye, të drejtat e parashikuara me ligj, dhe të respektuara, ishin të ndryshme. Kjo nuk është në kundërshtim me dispozitën në nenin 123, par.5, KPPK: "Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrëvullnetare dhe pa forcë, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit"¹⁸. Në këtë dispozitë është logjike për të kuptuar se kur për herë të parë fjala "i pandehuri" është duke u përdorur nuk është lidhur me vet individin, në vend të cilësisë në të cilën individi është deklaruar. Kjo dispozitë e fundit, ku lexon ", por jo të bashkë-pandehurit" është në përputhje me arsyetimin

¹⁸Sidoqoftë, ekziston jurisprudenca e Gjykatës së Apelit që mund të përdoret edhe në lidhje me të bashkëpandehurit.

prapa normës të përcaktuar në nenin 126, par. 1.1.3, KPPK "(...) mund të mos merret në pyetje si dëshmitarë (...) një i bashkë-pandehur gjersa procedurat e përbashkëta janë duke u zhvilluar", - a fortiori, ne do të themi, në qoftë se procedurat janë të njëjta.

Në fakt ne shohim se në nenin e cituar 123, par. 5, të KPPK-së, ligjvënësi ka zgjedhur fjalët "deklaratat e të pandehurit" (pa deklaruar që kur ... *ab initio*, nga fillimi i hetimeve apo vetëm në një fazë të mëvonshme), dhe gjithashtu ka vënë në dukje se këto deklarata kanë mundur të jenë dhënë në "çfarëdo konteksti". Në lidhje me periudhën e dytë të paragrafit, ne gjithashtu mund të themi se një nga parimet themelore të interpretimit juridik është se ligjvënësi dinte se si të shprehej; në fakt, ligjvënësi ka thënë "(...) janë të pranueshme gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër atij të pandehuri, **por jo** të bashkë-pandehurit", **nuk ka thënë** "(...) janë të pranueshme gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër **atij të pandehuri dhe të bashkëpandehuri**" [theksimi i shtuar]. Fjalja e fundit mund të lexohet si një kriter, një udhëzues për t'u ndjekur nga gjykata gjatë vlerësimit të provave (duke pasur parasysh edhe parimin e mbrojtjes kundër vetë-inkriminimit) në lidhje me atë të pandehurit të veçantë, "*deklarata të tilla nuk mund të shërbejnë si një provë e vetme apo provëvendimtare fajësuese për një dënim*".

Në lidhje me deklaratat e personave të cilët janë marrë në pyetje si dëshmitar, dhe kanë mbetur si të tillë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ligji parashikon rastet në të cilat deklaratat e mëparshme nga një dëshmitar mund të merren parasysh, dhe kjo për shkak se, si rregull, të gjitha provat duhet të paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor, si rrjedhojë e nenit 361 të KPPK-së, par. 1, dhe nenit 123, par. 2, KPPK-së. Ligji qartëson përjashtimet për këto rregulla, për shembull, nenin 123, par. 3, *in fine* dhe par. 4 *in fine*.

Në lidhje me deklaratat e mëparshme të dhëna nga i pandehuri në cilësinë e të pandehurit, atëherë ne duhet të marrim parasysh situatat e ndryshme që mund të ndodhin.

Megjithatë, para kësaj, është gjithashtu e rëndësishme për të bërë dallimin midis provave që janë pranuar, administruar (jo përjashtuar - dhe kjo çështje është adresuar gjatë gjykimit), dhe se si ajo është vlerësuar si provë, vlerën e saj provuese, si pasojë e nenit 260, paragrafët 2 dhe 3 të KPPK-së.

Deklaratat e mëparshme të të pandehurit, siç e kupton trupi gjykues, do të varen në fund të fundit nëse i pandehuri, gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku të gjitha provat janë paraqitur, siç u tha tanimë, vendos qetë parashtrojë rastin e tij apo jo, që do të thotë, nëse vendos qetë heshtë apo jo¹⁹.

Megjithatë, në lidhje me të bashkëpandehurit, vlera provuese e deklaratave të tilla tashmë është përmendur dhe përgjigja ishte se ajo nuk mund të merret parasysh.

Tani është koha për të trajtuar vet të pandehurin dhe natyrisht duke supozuar se deklaratat janë marrë në përputhje me ligjin (neni 261, par. 1, KPPK).

Sipas kësaj norme të fundit, neni 261, par. 1, KPPK "*Deklarimi i të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit të shtetit mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur është marrë në pajtim me dispozitat e nenit (...). Deklaratat etilla mund të përdoren për ta kundërshtuar deklarin e të pandehurit në gjyq ose si provë e drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 262 paragrafi 2. të këtij Kodi.*"[theksimi është shtuar]. Nga ana tjetër, neni 262, par. 2, KPPK, thotë "*Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklarin të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit*". Së fundi, neni 346, par. 1, KPPK, thuhet "*I akuzuari ka të drejtë që të mos deklarojë. Nëse ai zgjedh që të deklarojë(...)*".

Kjo na sjell në gurthemelin, vlerën provuese (për arsyetimin e fakteve të vërtetuara) të deklaratave të mëparshme nga i pandehuri do të varen nga fakti nëse i akuzuari deklarohe apo jo në shqyrtimin gjyqësor - ku të gjitha provat paraqiten, neni 361. par. 1, KPPK.

Nëse i pandehuri në shqyrtimin gjyqësor zgjedh që të deklarohe, që të dëshmojë, deklaratat e tij të mëparshme mund të përdoren për të kundërshtuar dëshminë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nëse zgjedh për të mos dëshmuar, për të mos u deklaruar, atëherë deklaratat e mëparshme nuk mund të përdoren ose, së paku, nuk mund të përdoren në dëm të të pandehurit.

¹⁹Sa i përket të drejtës për të heshtur ajo mund të kuptohet në mënyrë të gjerë ose të ngushtë. Kuptimi i gjerë i referohet të drejtës së të akuzuarit për të mos u dëmtuar në bazë të heshtjes së tij. Në këtë konceptim, e drejta përmban disa domethënie ligjore ndër të cilat është e drejta për të mos fajësuar veten. Sipas konceptit të ngushtë e drejta e heshtjes i referohet të drejtës së një personi të mos merret parasysh heshtja e tij nga një gjykatë në vlerësimin e akuzave kundër tij apo në përcaktimin e dënimit të tij". Artikulli nga Rrjeti i Trajnimit Gjyqësor Evropian, në <http://www.ejtn.eu/Documents/Themis/Written%20paper%20Italie/Themis%20written%20paper%20Romania%202.pdf> f.9.

Trupi gjykues vëren se neni 261, par. 1, KPPK, thotë se "për të kundërshtuar dëshminë e të pandehurit në gjyq ose **si provë e drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 262, paragrafi 2**" (Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm, ose në një masë vendimtare, në deklaratat e dhëna nga i pandehuri në polici apo tek prokurori i shtetit), por kjo na çon në thelbin e problemit.

Edhe pse ligjvënësi ka theksuar se si një "provë drejtpërdrejtë" (e cila është në përputhje me nenin 123, par. 5, KPPK), ajo nuk mund të përdoret për të shpallur të akuzuarin fajtor, vetëm apo në një masë vendimtare, ligjvënësi nuk ka thënë në mënyrë eksplicite se kjo nuk vlen për rastet kur i akuzuari vendos qetë mos dëshmojë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Ky trup gjykues është i mendimit se nëse i pandehuri nuk dëshmon në shqyrtimin gjyqësor deklaratat e mëparshme të tij apo të saj nuk mund të përdoren aspak e më së paku nuk mund të përdoren në dëm të tij ose të saj.

Është e rëndësishme të theksohet si në vijim:

- Edhe deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë; ato mund të përdoren vetëm për të kundërshtuar (neni 123, par. 2), për të marrë në pyetje në mënyrë të tërthortë(par. 3). Ky është rregulli. Përjashtimet janë nëse dëshmitari ka vdekur, është i sëmurë ose pohon privilegjin e mungesës së pranisë në Kosovë (par. 3, *in fine*), ose në qoftë se ajo është një mundësi e veçantë hetuese (par. 4).

Prandaj, nuk do të ishte e arsyeshme për të kuptuar se ligjvënësi ka dëshiruar për t'i dhënë një vlerë më të lartë provuese (dhe me më të lartë", kuptohet "me më pak kërkesa që duhet të përdoren në mënyrë të ligjshme") për deklaratat e mëparshme të një (sipas definicionit, konsiderohet i pafajshëm) të pandehuri, sesa me ato të dhëna nga një dëshmitar.

Me gjithë respektin e duhur për mendime të ndryshme, një interpretim i ndryshëm ose përfundim në këtë drejtim mund të boshatis vlerën e vendosur vetëm në shqyrtimin gjyqësor për të heshtur; nuk është për asnjë arsye që të gjitha provat duhet të paraqiten në shqyrtimin gjyqësor dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të pandehurit janë të fundit - kur është fjala për të paraqitur prova, përkatësisht për të dëshmuar apo jo (dhe "jo" është duke heshtur).

- Një nga parimet kryesore në të drejtën penale është se në rast paqartësie interpretimi duhet të jetë në favor të të pandehurit; edhe pse tani ne nuk po diskutojmë të drejtën materiale penale, është e rëndësishme të marrim parasysh një prej dimensioneve të parimit të ligjshmërisë (neni 2, par. 3, të KPK-së lexon "Përkufizimi i një vepre penale duhet të shpjegohet në mënyrë rigoroze dhe interpretimi me analogji nuk do të lejohet. **Në rast të paqartësisë, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të një personi kundër të cilit procedurat penale janë në vazhdim e sipër "**) [theksimi është shtuar]; ne nuk shohim asnjë arsye për të marrë një qëndrim të ndryshëm apo qasje kur ne po e diskutojmë ligjin procedural, një normë procedurale. I gjithë ambiguiteti i përmendur i ligjvënësit, duke mos adresuar në mënyrë të qartë rastin kur i pandehuri vendos që të mos dëshmojë në shqyrtimin gjyqësor (siç ndodh në vende të tjera, për shembull, Portugali ²⁰ - ku deklaratat e mëparshme, mund të konsiderohen vetëm nëse ipandehuri ishte paralajmëruar më parë se në qoftë se ai ose ajo deklaroi gjatë fazës hetimore, ajo mund të përdoret kundër tij ose duke përfshirë edhe rastin e saj të përdorimit të drejtës për të heshtur gjatë shqyrtimit gjyqësor) dhe pasi që e kanë vënë atë në një dispozitë që fillon me "Deklarata të tilla mund të përdoren për të kundërshtuar dëshminë e të pandehurit në gjykatë " ka bërë trupin gjykues për të sqaruar interpretimin e tij të ligjit, në këtë mënyrë: deklaratat e mëparshme nga të pandehurit nuk janë të pranueshme në rast se i pandehuri përdor të drejtën për të qëndruar i heshtur gjatë shqyrtimit gjyqësor - dhe i pandehuri prezumohet ipafajshëm derisa një dënim nga një gjykatë merr formën e prerë²¹.

Pas shpjegimit të udhëzimeve në vlerësimin e provave, trupi gjykues nuk do të japë vlerën provuese të deklaratave të të pandehurve të cilët kanë heshtur në shqyrtimin gjyqësor (N.K., S.F. dhe H.B.). Deklaratat e mëparshme të dhëna në cilësinë e të pandehurve (jo si dëshmitarë) nga të pandehurit A.Z. dhe S.H., nuk do të vlerësohen kundër të bashkë-pandehurve dhe do t'i jepet vlerë provuese për të

²⁰Për shembull, dispozita e përcaktuar në nenin 141, par. 4, seksioni B, në Kodin e Procedurës Penale, sipas të cilit i pandehuri është informuar se në rast se ai ose ajo deklaroi se deklaratat mund të përdoren në shqyrtimin gjyqësor, edhe nëse ai ose ajo vendos të heshtin në atë kohë.

²¹Sa i përket prezumimit të pafajësisë, siç thuhet në nenin 6 §2 të Konventës, ai është një parim i shenjtë i çdo sistemi gjyqësor i themeluar mbi parimin e sundimit të ligjit dhe ai e përkthen idenë se një person i akuzuar për kryerjen e një vepre të natyrës kriminale, konsiderohet të jetë i pafajshëm derisa një aktgjykim i fajësisë të dorëzohet në gjykatë. Ky prezumim kërkon, ndër të tjerat, se gjatë kryerjes së detyrave të tij, gjykata nuk duhet të fillojë me idenë paragjyqëse se i akuzuari ka kryer veprën me të cilën ngarkohet. Në atë mënyrë, barra e provës është në ndjekjen penale, dhe nga çdo dyshim duhet të përfitojë i akuzuari [theksimi është shtuar]. Artikulli nga Rrjeti i Trajnimit Gjyqësor Evropian, në <http://www.ejtn.eu/Documents/Themis/Written%20paper%20Italie/Themis%20written%20paper%20Romania%202.pdf> f. 10.

vlerësuar deklaratat e të pandehurve në gjykatë ose si dëshmi të drejtpërdrejta, edhe pse gjykata nuk do të krijojë fakte që kah shpallja e të akuzuarve fajtor vetëm, ose në një shkallë vendimtare, pas deklaratave të tilla, të dhëna nga të pandehurit gjatë fazës hetimore.

Në lidhje me deklaratat e dëshmitarëve të mëparshëm, vlera provuese u përmend më lart, "edhe deklaratat e mëparshme nga dëshmitarët nuk mund të përdoren si dëshmi të drejtpërdrejta, ato mund të përdoren vetëm për të kundërshtuar (neni.123, par. 2), për t'i marrë tërthorazi në pyetje (par. 3).Ky është rregulli. Përrjashtimet janë nëse dëshmitari ka vdekur, është i sëmurë ose pohon privilegjin e mungesës së pranisë në Kosovë (par. 3, in fine), ose në qoftë se është një mundësi e veçantë hetuese (par. 4) ". Një situatë e paqartë mund të ndodhë në qoftë se gjatë gjykimit dëshmitari pretendon se mbetet pranë përmbajtjes së deklaratave të mëparshme që i ka dhënë ... Edhe në një rast të tillë, që duhet të shmanget, gjykata ende duhet të respektojë kriteret ligjore të sapo cekura dhe duhet të përdor shqyrtimin gjyqësor për të pyetur dëshmitarin se çfarë mund të jetë relevante dhe çfarëdo mospërputhje do të vlerësohet lirshëm nga trupi gjykues.

Dokumentet:

Të gjitha dokumentet relevante për procesin e vendimmarrjes janë marrë në konsideratë, gjykata nuk do t'i adresoj ato një nga një pasi që nuk e sheh të nevojshme ndërsa referenca të hollësishme ndaj një dokumenti të caktuar apo një grumbulli dokumentesh tanimë janë bërë kur janë vërtetuar faktet dhe referenca të tjera do të bëhen kur të shihet e nevojshme dhe vetëm kaq.

Përveç kësaj, për ta bërë më të lehtë, siç u tha, disa nga dokumentet relevante janë përmendur pas faktit përkatës.

Gjithashtu, disa nga faktet e vërtetuara janë vetë-shpjeguese dhe disa shpjegojnë të tjerat.

Kontrata në mes të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe organit mbikëqyrës "N. Company" është kërkuar nga Ministria më 17 shtator 2015; provat dokumentuese të pagesës së 5.000 Eurove nga H.B. për Ministrinë më 10/04/2007 nuk janë në dosjet e lëndës. Pronari i kompanisë, dëshmitari S.A. (seanca e datës 14/05/2014) ka theksuar se ai nuk e mbante në mend kush kishte përfaqësuar

Ministrinë kur ai kishte negociuar këtë kontratë por mbante mend se ai kishte nënshkruar atë në emër të kompanisë së tij.

Për sa i përket kthimit të 5.000 Eurove nga i pandehuri B. në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, lidhur me provat dokumentuese, mund të merret në konsideratë aktgjykimi i plotfuqishëm civil; edhe pse ky fakt nuk është mohuar nga askush gjatë procedurës se është kthyer nga banka; referenca e vetme ndaj datës së pagesës buron nga përmbajtja e ekspertizës së kryer nga R.B., i cili ka qenë eksperti financiar i gjykatës i caktuar nga Gjykata Ekonomike për të kryer ekspertizën (faqe 3 të raportit të tij “Ekspertizë Financiare lidhur me 50.000 Eurot”, ku eksperti thotë – në paragrafin e fundit – “sipas deklaratës së dhënë nga i pandehuri e cila është pjesë e dosjes së lëndës, i njëjti person më 10/04/2007 ka kthyer shumën prej 5.000 Euro në llogarinë e MTI-së përmes transferit bankar, ndërsa shuma tjetër prej 45.000 Euro nuk është kthyer deri në këtë moment të kryerjes së ekspertizës”.

Me një theksim të veçantë, gjykata vlerësoj marrëveshjen bazë apo kontratën dhe dy aneks kontratat si dhe dokumentin tjetër: pra urdhrat e përmendur për blerje brenda Thesarit, në Ministrinë e Financave, dhe urdhrat e përmendur për pagesa dhe ata të lëshuar nga “E.” dhe të nënshkruar nga i pandehuri B. (ata që më lartë përshkruhen si “A”, “B” “C” dhe “D” respektivisht, të datës 31/05/2006, “Situacioni i Pare Avansuas”, 20/06/2006, “Situacioni i Pare 20/06” dhe i datës 21/07/2006, “Situacioni i Dytë 3/2006”, “document 33”, dhe fatura 39/06). Dokumente e tjera ishin përmendur kur kishin qenë duke u vërtetuar faktet përkatëse. Kur është fjala për dokumentet që kanë të bëjnë me kërkesat për zotimin e mjeteve, së paku 2 prej tyre ishin nënshkruar nga i pandehuri S.F., njëri në shumën prej 400.000 Euros dhe tjetri në shumën prej 1.040.000 Euro, të datave 21/07/2005 respektivisht 31/05/2006.

Rasti në pikën 1 është bazuar mbi faktin që shuma prej 50.000 Euro nuk është zbritur nga pagesa prej 135.278,20 Euro, çfarë nuk është e qartë është se pse rasti nuk është ndërtuar mbi faktin e qartë të pagesës, pagesës së avancit para pagesës së 135,278.20 Eurove; më e rëndësishme se sa të diskutohet se pse nuk është bërë zbritja (pasi që zbritja është vetëm mjet për të zvogëluar dëmin, nuk e përjashton vet veprën penale) do duhej të ishte të sqarohej se pse një shumë është dashur të zbritet, a ka pasur ndonjë gabim në pagesën paraprake (pagesa e një shumë më të madhe se sa që është dashur të paguhet) ose a ka pasur ndonjë pagesë

e cila nuk ka mundur të kryhet? – Domethënë nëse një shumë është dashur të zbritet kjo është për shkak se kjo shumë nuk është dashur aspak të paguhej ... por gjykata beson se faktet e vërtetuara kanë hedhur dritë mbi këtë çështje.

Kërkesa e gjykatës për të dhënat kriminale të të pandehurit ka marrë përgjigje: Gjykata Themelore (GJ.TH.) Ferizaj më 05/04/2015, GJ.TH. Pejë më 30/04/2015, GJ.TH. Prishtinë më 09/03/2015, GJ.TH. Prizren 09/03/2015, GJ.TH. Gjakovë më 12/03/2015, GJ.TH. Gjilan më 20/03/2015 dhe nga GJ.TH. Mitrovicë më 13/03/2015.

Dëshmitarët:

Për sa i takon deklaratave të dhëna nga dëshmitarët, përsëri është e rëndësishme të përmendet se disa arsye tanimë janë cekur në këtë aktgjykim dhe se kjo pjesë e arsyetimit nuk synon përsëritjen provave dhe as të jetë përmbledhje e tyre. Megjithatë, do të përmenden disa fragmente apo referenca.

Për sa i takon komisionit të vlerësimit, dëshmitari N.G.(seanca e datës 28/05/201) ka dëshmuar dhe sqaruar pozitën e tij si kryesues i komisionit të vlerësimit për tenderin, ka deklaruar se ai ishte caktuar si kryesues i komisionit nga ish sekretari i përhershëm dhe pasi që ishte hera e tij e parë në një komision të tillë, ai kishte insistuar që përveç 5 personave të komisionit, të kishte edhe tre ekspertë ndërkombëtar për të ndihmuar komisionin. Dëshmitari A.B. (seanca e datës 16/07/2014) gjithashtu ka dëshmuar se ishte pjesë e një komisionit të tillë, në cilësinë e vëzhguesit të dhënies së tenderit. Ai vetëm ka theksuar se ai ishte pjesë e komisionit të vlerësimit si vëzhgues dhe se procesi i vlerësimit ishte kryer në një sallë të madhe. Ai nuk kishte ofruar ndonjë informacion relevant lidhur me këtë.

Për sa i përket rolit të organit mbikëqyrës, Kompanisë “N.”, dëshmitarët kësaj janë A.P. , S.A., N.G.dhe H.K.

Dëshmitari A.P. (seanca e datës 14/05/2014) përmendi Kompaninë “N.”, ai ishte një partner i jashtëm i Kompanisë “N.” dhe ishte caktuar për të mbikëqyrur punët e kryera nga operatori ekonomik “E.” në Parkun Industrial në D.. Ai theksoi se ishin edhe pesë persona të tjerë të caktuar për të mbikëqyrur punën në park dhe disa prej tyre ishin nga “N.” dhe disa të jashtëm. Detyra e organit mbikëqyrës ishte të sigurohej që puna ishte duke u kryer, ta vlerësoj atë dhe të paraqes raport të nënshkruar në zyrën e prokurimit, në mënyrë që të procedohet me pagesën/pagesat.

Ky dëshmitar për me tepër i kishte konfirmuar pagesat e avancit, “në mënyrë që Ministria të bënte pagesat e avancit dhe në rrethanat kur ne bënim krahasimet atëherë ne bënim zbritjet nga pagesat e avancit të kryera nga Ministria”.

Kjo shpjegon se si dëshmitari kishte mundësi të ishte në posedim të dokumenteve që më vonë do të “bëheshin” prova numër 5, ku shohim një shtyllë të “zbritjeve të dakorduara të pagesave të avancit” (përfshirë 50.000 Euro) dhe është e rëndësishme të ceket se pas këtyre 50.000 Eurove ka një heqje (në atë tabelë) të shumës prej 20.000 Eurove, pasi që në faqen e fundit të të njëjtës provë është lista e ngastrave duke filluar nga 50.000 Euro ndërsa 20.000 Eurot e përmendura janë të përfshira dhe të gjitha këto ngastra arrijnë totalin prej 140.689,60 Euro, e njëjta shumë që tanimë është adresuar.

Sërish, është e rëndësishme të ceket se në këtë rast, në dokumentin numër 33 nga “E.”, të datës 21/07/2006, “Situacioni I Dyte 3/2006”, ai që mbanë vulën dhe nënshkrimin e organit mbikëqyrës “N.” në rreshtin 9A E. thekson se 50.000 Euro duhet të zbriten nga ajo pagesë dhe në rreshtin 10, thekson se për pagesën sipas atij situacioni ishin vetëm 85.278,20 Euro.

Gjithashtu në seancën e mbajtur më 14/05/2014 dëshmitari S.A., i cili ka qenë pronar i Kompanisë “N.” ka theksuar se nuk i kujtohet me kënd (nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) kishte negociuar dhe nënshkruar kontratën për mbikëqyrjen e punëve, se ai kishte filluar mbikëqyrjen e këtij parku të projektuar pak më vonë, në maj 2006, jo nga fillimi dhe ai nuk e dinte kush i kishte mbikëqyrur punët para tij dhe nuk kishte dhënë shumë sqarime gjatë dëshmisë së tij.

Angazhimi i të pandehurit S.F. në projektin e Parkut Industrial në D., ishte përmendur nga dëshmitarja B.S. pasi ajo tha se faturat shkonin te ai si “Menaxher i projektit” para se të shkonin në departamentin e prokurimit. Edhe pse drejtori i S.F.t madje as nuk ishte akuzuar, N.G., ai gjithashtu ka thënë (përkundër asaj që për arsye evidente, shumë nga përgjigjet e tij ishin shumë të paqarta dhe shmangëse gjatë gjithë kohës) lidhur me S.F.n se kishte raste kur ai dilte në vendpunishte kur ngriheshin problemet për të rregulluar apo eliminuar problemet e tilla, gjithashtu duke kontaktuar qytetarët e përfshirë. B.D. gjithashtu ka theksuar se dalja në vendpunishte dhe inspektimi i punëve ishte detyra e S.F.t; ai gjithashtu ka thënë se Departamenti për “zhvillimin e bizneseve / ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”

(emri i divizionit pas mbarimit të vitit 2006) ka qenë përgjegjës për këtë projekt, ka thënë se “N.G. dhe S.F. ishin aty, XXX i Prokurimit, sigurisht, sepse ai ishte përgjegjës për kontratat dhe nga departamenti i administratës, sigurisht, këta ishin personat të cilët duhej të më përgjigjeshin mua për atë se çfarë kishte ndodhur”. Për sa i takon kontratës të lidhur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe kompania mbikëqyrëse “N.”, gjykata konsideron se ajo nuk përfshinë përgjegjësitë e atyre të cilët kanë punuar në Ministri – si pronare e projektit (ndryshe nga ajo çfarë ka thënë dëshmitari N.G.).

N.G. për më tepër ka sqaruar se organi mbikëqyrës bënte një raport dhe vlerësim mbi punët e kryera dhe pastaj, më vonë, departamenti i prokurimit “shqyrtonte këtë performancë të veçantë dhe pastaj kjo procedohej për pagesë dhe kjo bëhej pas nënshkrimit të sekretarit permanent” dhe ishte përgjegjësi gjithashtu e departamentit të prokurimit të vendoste nëse ndonjë faturë / pagesë e caktuar duhej të bëhej ose jo, duke u bazuar në raportin e bërë nga organi mbikëqyrës dhe pastaj pas vërtetimit të situatës zyra e prokurimit vetëm “krahasonte shumat nëse ishin të njëjta apo tejkalonin shumën e cila ofrohej me situacionin” dhe tha se departamenti i prokurimit dhe zyra e financave dhe sekretari i përhershëm miratonin urdhrin për pagesë. Për sa i takon pagesës në fjalë (50.000 Euro) tha se janë bërë disa “gabime” të njëpasnjëshme por “zyrtari certifikues është personi i fundit” (për të bërë kontrollimin). Në fund të dëshmisë së tij ai tha se nuk sheh ndonjë problem nëse ministria mbështetet në rolin vetëm të një kompanie për të bërë mbikëqyrjen e punëve për të cilat do të paguaj.

Më 5 qershor 2014 ka dëshmuar dëshmitari H.K. dhe ai sqaroi se si mbikëqyrës, para Kompanisë “N.”, kishte një zyrtar të MTI-së i cili ishte inxhinier dhe emri i tij ishte H.B. dhe pas tij kishte ardhur Kompania “N.” si organ mbikëqyrës. Z. H.B. kishte kryer mbikëqyrjen në fillim të vitit 2005 deri në fillim të vitit 2006 dhe pastaj në muajin prill ose maj 2006 Kompanisë N. i ishte dhënë mbikëqyrja e punëve.

Si përmbledhje:

Për sa i takon procedurës së pagesës, dëshmitari i përmendur N.G.ka theksuar se S.F. gjithashtu kishte shkuar në vend-punishte për të vëzhguar punët, ndërsa departamenti i prokurimit ishte përgjegjës për kryerjen e harmonizimit të

pagesave dhe sipas tij personi i fundit i cili do duhej të vërente shumën prej 50.000 Eurosh që ishte duke u paguar ishte zyrtari certifikues në departamentin financiar. Ai gjithashtu ka thënë se “departamenti i prokurimit i mbante librat lidhur me operatorin ekonomik E.”. Kur ishte pyetur lidhur me atë se cili divizion ishte përgjegjës për kryerjen e barazimit në mes të pagesave dhe faturave, ai sqaroi se procedura ishte: pasi kompania mbikëqyrëse merrte apo pranonte një performancë të caktuar atëherë zyra e prokurimit shqyrtonte këto performanca të caktuar dhe pastaj ajo procedohej për pagesë dhe kjo bëhej pas nënshkrimit nga sekretari i përhershëm. Ai theksoi se përgjegjësia për krahasimin e pagesave me faturat ishte mbi departamentin e prokurimit. Siç u tha më lartë, dëshmitari dëshmoi se kompetenca për të kontrolluar pagesat (nëse ishte paguar më shumë apo paguar më pak) ishte te zyra e prokurimit; megjithatë, sipas këtij dëshmitari personi i fundit për të vlerësuar dhe vërejtur gabimet do duhej të ishte zyrtari certifikues.

Dëshmitari B.D.në atë kohë ishte XXX i Tregtisë dhe Industrisë dhe ai e kishte pohuar se ai ishte njoftuar nga tash i pandehuri A.Z. për sa i takon 50.000 Eurove që i ishin paguar operatorit ekonomik E.. Menjëherë pasi që ishte informuar ai kishte bërë hetime për të gjetur nëse pagesa ishte për shkak të ndonjë gabimi apo ishte e qëllimshme. Pas këtyre hetimeve të kryera nga personeli i Ministrisë ai deklaroi se atij i ishte prezantuar një shkresë e nënshkruar nga operatori ekonomik “E.”, i cili kishte deklaruar me shkrim se do të kthente paratë në llogarinë bankare të Ministrisë dhe kjo letër i ishte sjell atij nga N.K., nga departamenti i prokurimit. Ai theksoi se ai i kishte thënë A.Z. “a e din se kjo është vepër penale dhe mund të shkosh në burg për këtë”, dhe ai i ishte përgjigjur atij se ai ishte mashtruar nga ata personat dhe nëse do duhej të shkonte në burg ai do shkonte por edhe N. do duhej gjithashtu të shkonte dhe unë e vërejta se ata kishin probleme mes vete.

B.S., zyrtarja certifikuese, ka dëshmuar më 4 qershor 2014. Ajo gjithashtu ka deklaruar se ajo ka punuar në Ministri gjatë periudhës 2003-2008 dhe fillimisht ka qenë zyrtare e financave dhe më vonë zyrtare certifikuese. Ajo ka deklaruar se gjatë kohës kur ajo ishte në pushim në periudhën 2005-2006 ajo ishte zëvendësuar nga S.H.. Për sa i takon pagesës së 135.275,28 Eurove, prej së cilës zbritja e pretenduar prej 50.000 Euro është dashur të bëhej, ajo ka theksuar se nëse një faturë do ishte sjell në atë shumë, domethënë e aprovuar së pari nga organi mbikëqyrës, atëherë pagesa duhet të bëhet në të njëjtën shumë. Për sa i takon asaj se çfarë zyrtarja certifikuese kontrollon në pagesë, ajo ka thënë se “dosja e

kompletuar e lëndës i dërgohet zyrtarit certifikues, me fondet e ndara, faturën, dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm që dosja e lëndës duhet të përmbajë është brenda dosjes së lëndës. Ato përfshijnë nënshkrimet e të gjitha autoriteteve apo organeve kompetente” Ky verifikim përfshinë inspektimin e faturave dhe gjithë dokumentacionit të nevojshëm, kontratave, shtojcave, fondeve të ndara etj. Në fund por jo më pak e rëndësishme, ajo ka theksuar se çdo herë që një pagesë është bërë ka qenë praktikë të merret kontrata dhe të kontrollohen kushtet dhe kjo ka qenë detyra e zyrës së prokurimit.

M.B. (e marrë në pyetje më 5 qershor 2014) si shefe e Departamentit të Financave gjersa shpjegonte procedurën e zotimit të mjeteve, ajo ka theksuar se në atë kohë, kur projekti ishte i planifikuar, fondet ndaheshin në bazë të kërkesës së bërë nga departamenti përkatës. Sipas kësaj, fondet zotoheshin dhe pastaj fillonin procedurat e prokurimit. Ajo sqaroi se, sipas praktikës, kontrata mbi projektin nuk duhet patjetër të jetë në shumën e njëjtë me fondet e zotuara, kontrata mund të jetë e një shumë tjetër nga shuma e zotuar për një projekt të caktuar. Ajo ka thënë se nuk e ka idenë se si është e mundur që janë dy fatura (20/06 dhe 39/06) me të njëjtën shumë të parave ndërsa përshkrimi i punëve në fatura është i ndryshëm dhe si, në anën tjetër, ekziston një rrethanë e cila në mënyrë të saktë e shpjegon shumën e cila është dashur të paguhet (dokumenti numër 33). Ajo ka theksuar se mbipagesa është vërejtur vetëm pasi që ajo ishte paguar dhe se S.H. kishte nënshkruar pasi që ishte duke e zëvendësuar zyrtarin certifikues, pasi që B.S. ishte në pushim në atë kohë. Ajo ka deklaruar se kontrata ishte lidhur nga zyra e prokurimit dhe faturat janë sjellë në atë zyrë. Si personi i cili i ka siguruar Prokurorisë raportin mbi pagesat e bëra për operatorin ekonomik “E.”, ajo ka sqaruar gjithashtu se rrethana e parë e avancit ka qenë një pagesë avanci, domethënë shuma prej 140,689.62 ishte paguar para se punët të fillonin por ajo nuk e ka sqaruar se çfarë kishte ndodhur me 50.000 Eurot që është dashur të zbriten gjatë pagesës së bërë për Kompaninë “E.”.

Lidhur me versionet kontradiktore, që vinin edhe nga i njëjti person, ne mund të shohim se, për shembull (dhe ky është vetëm një shembull ...), i pandehuri A.Z. ka theksuar se ishte bërë një pagesë avanci dhe më vonë kishte thënë se nuk ishte pagesë avanci por ishte pagesë për punët ... (shih si shembull raportin e auditimit, faqe 4 pika 2 e) dhe f. 12 të seancës së mbajtur më 12 shtator 2014) kundër paragrafit të parafundit të faqes 2 të procesverbalit të seancës së mbajtur më 30 shtator 2014, “po, unë kam qenë ushtrues detyre i sekretarit të përhershëm

mirëpo nuk ka pagesë avanci por vetëm pagesë për kryerjen e punëve pra siç u përmend nuk është lejuar pagesa e avancit”). Ky versioni (i fundit) që nuk ka pasur pagesa të avancit është përsëritur në seancën e mbajtur më 30 shtator dhe 4 nëntor 2014. Gjithashtu i pandehuri S.H. kishte mendime të ndryshme lidhur me atë nëse kontrata lejonte apo nuk lejonte kryerjen e pagesave të avancit, pasi që në seancën e mbajtur më 5 janar 2015, në faqe 6 të procesverbalit, ai thotë kontrata nuk ishte e qartë në lidhje me mos-pagesat e avancit, në faqe 7 ai ishte i sigurt se nuk kishte pagesa të avancit, por pastaj ai gjithashtu thotë se ka certifikuar pagesën sepse çdo gjë ishte në rregull dhe më vonë në faqe 17 shkurtimet u bënë të qarta pasi që tash çdo gjë varej nga fatura.

Për sa i takon sekuencës lidhur me nënshkrimin e dokumenteve që kanë të bëjnë me procesin e pagesës, përsëri vështirë që kemi të bëjmë me versionin e njëjtë ...Sipas dëshmitarëve B.S., M.B., S.R. dhe të pandehurve S.H. dhe A.Z. ekzistojnë praktika të ndryshme, versione të ndryshme të të njëjtit realitet.

Sipas dëshmitares B.S. sekuenca e nënshkrimeve për të lejuar një pagesë (intervista para shqyrtimit gjyqësor që ajo iu është përmbajtur gjatë gjykimit) ishte: pas përpilimit të faturës fatura kontrollohet nga menaxheri i projektit i cili ishte S.F., pastaj ajo duhet të dërgohet në departamentin e prokurimit apo te sekretari i përhershëm dhe pas nënshkrimit nga ana e tyre fatura kalonte tek zyra e financave dhe nënshkruhej nga zyrtari certifikues dhe gjithashtu ajo është dashur të nënshkruhej më parë nga zyrtari aprovues.

Dëshmitarja M.B. ka sqaruar se B.S. ishte Zyrtare Certifikuese, S.H. zyrtar për zotimin e mjeteve dhe në pyetjen e prokurorit në lidhje me procedurën e pagesës pas përfundimit të punëve, ajo u përgjigj se fillimisht përfundohen punët e kontraktuara në mënyrë që punët e kryera të pranohen dhe ne pranojmë faturën që dorëzohet në zyrën e prokurimit (shefi i së cilës në atë kohë ishte N.K.) për nënshkrim dhe pastaj ajo nënshkruhej nga sekretari i përhershëm; më pas fatura pranohej nga zyra e financave. Në rastin konkret, formulari ishte përgatitur nga S.H., më pas është përcjellë për nënshkrimet dhe nënshkruar nga N.K.. Ka ekzistuar edhe një formular për pranimin e mallrave. Pasi që shumica ishte mbi 5,000 euro ajo duhej të nënshkruhej gjithashtu edhe nga Sekretari i Përhershëm, A.Z.. Pas marrjes së nënshkrimeve, është nënshkruar nga zyrtari certifikues S.H. dhe pastaj ajo ka shkuar te Thesar. Ajo gjithashtu tha se pastaj ne bënim fotokopjimin e

lëndës: një kopje mbetej në Ministri ndërsa kopja origjinale e faturës dërgohej në Thesar, dhe në thelb kjo ishte sekuenca e nënshkrimeve që duhej të jepeshin kur pranohej një faturë.

Dëshmitari H.K., i cili ka qenë zyrtar i prokurimit në Ministri, dhe, siç tha tashmë (në seancën e datës 5 qershor 2014), në lidhje me rendin procedural që shpinte në një pagesë, ka thënë se ajo fillonte me zyrtarin e prokurimit të kompanisë mbikëqyrëse që sillte dokumentet dhe pastaj kompania që kryente punët dorëzonte faturat. Fatura vinte në zyrën e prokurimit që e kishte radhën të dërgonte faturën te Sekretari i Përhershëm për nënshkrim dhe pastaj ajo procedohej më tej. Në faqe 35 të procesverbalit të seancës në fjalë, ky dëshmitar paraqiti edhe versionin e tij, si në lidhje me ndarjen e mjeteve ashtu edhe në lidhje me pagesat: "Unë kam bërë përshkrimin nga ndarja e mjeteve deri në lëshimin e urdhërpagesës. Formulari për ndarjen e mjeteve nënshkruhej nga sekretari dhe zyrtari i buxhetit pastaj nga certifikuesi ndërsa dokumenti për pranimin e mallrave nga Zyrtari i Prokurimit dhe zyrtari i ngarkuar për pranimin e punëve dhe personi i fundit për të nënshkruar është zyrtari certifikues".

Dëshmitari S.R., gjatë dëshmisë së tij nuk ka ofruar dëshmi në lidhje me sekuencën e nënshkrimeve që është dashur të ndiqet kur një faturë duhej miratuar; Megjithatë, ai theksoi se duke e ditur procedurën që duhej ndjekur, pagesa prej 50,000 euro mbi shumën e caktuar nuk është dashur të ndodhte.

Dëshmitari H.Z. (ka dhënë dëshmi në seancën e mbajtur më 17 korrik 2014) ka punuar më parë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në mes të viteve 2003 dhe 2010 si zyrtar pranimi. Ai ka deklaruar se një pagesë avanci gjithmonë duhet të parashihet në kontratë dhe kontrata duhet të përcaktojë nëse do të bëhet ndonjë pagesë avanci ose jo. Ai nuk ishte në dijeni për kushtet e veçanta të kontratës në atë kohë; megjithatë, ai e dinte (më vonë gjatë deklaratës së tij) se një pagesë avanci ishte kryer për "E", pasi që nga faturat atyre iu duhej çdo herë të zbritnin një shumë të pagesës.

Ai deklaroi se si zyrtar pranues ishte një kolonë ka ai duhej të shkruante kështu që ai nënshkruhej në atë kolonë ku shkruante "pranimi i gjërave". Në këtë rast të caktuar një trup mbikëqyrës (kompania "V.") i cili, përveç ministrisë, do ta

kryente mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimitarisë. Pos nënshkrimit të tij ai deklaroi se ato nënshkrime shtesë do t'i përfshinin emrat e sekretarit që në atë kohë ishte A.Z. dhe të tjerët në radhë ishin B.S., S.H., N.K. dhe ai vet. Ai është pyetur për sekuencën e nënshkrimeve të lartpërmendura, “kush duhet të jetë sipas mendimit tuaj, kush ishte kryesisht personi përgjegjës për bërjen atij bilanci”, të mos e bëjë zbritjen nga fatura, dhe ai deklaroi se sekretari ishte përgjegjës për tërë stafin, jo për stafin politik, por për tërë stafin dhe sekretar i përhershëm ishte A.Z. dhe prandaj ai ka mundur ta bënte bashkërendimin përfundimtar mes faturave dhe pagesave nëse diçka nuk përputhej ose nuk barazohej, para fundit të procesit. Ai gjithashtu (faqet 21 dhe 22, mes tjerash) përmendi në versionin e tij (dhe e ka ndryshuar...) lidhur me sekuencën e nënshkrimeve deri te pagesa.

Sipas S.R. (seanca e datës 17 korrik 2014) ishte detyrë e komisionit (domethënë e trupit mbikëqyrës, kompania “V.”) dhe e sekretarit të përhershëm, bashkë me komisionin teknik për ta bërë barazimin (të punimeve të ekzekutuara dhe pagesave) dhe në atë kuptim që nuk duhet të paguhen 50.000 euro më shumë. Derisa i përgjigjet prokurorit lidhur me personin i cili është dashur t'i krahasonte para-pagesën me faturat për punimet e kryera, deklaroi se pas zyrtarit pranues, do të shkonte në zyrën e prokurimit ose nëse kompania ka një shërbim të atillë, shkon përmes shërbimit të menaxhimit të kontratave, një zyrë kjo brenda departamentit që apostafat merret me çështje të atilla.

Ai gjithashtu dëshmoi lidhur me çështjen e pagesës derisa është marrë në pyetje nga A.Z., pasi që i pandehuri Z. deklaroi se ai nuk e ka nënshkruar ose nuk ka lejuar ndonjë para-pagesë dhe dëshmitari deklaroi se paradhënia mund të lejohet vetëm me nënshkrimin paraprak të sekretarit të përhershëm ose të personit enkas të autorizuar nga sekretar i përhershëm.

Sipas të pandehurit A.Z. në seancën e datës 26 shtator 2014 (faqet 6 - 10), fillimisht trupi mbikëqyrës e sjell kërkesën për pagesë dhe ia dërgon departamentit të prokurimit, gjegjësisht N.K.t, pastaj pas departamentit të prokurimit e njofton departamentin që e implementon projektin, në ish departamentin për zhvillimin e bizneseve të vogla (atëherë XXX ka qenë N.G.), pastaj dokumentet do të shkonin në departamentin e pranimit të aseteve dhe projekteve, të “zyrtari i aseteve”, i cili ishte H.Z., pastaj ai e pranon asetin dhe pastaj zyrtari i prokurimit duhet ta nënshkruajë kërkesën dhe pa u aprovuar nga ky zyrtar nuk shkonte për pagesë (N.K. si pala nënshkruese e kontratës), në fund, e

tërë dosja do të shkonte në departamentin e financave dhe atje ata duhej t'i kontrollonin faturat dhe shërbimet, ta kontrollonin kontratën nëse kishte ndonjë tejkalim, dhe nëse gjërat ishin në rregull ata mund ta bënin pagesën dhe personi kyç për ta nënshkruar faturën ishte S.H. Në fund, në Tehsar, S.G. e lejoji pagesën dhe ai ishte filtri i fundit në pozitë për ta ndalur pagesën. Gjithashtu tha se sekretari i përhershëm nuk duhej ta nënshkruante faturën (nënshkrimi i tij ishte falsifikuar për ta shantazhuar) dhe gjithashtu tha se “pas mbylljes së këtij rrethi, komplet doja shkon në departamentin e financave sepse proceduar e pagesës është kryer. Kur të arrijë atje ata duhet t'i kontrollojnë faturat dhe shërbimet, ta kontrollojnë kontratën nëse ka tejkalime dhe nëse e shohin që gjendja e gjërave është në rregull mund ta bëjnë pagesë (...) Personi kyç financiar ishte S.H.: (shihni faqe 9, seanca e datës 26 shtator 2014).

I pandehuri S.H. e shpjegoi versionin e tij të sekuencës së nënshkrimeve që duhej siguruar që pagesa të realizohej në seancën datës 12 dhjetor 2014(f. 6 për hierarkinë, f. 10 për zotimin e fondeve, f. 11 për sekuencën e nënshkrimeve – pas së cilave gjëra duhej kontrolluar kontrata...) si vijon: para se fatura të shkojë te sekretari i përhershëm ku është dikush i cili e pranon atë në ministri si zyrtar pranues (në atë kohë ky ishte H.Z.) dhe pastaj do të shkonte te sekretari i përhershëm (A.Z.) dhe pastaj pas departamentit të prokurimit të nënshkruhej nga N.K.; pastaj do të shkonte te zyrtarja certifikuese (B.S.), pro pasi që ajo ishte në pushim ai e nënshkroi në emër të saj pasi që ishte i autorizuar ta bënte këtë dhe e qartësoi se zyrtari certifikues ishte ai që kontrollonte nëse çdo gjë është nënshkruar. Pas nënshkrimeve e tërë dosja e rastit shkon në Thesar për ekzekutim dhe zyrtar në at kohë ishte S.G. i cili nënshkroi për atë pagesë.

Lidhur me vulën, i pandehuri A.Z. në seancën e mbajtur më 12 shtator, f. 6, deklaroi se dikush e kishte përdorur vulën e tij, ndërsa në seancën e mbajtur më 26 shtator, f. 14/15, deklaroi se ndoshta një vulë tjetër (e falsifikuar) me faksimilen e tij ishte punuar – ndoshta sepse dëshmitari i tij i mbrojtjes, sekretari i tij (dëshmitari H.), nuk tha ose nuk konfirmoi se faksimilja e tij ka mundur të merrej, të përdorej nga dikush tjetër...pasi që ishte në zyrën e tij dhe askush nuk mund të hynte.

H.K. i cili ka qenë zyrtar i prokurimit brenda ministrisë dhe, siç tashmë u theksua, dëshmoi më 5 qershor 2014 lidhur me aneksin, ai deklaroi se aneks kontrata, lidhur me punët shtesë, nuk mund të tejkalojë 10%. Maksimumi që mund

të shkojë është 10%. Ai pastaj e shpjegoi sekuencën e nënshkrimeve derisa është marrë në pyetje nga prokuroria.

Gjykata i konstatoi faktet përtej dyshimit të arsyeshëm. Të gjitha provat e paraqitura gjatë seancave janë regjistruar fjalë për fjalë, dhe janë më dispozicion për rivlerësim, nëse ka nevojë.

C 2) Faktet që nuk janë vërtetuar

Faktet që nuk janë vërtetuar janë vetëm faktet që “nuk janë vërtetuar” dhe “nuk janë vërtetuar” do të thotë se nuk ishte e mundur të vërtetohen, ngase nga këndvështrimi juridik ato nuk kanë ndodhur.

Të gjitha faktet e përmendura në aktakuzë të konsideruar që nuk janë vërtetuar, nuk janë vërtetuar, dhe nuk ka nevojë të përsëriten këtu. Megjithatë, gjykata i veçon faktet në vijim që nuk janë vërtetuar:

Akuza 1

C.2.1 – Rrethanat e sakta në të cilat faksimilja e A.Z. përfundoi në krye (në anën e djathtë) të dokumentit të quajtur “fatura” 39/06.

C.2.2 – Se në bazë të kërkesës së të pandehurit N.K. dhe me pëlqimin e të pandehurit H.B., shuma prej 50.000 eurove. më mirë të thuhet 45.000 euro, i është dhënë personalisht të pandehurit K. i cili i kishte thënë B. se ai vet do ta dorëzonte këtë shumë në buxhetin e MTI-s.

Akuza 2

C.2.3 – Nga data 14.09.2005 kur komisioni vlerësues e përpiloi raportin mbi vlerësimin dhe rekomandimin e tenderëve për dhënien e kontratës lidhur me tenderin e ndërtimit të infrastrukturës në pjesën industriale në D. Nr.

MTI/22/07/2005, me ç’rast kompanisë “E.” me pronar H.B., iu dha kontrata dhe deri në përfundim të punimeve të kontraktuara nga kjo kompani më

31.12.2007, i pandehuri N.K. si person zyrtar, drejtor i departamentit të prokurimit, dhe S.F. si person zyrtar, udhëheqës i Agjencisë për Përkrahje të Ndërmarrjeve dhe të Zhvillimit Regjional dhe i angazhuar në Departamentin e Zhvillimit të Sektorit Privat, që të dy në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, duke vepruar në koordinim dhe bashkëpunim me njëri-tjetrin, pranuan ryshfet nga i pandehuri H.B..

C.2.4 – I pandehuri H.B. në emër të ryshfetit i dha këto shuma: të pandehurit N.K. gjithsej shumën prej 180.000 eurove dhe të pandehurit S.F. shumën prej 50.000 eurove.

C.2.5 – I pandehuri S.H. derisa vepronte në cilësinë e zyrtarit financiar, kah fundi i vitit 2007 i telefonoi H.B.dhe i tha, “a dëshiron që t’i transferoj të gjitha paratë” dhe derisa i pandehuri B. tha që nuk ishte e mundur, i pandehuri S.H. u përgjigj, “është e mundur por duhet të m’i japësh 3.000 euro”. H.B. i tha se nuk ishte problem. S.H. pastaj ia transferoi të gjitha paratë H. B..

Akuza 3.

C.2.6 – Pavarësisht aneks kontratës të nënshkruar më 20.07.2006 mes të pandehurit N.K. dhe përfaqësuesit ë kompanisë “E.” (të pandehurit H.B.), me aneks kantatë u ndërrua shuma e kontratës së parë prej 144.000 eurove në 1.730.000 euro, duke e tejkalar kështu shumën e kontratës së parë për 10% dhe ai kështu i shkaktoi dëme materiale buxhetit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në shumë prej më shumë se 100.000 euro.

Arsyetimi (pa asnjë paragjykim ndaj arsyetimit të mëparshëm të fakteve të vërtetuara konstatuara):

Përveç asaj që tashmë është thënë më lart, e cila aplikohet këtu *mutatis mutandis*, në këtë “arsyetim negativ”, ka disa aspekte që vlejné të theksohen, edhe pse dhe përsëri, siç u tha më herët, kjo nuk duhet të jetë përsëritje e provave të paraqitura dhe duhet të kuptohet në lidhje, në koordinim, me arsyetimin e fakteve të vërtetuara.

Akuza 1

Të gjitha dokumentet që ekzistojné dosjen e rastit janë kontrolluar dhe, kur ishte relevante, janë përmendur në këtë aktgjykim.

Akuza 2

Lidhur me faktet që do të ishin relevante për veprën penale marrje e ryshfetit, pos deklaratave të të pandehurit B. (vlerësimi i deklaratave të të pandehurit dhe të dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor tashmë është adresuar më

lant), deklaratat e dëshmitarëve kryesor lidhur me këtë çështje do të shqyrtohet hollësisht, përkundër kësaj tashmë është thënë se arsyetimi nuk duhet të jetë përsëritje e çdo prove – megjithatë, aspektet kryesore do të përmenden, marrë parasysh rëndësinë e kësaj akuze, dhe për të mundësuar të kuptohet vendimi i këtij kolegji lidhur me këto fakte.

Duke marrë parasysh se çka është thënë lidhur me deklaratat e të pandehurve, kundërthëniet eventuale ose mospërputhjet që përmbajnë ato, nuk do të përmenden. Por duhet përmendur se nga pasqyra e provave të shtjelluara në aktakuzë, ka shumë gjëra që nuk kanë kuptim fare për një vëzhgues objektiv, qofshin ndryshime e vazhdueshme në shuma (dhe shuma totale nuk përputhet me shumat nën-totale, etj. ; shumat e pretenduara të dhëna si ryshfet nuk përputhen me njëra tjetrën dhe ky është vetëm njëri nga shembujt e mundshëm, nga 180.000 euro, sipas vet aktakuzës, në total arrin në 233.000 euro: 180.000 euro për të pandehurin K., 50.000 për të pandehurin F. dhe 3.000 euro për të pandehurin H., pa i përmendur shumat e tjera nga 1.000 euro ose 2.000 euro që pretendohet të janë dhënë vazhdimisht), qofshin në sekuencën e fakteve dhe të të dhënave të tjera.

Gjithashtu është disi e paqartë , sipas vet aktakuzës, se cili ka qenë kriteri për t'i akuzuar disa individë dhe për t'i lënë të tjerët si dëshmitarë, ose si disa deklarata mund të pranohen nëse vijnë nga dikush i cili zhvillon biznes të rregullt si ndërtimtar (pasi që i pandehuri B. ka qenë ndërtimtar në këtë rast) lidhur me procedurat e pagesës dhe kthimit (pagesës) së shumave të parave pa i dokumentuara ato – sipas tij.

Rasti i parë i “dhënies së ryshfetit” do të ishte takimi një ditë pasi që komisioni vlerësues e kishte kryer vlerësimin, domethënë, në 15.09.2005 dhe kjo do të kishte ndodhur në restorantin T. dhe të pandehurit K., F. dhe B. (pretendohet) janë takuar në praninë e H. Z., ku shuma prej 180.000 eurove është kërkuar nga K. (për veten e tij dhe për F.) nga B. si kusht për atë të fundit për t'i filluar punimet.

Dëshmitari H.Z. (seanca e datës 17.07.2014) e përmendi takimin me B. në zyre, në ministri, dhe gjithashtu e përmendi një takim të rastësishëm në hotelin “P.” (jo T.) dhe se atij (askujt tjetër) i shkrepiti ideja të ndalej atje për t'i parë disa shokë, duke mos e ditur se B. dhe K. kishin kontakt tjetër atje, pos që B. iu bashkua atyre (Z., K. dhe të tjerët, disa shokë) në të njëjtën tavolinë për një kafe dhe kjo ishte pasi që B. i telefonoi K. për ta pyetur ku ishin. Sipas këtij dëshmitari, asgjë

nuk i ishte dhënë K. dhe biseda ishte e parëndësishme (për gjërat e “rëndomta, të rastësishme”).

Rasti i dytë do të kishte ndodhur 2 ditët e ardhme, rreth datave 16 ose 17.09.2005, në (afër) “K.”, ku B. e dërgoi punëtorin e tij Y.C. për t’ia dorëzuar një qese plastmase N. K. me 100.000 euro.

Dëshmitari Y. C. (seanca e datës 13.05.2014) do të oshte dëshmitari kyç, bashkë me Z.M.

Që të dy dëshmitarët deklaruan në njëfarë mënyrë se disa fakte lidhur me dhënien e ryshfetit mund të vërtetoheshin. Por, deklaratat nuk janë të qëndrueshme pasi që nuk mjaftojnë për t’i vërtetuar faktet përtej dyshimit të arsyeshëm – akomatë arsyeshëm sipas vlerësimit të trupit gjykues.

Dëshmitari Y.C. nuk e tha të njëjtin version dy herë(dhe kjo mund të merret parasysh, duke marrë parasysh mënyrën se si deklarata është dhënë në shqyrtimin gjyqësor): në polici (më 20.09.2011) ai kryesisht deklaroi se herën e parë që ishte i pranishëm kur H. shkoi për t’i dhënë diçka zyrtarëve të MTI-s, në mbrëmje, në hotelin Iliria; herën e dytë atij iu dha një qese plastmase(ngjyrë të zezë, pas një pyetjeje tjetër...) për t’ia dhënë K. dhe ai (dëshmitari) i takoi K. dhe S. afër “Kurrizit” dhe ia dha qesen K. por disa pyetje më vonë ai tha se nuk e dinte se kujt ia kishte dhënë qesen. Në prokurori (më 16.01.2012) dëshmitarit deklaroi se herën e parë, rreth mbrëmjes, në hotelin I., H. ia dha këtë qese të zezë 2 personave të cilët iu bashkuan kur ishin të ulur atje rreth tavolinës, dhe herën e dytë, H. këmbënguli se ai (dëshmitari) do të shkonte me atë (H.) për ta takuar K. në mbrëmje, në restorantin afër “K.” dhe pastaj H. ia dha K. një qese të zezë plastmase dhe pasi që ishte errësirë dhe pasi që qëndronte në këmbë, nuk mundi të shihte nëse ishte edhe dikush tjetër me K., gjithashtu duke deklaruar të dinte se H. shkoi për ta takuar K. me qese dhe se u kthye pa qese, por disa pyetje më vonë, dëshmitari thotë se e ai i pa H.n dhe K. me njerëzit e tjerë të cilit ishin me atë, që ai mund t’i shihte njerëzit ulur rreth tavolinës.

Në të dy intervistat, rastet, ai tha se H. i ka thënë se për ta marrë punën ai duhej t’i jepte diçka zyrtarëve të MTI-s dhe se ai (dëshmitari) kurrë nuk e ka ditur se çka ka pasur brenda në qese (t).

Në shqyrtimin gjyqësor, dëshmitari deklaroi se e kishte thënë të vërtetën në të dy intervistat e lartpërmendura (përkundër mospërputhjeve dhe ndryshimeve në përshkrimin e fakteve nga njëri-tjetri) dhe gjatë marrjes në pyetje nga trupi gjykues, deklaroi të mos e mbante në mend se H. i kishte thënë që për ta fituar projektin ai duhej të jepte diçka, konfirmoi se një herë ai shkoi bashkë me H.n për ta takuar K. dhe S. në hotelin I. dhe se H. pastaj ua dha qesen e zezë dhe se në një rast tjetër, kur tashmë ishte errësuar, ai me H. shkuan në një vend afër “Kurrizit” dhe H. ia dha qesen K. i cili ishte atje me një person tjetër.

Lidhur me disa mospërputhje dëshmitari deklaroi të mos mbante në mend të ketë thënë gjëra të tilla në polici. Deklaroi se nuk e dinte çka kishte në qese.

Deklarata e dëshmitarit ndryshon gjatë kohës dhe nëse disa gjëra do të mund të konsideroheshin si “çështje detaji”, të tjerat nuk mundën: për shembull, mos mbajtja në mend se cila ishte arsyeja që H. i tha për takimet me zyrtarët, të cilët (ai ose B.) e dorëzuan qesen herën e dytë, i cili ishte (ose nuk ishte) i pranishëm herën e dytë pos K. dhe B..

Mund të thuhet se dëshmitari është duke e thënë të vërtetën, edhe pse me mospërputhje, por gjithashtu mund të thuhet se dëshmitari gënjen, pasi që versionet nuk përputhen dhe në secilin rast ai ishte njoftuar për detyrën e tij për ta treguar të vërtetën dhe se gënjimi ishte vepër penale; një gjë është e sigurt, dëshmitari gënjeu së paku në njërin nga versionet e paraqitura. Faktet kyçe të përmendura nuk mund të përzihen, “të mbuluar me hije”, deri në këtë masë nëse dëshmitari e ka thënë të vërtetën.

Tash shtrohet pyetja nëse pos kësaj, kjo lloj “deklarate” akoma mund të përdoret për ta argumentuar një vendim përtej dyshimit të arsyeshëm: - Në vlerësimin e këtij trupi gjykues, jo. Gjykata nuk ka të dhëna të mjaftueshme për t’i vërtetuar faktet të cilat dëshmitari i paraqiti dhe prandaj ato nuk janë vërtetuar, dhe nuk janë vërtetuar do të thotë vetëm se gjykata nuk thotë se faktet nuk kanë ndodhur; ajo që gjykata thotë është se deklarata(t) e dëshmitarit janë dhënë në mënyrën në të cilën nuk lejohet të vërtetohen.

Nuk është vetëm rast i kundërtënieve mes një personi dhe personi tjetër (ose madje edhe ballafaqim), është një rast kundërtënieje në deklaratat e personit të njëjtë dhe deri në masën që të lejon të thuash se dëshmitari gënjen, së paku

pjesërisht, dhe kjo e zbeh besueshmërinë për ta argumentuar një vendim të bazuar në deklaratat e atilla. Kjo gjithashtu vlen edhe lidhur me ballafaqimin që ka ndodhur mes këtij dëshmitari dhe të pandehurit B., në aspektin që përsëri versionet nuk përputheshin. Deklarata e dëshmitarit nuk është vetëtuar nga asnjë deklaratë tjetër, të dhënë nga dëshmitari A.B., i cili gjithmonë e ka paraqitur të njëjtin version (seanca e datës 16.07.2014 dhe deklaratat e seancave përgatitore të datave 20.11.2011 dhe 19.01.2012).

Gjithashtu lidhur me kredibilitetin e dëshmitarit Y.C., gjykata thekson se në këtë rast, kundërthëniet nuk ishin nga faza përgatitore deri te faza e gjykimit, sepse vitet kishin kaluar; ato ndodhën gjithashtu brenda rreth 3 muajve e gjysmë – mes deklaratës në polici dhe në prokurori.

Kjo na çon te një dëshmitar tjetër që ndoshta ndihmon në vlerësimin e fakteve, duke i marrë parasysh përmbajtjet e deklaratave dhe të pyetjeve që i janë parashtruar dëshmitarit Y.C.: në ballafaqimin e datës 14.05.2015, në të cilën datë, sipas versionit të paraqitur nga dëshmitari (bazuar në versionin e B.), ai kishte shkuar për t’ia dorëzuar K. 100.000 euro bashkë me dëshmitarin Z.M. Dëshmitari Y.C. nuk e përmend të këtë shkuar me Z.M. në asnjë rast dhe dëshmitari Z.M. në asnjë rast nuk e përmend Y. ose të këtë shkuar me atë për t’ia dorëzuar një qese K. në (ose afër) “Kurrizit”; më parë ai flet për vendin tjetër, restorantin “A.B.” në magjistralen Prishtinë – Pejë. Deklarata e këtij dëshmitari do të analizohet pastaj.

Rasti i tretë i përmendur në akuzën 2 ishte një takim mes të pandehurve B. dhe Krasniqi, “të nesërmen” (17 ose 18.09.2005) në restorantin “A.B.”, ku K. supozohet t’i këtë pranuar 35.000 euro nga B..

Për këto fakte të para me rëndësi është deklarata e dëshmitarit Z.M. (seanca 13.05.2014), i cili e konsideron veten si familje e B. dhe në gjykim deklaroi se kur ai (Z.M.) ishte marrë në pyetje, ai e kishte thënë të vërtetën. Dëshmitari deklaroi të ishte shoferi i B. dhe se shkonte shpesh me atë në restorantin “A.B.”.

Në esencë, gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëshmitari e konfirmoi atë që e kishte thënë më parë në dy intervistat e përmendura, në polici më 10.10.2011 dhe në prokurori më 16.01.2012 dhe ato 2 deklarata ishin në përputhje me njëra-tjetrën: kryesisht ai deklaroi çfarë i pandehuri B. i kishte thënë atij në veturë derisa e ngiste

, se (B.) do t'i taktonte zyrtarët e MTI-s për t'ua dhënë paratë, ai nuk di emra, B. doli me qese (dëshmitari nuk e dinte çka kishte në të) dhe ai qëndroi në veturë në parking duke e pritur B. , B. u kthye pas pak kohe me të njëjtën qese, ai nuk e pa askënd duke i dhënë ndonjë gjë dikujt dhe në parking ai e kishte parë një automjet të MTI-s.

Në gjykim, pas “pranimit” të deklaratave të tija të mëparshme, ky dëshmitar pranoi se dinte (vetëm) çka B. i kishte thënë, që nuk ishte një “qese” por një “çantë” që B. e kishte me vete, nuk e dinte kë saktësisht B. do ta takonte atje, nuk i kujtohej më nëse e kishte parë apo jo automjetin e MTI-s në parking dhe nuk i kujtohej më se para sa dite e kishte dëgjuar bisedën mes B. dhe Y.C. për dhënien e parave zyrtarëve të MTI-s.

Lidhur me këtë deklaratë, vlen të theksohet: në njërën anë ai nuk di emra, nuk ka parë asgjë t'i është dhënë dikujt dhe në anën tjetër, ai deklaroi se çfarë thotë ai në thelb është ajo çka i kishte thënë B.. Pa marrë parasysh çka ka thënë lidhur me shqyrtimin e deklaratave të mëparshme të të pandehurit, përsëri neni 123 paragrafi 5 i KPPK duhet të mbahet në mend, në kuptimin që deklarata e të pandehurit (të B.) do të ishin së paku (të mos themi “e vetmja”) provë vendimtare fajësuese për dënim (për bashkë-pandehurit).

Ngjarja e katërt nuk ka datë, pretendohet të ketë ndodhur gjatë ekzekutimit të kontratës në “Hotel P.” (“Hotel P.” sipas fotove në dosjen e rastit) në M., ku pretendohet që K. i mori 45.000 euro nga B. në praninë e A.SH.

Dëshmitari A.SH. tha gjëra të tjera, edhe gjatë seancës së njëjtë; për shembull, lidhur me nëse e ka parë B. duke i dhënë diçka një personi, së pari tha se nuk e ka parë, pastaj tha që kishte parë të jepej diçka nën tavolinë por nuk e ka ditur se çka. Gjërat e tjera të palogjikshme janë përmendur si p.sh. që dëshmitari i mbante në mend dy qese (njëra ishte e plastmasës), se si dukeshin para dhe pas takimit (jo të zbrazëta), por nuk e dinte ngjyrën, as nëse ishin ngjyrë të çeltë apo të mbyllur qeset që i kishte **parë** (theksimi është shtuar, e kishte “parë” në mënyrën e njëjtë që e kishte parë materialin nga i cili ishin prodhuar dhe vëllimin e tyre...). Gjithashtu më herët në deklaratën(at) e tij kishte lënë përshtypje që B. e kishte marrë afër stacionit të trenit në Mitrovicë që të shkonte me atë në bankë dhe më vonë tha se ishte duke e ngarë veturën, dhe në fund, ai tha se B. shkoi ta takonte afër stacionit por ai (dëshmitari) e drejtoi veturën nga aty e tutje...

Pastaj, sa i përket vlerës së kësaj deklarate, dëshmitari as që e di se kur ky episod të cilin e përmend ka mundur të ketë ndodhur: derisa në intervistë para prokurorisë ai ka mundur ta përmendte vitin 2005, në gjykim ai nuk e dinte ditën, muajin ose detajet e tjera. Para gjykimit ai ka thënë se B. do të takonte njerëz (dhe shuma e marrë nga banka ishte 700.000 euro që do të ishin për punën e tij, veprimtarinë), por gjatë gjykimit tha se ai kishte thënë se ai (B.) do t'i takonte njerëzit për t'ua dhënë paratë. Gjithmonë ka deklaruar se nuk e dinte se kush ishin personat me të cilët B. u takua. Në shqyrtimin gjyqësor ai gjithashtu deklaroi se i kishte parë të pandehurit për herë të parë në seancën gjyqësore.

Përkundër përmbajtjes së deklaratave që e bëjnë jo relevante për rastin, dëshmitari gjithashtu ka deklaruar se B. shkoi në P.C. në M. për ta marrë atë shumë të parave. Dokumentet/pasqyrat bankare në dosjen e rastit (me përgjigje të bankës R.të datës 12 shtator 2012 në urdhrin e gjykatës të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake më 24 gusht 2012 – urdhri për zbulimin e të dhënave financiare lidhur me të gjithë të pandehurit në të gjitha institucionet bankare të Kosovës), lidhur me B., tregojnë se H.B. ishte person i autorizuar i NEP E., ku pati transferime hyrëse nga (DANCON) KFOR-i në shumë prej 58.703,45 euro nga data 29.09.2008 deri më 06.04.2012; përgjigja tjetër në urdhrin e gjykatës ishte nga SHPK ku E. e kishte një llogari bankare dhe nga data 30.03.2001 deri më 25.08.2011 e vetmja depozitë ishte në shumë prej 20.00 euro...Këto ishin transaksionet e vetme të hasura.

Ngjarja e pestë e ryshfetit të përmendur në aktakuzë nuk është datuar, pretendohet të ketë ndodhur gjatë ekzekutimit të kontratës dhe ndodhi në restorantin “Q. e Ll.”, ku supozohet që F. i mori 50.000 euro nga B.

Gjatë gjykimit nuk pati referenca për këtë ngjarje.

Ngjarja e gjashtë është në fund të vitit 2007, dhe pretendohet që i pandehuri H.O. shkoi në zyrën e B. për t'i marrë 3.000 euro që ta ekzekutonte një pagesë në emër të B..

Edhe pse gjatë jetimeve muaji “dhjetor” 2007 ishte diskutuar, aktakuzën e kemi në “fund të vitit 2007”.

Prandaj me rëndësi është që së pari të shikohet nëse ai (S. H.) ka qenë në pozitë në Ministri, në fund të vitit 2007, kjo do të kishte logjikë nëse ai ia ka parashtruar pyetjen e pretenduar B. për kthim parash (ryshfet).

Në këtë aspekt, gjykata konstatoi se si i pandehuri S.H., kur u identifikua në gjykatë (seanca 14.04.2014), tha: "Kam qenë ish zyrtar në ministrinë e financave dhe ekonomisë nga data 17 maj 2004 deri në vitin 2010. Fillimisht jam suspenduar dhe me urdhër të gjykatës jam kthyer në vendin tim të punës"; gjatës seancës së mbajtur më 12 dhjetor 2014 ai sqaroi që ka qenë i suspenduar mes datave 16 janar 2007 dhe 23 shkurt 2009 dhe me kërkesën e gjykatës e qartësoi përgjigjen dhe tha, "nga 16 janari i vitit 2007 deri më 23 shkurt 2009."

Përveç kësaj, në fund të viti 2007 ai as që ishte në funksion më në Ministri sepse ai tashmë kishte qene suspenduar, gjithashtu vlen theksohet se nuk ka pasur prova të kundërta për këtë dhe se në atë kohë pagesat ndaj E.-t nuk ekzekutoheshin më - prova numër 5 e parashtruar nga prokuroria është e rëndësishme (dokumentet e parashtruara nga dëshmitari A.P.) meqë ajo gjithashtu e thekson faktin se në fund të vitit 2007 nuk ka pasur më pagesa për E.n.

Akuza 3

Askush nuk përmendi ndonjë shumë të caktuar dëmi, madje as bashkë i pandehuri A.Z. dhe nuk kishte prova se punimet e përfshira nga aneksi në fjalë i kontratës nuk janë kryer.

D – Faktet që përgjegjësia penale e të akuzuarit (neni 361 dhe 370, paragrafi 7. KPPK:

Ligji i aplikueshmen (parashkrimi dhe faktet e konstatuara dhe përgjegjësi penale lidhur me veprat e tjera penale).

Parashkrimi

Analiza e parashkrimit lidhur me veprat penale:

Lidhur me parashkrimi në 17.10.2013, në atë kohë, kryetari i trupit gjykues kishe shkruar: "Çështja e parashkrimit: periudha relevante e parashkrimit në bazë të nenit 106 (1.4) të KPK është 5 vjet. Mbrojtja argumenton se periudha e parashkrimi ka skaduar në këtë rast sepse veprimi i fundit e veprës së pretenduar sipas aktakuzës ka ndodhur në dhjetor të vitit 2005 dhe aktvendimi mbi fillimin e hetimeve është i datës 20 dhjetor 2011, jashtë parashkrimit prej 5 vitesh. Prokurori argumenton se hapi i parë i ndërmarrë për ndjekje penale ka ndodhur përmes një

informate me shkrim nga Agjencia Kundër Korrupsionit të datës 15 prill 2008, e cila është qartë brenda periudhës së parashkrimit. Neni 107 (5) i KPK thotë se “periudha e parashkrimit ndërpritet me çdo veprim të ndërmarrë për qëllim të hetimit penal.” Kjo është e qartë dhe nuk ka nevojë të interpretohet. “Çdo veprim” domethënë saktësisht ashtu. Neni nuk thotë çdo veprim nga data e aktvendimit mbi fillimin e hetimit penal.” Letra e Agjencisë Kundër Korrupsionit e datës 15 prill 2008 ishte qartë një verim dhe ishte e qartë që është ndërmarrë për qëllime të hetimit penal. Prandaj, plotësisht përputhet me nenin 107 dhe e ndërpret periudhën parashkrimit. Kryetari i trupit gjykues është i kënaqur që periudha e parashkrimit në këtë rast nuk ka skaduar.”

Ta shikojmë tash secilën vepër penale lidhur me këtë kërkesë procedurale, që periudha e parashkrimit nuk ka skaduar.

1) Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, e kryer në bashkëveprim (ndesh me nenin 422.1 në lidhje me nenin 31 të KPK): kjo është sipas Kodit të ri Penal të Kosovës (KPRK) dhe prandaj parashkrimet jepen në nenin 106 të KPRK.

Vepra penale është, në përputhej me aktakuzën, kryer më 25.07.2006, kur urdhri për pagesë ishte datuar më datën kur ishte lëshuar, edhe posë mënyra se si është shkruar aktakuza mund të nxitë dyshim (“nga data 14.09.2005(...) deri në përfundimin e punimeve nga kjo kompani më 31.12.2007) nëse nuk kemi të bëjmë me një vepër penale në vazhdim, e cila do ta zgjaste afatin e parashkrimit.

Vepra penale është e dënueshme me burgim prej 5 vitesh, e cila gjë çon në aplikimin e periudhës së përshkrimit prej 5 vitesh (neni 106, paragrafi 1.1.4, KPK) lidhur me fillimin e hetimeve dhe 10 vjet të parashkrimit absolut të ndjekjes penale (përfshirë mundësinë e dënimit të gjykatës për akuzën), në bazë të nenit 107, paragrafi 8, KPK. Duke marrë parash që afati fundit fillon ditën që vepra penale (pretendohet) është kryer (në bazë të nenit 107 paragrafi 1 i KPK) që “është ndërprerë nga çdo veprim i ndërmarrë me qëllim të ndjekjes penale të veprës penale” (neni 107, paragrafi 5, KPK) dhe se “hapi i parë i ndërmarrë i ndjekjes penale ka ndodhur përmes informatës me shkrim nga Agjencia Kundër Korrupsionit me datë 15 prill 2008” (siç tashmë është thënë në aktvendimin e datës 17.10.2013, pastaj i kemi këto rezultate: hetimi filloi më 15.04.2008, andaj

është brenda afatit të lejuar ligjor. Andaj parashkrimi absolut i ndjekjes penale dotë ndodhë më 25.07.2016.

2) Lidhja e kontratës së dëmshme (ndesh me nenin 237.1 dhe 1 KP i Përkohshëm i K).

Duke marrë parasysh se dispozitat ligjore, kriteret e sapo cituara (në analizën e veprës së mëparshme penale) të kodit të vjetër dhe të ri penal dhe të nenit 237, paragrafi 2 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, theksonin se: “kur autori i veprës sipas paragrafit 1 të nenit aktual pranon ryshfet ose shkakton dëm që e tejkalon shumën 100.000 euro, autori i veprës do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet”, i kemi rezultatet në vijim: faktet(akuza 3) ndodhën më 20.07.2006, hetimit filloi më 15.04.2008, dhe prandaj brenda afatit të lejuar me ligj (10 vite, nenin 90, paragrafi 3, dhe 91, paragrafët 1 dhe 2 dhe Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. *Parashkrimi absolut i ndjekjes penale do të ndodhë më 20.07.20127 (20 vite, neni 91, paragrafi 6 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës).*

Nëse vepra është kryer sipas nenit 237, paragrafi 1, sanksioni aplikueshëm është “burgim prej tre muajsh deri në tre vite” dhe pastaj sipas nenit 90, paragrafi 5 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, parashkrimi është “tre vite prej kryerjes së veprës penale të dënueshme me burgim prej më shumë se një vit (pasi që neni 90, paragrafi 4 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës nuk aplikohet sepse vepra penale nuk është e dënueshme më shumë se 3 vjet burgim). Sipas logjikes së shpjeguar më lart, parashkrimi absolut ka ndodhur më 20.07.2013.

Kodi i ri penal i Kosovës nuk e ndryshon rezultatit, pas arsytimit të shpjeguar më pare (nenet 291, paragrafi 2 dhe respektivisht, 10 vjet, Nenin 106, paragrafi 1.1, Kodi penal I ri I Kosovës, dhe 20 vite, neni 107, paragrafi 8, I kodit të njëjtë).

3) Marrja e ryshfetit (ndesh me nenin 343, paragrafi 1, Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës; sipas kësaj dispozite, autori i krimit do të dënohet me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet. Sipas logjikës së njëjtë sa për veprat penale tashmë të përmendura, rezultati është se hetimi filloi më 15.04.2008, afati i fundit i lejuar me ligj për fillimin e hetimeve nuk është shkelur (5 vjet, nenet 90, paragrafi 4, dhe 91, paragrafët 1 dhe 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës), duke

marrë parasysh she aktakuza i referohet periudhës kohorë që përfundon më 31.12.2007 dhe parashkrimi absolut i ndjekjes penale do të ndodh më 31.12.2017.

4) Dhënia e Ryshfetit (ndesh me nenin 429, paragrafi 1 i KPK, sipas aktvendimit të datës 17.10.2013, duke e konsideruar më të favorshëm dispozitën aktuale nga ajo e mëparshmja, neni 344, paragrafi 1, i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, autori i krimit “do të dëbohet me burgim prej tre muajsh deri në tre vite”); autori i krimit do të dënohet me gjobë ose burgim deri në 3 vjet (ndërsa te kodi i përkohshëm nuk kishte opsion të dënimit vetëm me gjobë dhe dënimi më i ulët i mundur me burgim ishte më i lartë, pasi që ishte caktuar në 3 muaj...). Sipas logjikës së njëjtë si më parë, rezultati është se pasi që hetimi filloi më 15.04.2008 dhe marrë parasysh datat e përmendura në veprën e kaluar penale, rezultati është se afati i fundit i lejuar me ligj për fillimin e hetimeve nuk është shkelur. (Neni 106, paragrafi 1.1.5, KPK), pasi që filloi brenda 3 viteve pas datës 15.09.2005 dhe 31.12.2007, por parashkrimi absolut i ndjekjes penale tashmë ka ndodhur më 15.09.2011 (lidhur me të pandehurit N.K. dhe S.F. – domethënë, tashmë kishte ndodhur kur aktakuza e datës 05.11.2012 ishte ngritur më 13.11.2012) dhe më 31.12.2013 (lidhur me të pandehurin S.H.).

Pasi që parashkrimi absolut i ndjekjes penale tashmë ka skaduar, nuk vlen të adreson çështja se faktet do të përfshiheshin për 3 veprat penale të dhënies së ryshfetit, jo vetëm për 1, si në aktakuzë.

Prandaj, lidhur me këtë akuzë, vepra penale dhënie ryshfeti, gjykata nuk ka opsion tjetër pos për ta refuzuar, në bazë të neneve 362, paragrafi 1 dhe 363, paragrafi 1.3 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, pasi që periudha e parashkrimi absolut ka skaduar.

5) Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi (ndesh me nenin 236, paragrafët 1.2 dhe 2, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës). Autori i kësaj vepre penale do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj derë në pesë vjet. Sipas logjikës së njëjtë, sa për veprat penale tashmë të përmendura, rezultati është se hetimi filloi më 15.04.2008, afati i fundit i lejuar për fillimin e hetimeve nuk ishte shkelur (5 vjet, nenet 90, paragrafi 4 dhe 91, paragrafët 1, 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës) dhe parashkrimi absolut i ndjekjes penale do të ndodhë më 25.07.2016 (10 vjet sipas nenit 91, paragrafi 6, të Kodit të Përkohshëm

Penal të Kosovës). Ligji i ri nuk është më i favorshëm, neni 290 i KPK, pasi që gjithashtu parashikon një gjobë bashkë me burgimin si më parë.

Pasi që e kemi analizuar secilin veprë penale, dhe përkundër faktit që prokuroria tashëm është tërhequr nga ndjekja për veprën penale “mashttrim në detyrë”, për arsye sistematike ne do t’ia bëjmë disa referenca asaj gjithashtu. Prandaj,

6. Mashtrimi më detyrë, që është pretenduar të jetë kryer në bashkëkryerje (ndesh me nenin 341.1 dhe 3 bashkë me nenin 23. të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës), kjo në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe duke aplikuar kriteret e njëjtë si më lartë (por me dispozitat mbi parashkrimin të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës), në bazë të nenit 341, paragrafët 1 dhe 2, “*Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumën 5000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet, atëherë i kemi rezultatet vijuese:*

- Hetimi filloi më 15.04.2008, afati i fundit i lejuar për fillimin e hetimeve ishte (10 vjet, nenet 90, paragrafi 3 dhe 91, paragrafët 1, 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës).

- Parashkrimi absolut i ndjekjes penale do të ndodhte më 25.07.2026 (20 vjet , neni 91, paragrafi 6, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës).

Është me rëndësi të shihet, në bazë të parimit se ligji më i favorshëm do të aplikohet, neni 2, paragrafi 2, i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, nëse me Kodin e Ri Penal të Kosovës rezultati do të ishte tjetër.

Sipas nenit 426, paragrafi 2, KPK, dënimi me burgim (bashkë me gjobë, nuk është paraparë në kodin e kaluar) për veprën penale do të ishte prej 1 deri në 8 vjet, dhe prandaj rezultati do të ishte i njëjtë, respektivisht: 10 vjet, neni 106, paragrafi 1.1 i Kodit të Ri Penal të Kosovës dhe 20 vjet, neni 107, paragrafi 8 i kodit të njëjtë. Parashkrimi absolut i ndjekjes penale do të ndodhte më 25.07.2026.

Faktet e vërtetuara dhe përgjegjësia penale lidhur me veprat e tjera penale

Duke marrë parasysh aktakuzën e ndryshuar dhe duke u tërhequr nga ndjekja (datë 17 prill 2015) lidhur me veprën penale “mashttrim në detyrë”, nga neni 341

paragrafët 1 dhe 1 të KPK, si dhe refuzimi i lartpërmenduri i akuzës “dhënie ryshfeti”, ndesh me nenin 429 të KPK, shkak i parashkrimit (në bazë të neneve 362, paragrafi 1 dhe 363 , paragrafi 1.3 të KPPK) veprat e tjera penale që po analizohen janë:

- Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, e kryer në bashkëkryerje (ndesh me nenin 422.1 lidhur me nenin 31 të KPK) – të pandehurit N.K., A.Z., S.H. dhe S.F.;

- Marrje ryshfeti (ndesh me nenin 343.1 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës) – të pandehurit N.K., A.Z., S.H. dhe S.F.;

- Lidhja e kontratës së dëmshme (ndesh me nenin 237.1 dhe 1 KP i Përkohshëm i K) i pandehuri N.K.- dhe

- 1) Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar , e kryer në bashkëveprim (ndesh me nenin 236, paragrafët 1.2 dhe 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës)- i pandehuri H.B..

Tash, në këtë pjesë, një analizë, një përshkrim i secilës prej këtyre veprave të tjera penale për të cilat akuzohen të pandehurit, do të pasojnë sipas radhës që sapo u përmendën.

Bashkë me këtë aktgjykim i kemi adresuar klasifikimet ligjore të bëra nga prokuroria. S’ka nevojë të thuhet se gjykata bazohet vetëm në fakte, neni 361, paragrafi 1 i KPPK.

- **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, e kryer në bashkëkryerje (ndesh me nenin 422.1 lidhur me nenin 31 të KPK) – të pandehurit N.K., A.Z., S.H. dhe S.F. (akuza 1)**

Vepra penale e kryer në bazë të nenit 422.1 të KPPK përcaktohet si vijon:

1. Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm

personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. 2.Për qëllime të këtij neni, shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshinë, por nuk kufizohet në; 2.1. shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin ezyrtarit;2.2. moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj;2.3. pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfarëdo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj;2.4. keqpërdorimi i pasurisë, shërbimeve apo personelit qeveritar apo i ndonjë sendit tjetër me vlerë që i përket qeverisë e që ka rënë në kujdesin apo posedimin e zyrtarit si rezultat i detyrës apo punës së tij; 2.5. nënshtrimi me dashje i personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë për të cilën e di se është e kundërligjshme; ose 2.6. ndalimi ose pengimi me dashje i tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor.

Duke filluar me analizimin e elementeve që janë pjesë përbërëse e veprave penale siç ishte në kohën e fakteve, duhet të shikojmë version e kaluar, neni 339 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, që thotë si vijon: “(1) Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit apo të shkaktimit të dëmit për personin tjetër ose për atë organizatë të biznesit shpërdoron pozitën e tij zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush detyrat zyrtare dënohet me burgim deri në një vit.(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dëm i cili tejkalon shumën 2.500 euro apo me shkelje të rëndë të të drejtave të personit tjetër, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet. (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumën 5.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.”

Në të dy versione, sa i përket kryerësit, është një vepër penale e cila nuk është e rëndomtë por specifike, domethënë se jo çdokush mund ta kryejë këtë veprë penale, kryerëse duhet të jetë dikush me karakteristika specifike, duhet të jetë një zyrtar.

Mens rea (elementi subjektiv në doktrinën kontinentale) është qëllimi. Në të dy versionet veprat penale duhet të kryhet me qëllim të drejtpërdrejt dhe neglizhenca nuk është mënyrë e pranueshme e kryerjes së veprës (meqë “Një person konsiderohet penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia vetëm nëse këtë shprehimisht e parashikon ligji.” – neni 11, paragrafi 3, i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe neni 17, paragrafi 2 i KPK, dhe kjo është shkaku i faktit se përkundër shumicës së veprave penale që kryhen me qëllim, për çka qëllimi i përgjithshëm mjafton, në këtë vepër penale kjo nuk mjafton sepse një qëllim specifik i drejtpërdrejt (*dolus specialis*) i nevojitet legjislatorit , dhe ky qëllim pastaj duhet të ketë për qëllim përfitim personal ose për një person tjetër ose për të t’i shkaktuar dëm një personi tjetër (përfshirë një preson juridik) . Në këtë aspekt, ka ndryshim të vogla në tekst por thelbi i qëllimit specifik kam mbetur i njëjtë.

Lidhur me mënyrën e kryerjes, kjo vepër penale, në të dy versionet, mund të kryhet me veprim ose me mosveprim (neni 31 paragrafi 1, i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe neni 8, paragrafi 1 i KPK).

Vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar e mbron vlerën juridike të përmbushjes së interesit publik në lirin e detyrave zyrtare. Siç thotë Komentari mbi Kodin e Ri Penal të Kosovës, “vepra penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare e ka karakterin e një vepre të përgjithshme penale kundër detyrës zyrtare, në bazë të faktit se shumica e veprave të tjera përbëjnë një formë të veçantë të këtyre veprave penale; prandaj kjo vepër ka, në krahasim me veprat e tjera, një karakter shtesë, që do të thotë se kjo dispozitë do të aplikohet vetëm nëse veprimet e kryerësit nuk do të karakterizohen me asnjë nga këto vepra.”²⁴

Dallimi kryesor mes versionit të vjetër dhe të ri të veprës penale janë në rrethanat rënduese të paragrafët 2 dhe 3 të versionit të kaluar, në bazë të cilëve edhe dënimi do të bëhej më i rëndë. Aplikimi i rrethanave të atilla varet natyrisht nga faktet e vërtetuara.

Duke marrë parasysh faktet e vërtetuar lidhur me veprën penale, është e mundur të thuhet se është kryer nga të pandehurit N.K., A.Z., S.H. dhe S.F.. Siç është theksuar në fakte (**shih C.1.28**, mes tjerash) “çdo pagesë, në mënyra të ndryshme dhe etapa gjatë procesit, duhej të autorizohet nga zyrtari certifikues dhe nga sekretari i përhershëm, meqë asnjëri nga këta zyrtarë nuk mund ta mundësonte

pagesën vetëm dhe që të dy, zyrtari certifikues dhe sekretari i përhershëm ishin të autorizuar ta ndërprisnin pagesën e kundërligjshme të ndonjë kontrate. I pandehuri Krasniqi, si udhëheqës i departamentit të prokurimit, e nënshkroi urdhrin e blerjes (...) të datës 25.07.2005 lidhur me urdhër-pagesën për obligimet dhe pagesën me referencë 20406254, dhe numri i zotimit 33994, i datës 25.07.2006, përmes të cilit kompanisë “E.” i është paguar “fatura” nr. 39 e datës 21.07.2006, në shumë prej 135,278.29 euro. Në atë kohë, më 25.07.2006, zyrtari certifikues ishte i pandehuri S.H. dhe e certifikoi formularin në atë cilësi dhe ushtrues detyre i

sekretarit të përhershëm ishte i pandehuri A.Z. i cili nuk e ndali një pagesë të atillë. I pandehuri S.F. nuk e ndali dhe nuk e raportoi, prandaj e lejoi pagesën në fjale: si shëf i Departamentet për përkrahjen e ndërmarrjeve dhe zhvillimit rajonal, pasi që ishte i inkuadruar në Departamentin e Zhvillimit të Sektorit Privat cilit departament edhe i përkiste projekti, nuk i kreu detyrat e tij menaxhuese pasi që ai gjithashtu e kishte për detyrë edhe mbikëqyrjen e projektit.”

²⁴“Kodi Penal I Republikës Së Kosovës”, Komentari, Botimi I”, nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Bonn and Eschborn, Germany (në tekstin e mëtejshëm “Komentari”). Në pikën 1, përkthimi anglisht, për komentarin e nenit në fjalë. “Çështja këtu është ër keqpërdorimin në detyrë, gjegjësisht të detyrës së një personi; kryerësi i kësaj veprë penale, përmes verimeve ligjore brenda detyrave t tij ose të saj e përdor autorizimin e tij paligjshëm, gjegjësisht, kryerësi i kësaj veprë penale në mënyrë të paligjshme i përdorë mundësitë real dhe ligjore të lidhura me pozitën e tij/saj zyrtare, duke i kryer veprat të cilat, sipas natyrës së tyre, nuk janë veprime zyrtare por veprime të rëndomta penale. Veprimi I kryerjes është definuar si një mënyrë alternative dhe vepra penale paraqitet në tri forma, gjegjësisht: keqpërdorimi i detyrë zyrtare ose autoritetin, tejkalimi i autorizimeve zyrtare dhe moskryerja e detyrave zyrtare (moskryerja e obligimeve zyrtare)” – pika 3 dhe 4.

Nga fakt është e mundur të përfundohet se për qëllim specifik të drejtpërdrejt, të pandehurit vepruan me qëllimin për të fituar përfitime materiale të paligjshme për (...) një organizatë afariste(kompania “E.”) dhe e keqpërdoren detyrën e tyre zyrtare, gjithashtu duke mos i zbatuar detyrat zyrtare sipas ligjit. Sipas këndvështrimit të trupit gjykues, një interpretim i ndryshëm mund të çoj te një situatë ku njerëzit me detyra të ndryshme nëpër organizata të ndryshme (ose në këtë rast, zyrtarët në “subjektet pagues”) madje mund të mos ndihem përgjegjës për kryerjen e detyrave të tyre si duhet, gjegjësisht, kontrollimin e përmbajtjes së dokumenteve të prezantuar – që para së gjithash të vlerësohet nëse ato mund të

konsiderohen të sakta apo jo; mund të çojë në mungesë të plotë të përgjegjësisë në kryerjen e detyrave zyrtare.

Kjo në fakt është e lidhur me linjën kryesore të mbrojtjes si njëfarë fakti se dikush tashmë ka dështuar në lirim nga detyra do të justifikohet se personi përgjegjës i radhës në zinxhir do të dështonte gjithashtu...për këtë aq shumë theks gjatë rrugës i është vënë sekuenca për të lejuar pagesën por në fakt çdo preson është përgjegjës për veprat e tij/saj pa marrë parasysh që të tjerët kanë dështuar – përkundër, deri në një masë, faktit, mund të konsiderohet si lehtësuese por jo deri në masën që është parashikuar nga mbrojtja. Në këtë aspekt gjykata konstaton (dhe disa nga emrat tashmë janë përmendur në këtë aktgjykim) se personat e tjerë munden gjithashtu të jenë akuzuar, siç u tha tashmë, dhe vlen të theksohet se si versioni do të ndryshonte nga individi në individ (sekuenca e nënshkrimeve, etj.) dhe madje i njëjti person ka deklaruar gjëra të ndryshme gjatë rastit, përfshirë, për shembull, nëse ka qenë paradhënie apo jo...

Siç u tha më parë, të pandehurit N.K., S.H., A.Z. dhe S.F. e kanë shkelur ligjin.²² Ata e shkelën kontratën me operatorin ekonomik, i shkelën kontratat e tyre të veta të punës dhe ligjin.

Detyrat e drejtor të prokurimit publik (N.K.), I mbikëqyrur nga sekretari i përhershëm (A.Z., ushtrues detyre), përfshijnë: “(...) planifikon, procedon, mbikëqyrë dhe në mënyrë efektive dhe efikase e zbaton furnizimin e mallrave dhe shërbimeve sipas kërkesës së departamente dhe agjencisë përkatëse; (...)Rreptësisht i respekton procedura te prokurimit; e përcjellë dorëzimin e mallrave dhe shërbimeve në bazë të kontratave dhe marrëveshjeve; (...)i monitoron dhe ekzekuton kontratat; i kontrollon faturat në krahasim ,e shënime për mallrat dhe shërbimet e pranuar, në përputhje me kontratat dhe marrëveshjet (...)”²⁶, dhe në pajtim me ligjin mbi prokurimin, paragrafi 1, 2, 21, dhe 22 të Ligjit 2003/17²⁷ dhe Ligji 2003/2002 (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/17)²⁸.

Sipas nenit 21, paragrafi 1, dhe 22, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit 2003/17, “Çdo autoritet kontraktues do të themelojë departamentin e tij të prokurimit që do të ushtrorë aktivitetet e prokurimit të autoritetit kontraktues në fjalë. Çdo autoritet kontraktues do të sigurojë që departamenti i tij i prokurimit ka mjaft personel të

²² Për arsye sistematike i pandehuri A.Z. tash do të përmendet në vendin e tretë.

²⁶ Sipas kontratë së tij dhe "Titullit të punës: Drejtor i departamentit të prokurimit."

²⁷

Këto dispozita do të adresohen përsëri lidhur me akuzën 3. Dispozitat thonë si vijon: paragrafin 1" Qëllimi. 1.1 Qëllimi i ligjit aktual është sigurojë përdorimin më efikas, kosto-efektiv, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, burimeve publike dhe të gjitha fondet e tjera dhe burimet e organeve kontraktuese në Kosovë duke i përcaktuar kërkesat dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe obligimet që do të përmbushen, nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, organet kontraktuese, koncesionerët e punës, dhe trupat publik që zhvillojnë, ose marrin pjesë ose janë të interesuar në aktivitetin e prokurimit që përfshin ose lidhet me përdorimin e atyre fondeve dhe/ose burimeve. 1.2 Ligji aktual gjithashtu ka për qëllim të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, shërbyesve civil dhe personave të tjerë që zhvillojnë ose janë të përfshirë në aktivitetin e prokurimit duke kërkuar që vendimit e atyre individëve, dhe bazat ligjore dhe faktike e atyre vendimeve, janë pa interesa personale, karakterizohen me mos diskriminim dhe shkallë të lartë të transparencës, dhe janë në përputhje me kërkesat procedurale dhe të substancial të ligjit aktual. 1.3 Në fund, ligji aktual ka për qëllim të promovojë vendosjen e një profesionalizmi kulturor institucional të paanshëm, etik dhe pa interesa materiale të të gjithë zyrtarët publik, shërbyesit civil dhe personat e tjerë që zhvillojnë ose janë të përfshirë në një aktivitet prokurimi duke kërkuar që individët e atillë të sillen në mënyrën që informohet vetëm nga objektivi i arritjes së përdorimit më efikas, kosto-efektiv, transparent dhe të drejtë të fondeve publike dhe burimeve publike duke iu përmbajtur rreptësisht kërkesave procedurale dhe substanciale të ligjit aktual ;" paragrafi 2 thotë:

"2.1 Ligji aktual do të aplikohet për aktivitetet e prokurimit të autoriteteve kontraktuese dhe të koncesionarëve të punimeve, meqë ato kushte janë definuar këtu. Ato autoritete dhe koncesionarë nevojiten në zhvillimin e aktiviteteve të tyre prokuruese, për të zbatuar procedurat e aplikueshme dhe kërkesat substanciale të ligjit aktual. 2.2 Ligji aktual gjithashtu vlen për të gjithë personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, meqë ato kushte të definuara këtu, të implikuar, që marrin pjesë ose janë të interesuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë, në një aktivitet prokurimi të përfshirë nga ligji aktual; personat e atillë, operatorët, ndërmarrjet gjithashtu nevojiten për të zbatuar kërkesat e aplikueshme procedurale dhe substanciale të ligjit aktual" dhe neni 22: "Zyrtarët e prokurimit që zhvillojnë aktivitetet e prokurimit 22.1 Çdo aktivitet prokurimi i autoritetit kontraktues do të zhvillohet nga zyrtari i vet i prokurimit, pos në ato raste ku Qeveria ia ka caktuar aktivitetin e prokurimit PPA-s në përputhje me ligjin aktual. 22.2 Zyrtari i prokurimit i autoritetit kontraktues do të jetë përgjegjës për sigurimin që të gjithat aktivitetet e prokurimit i autoritetit të atillë kontraktues të zhvillohen nga departamenti i prokurimit dhe në pajtim të rreptë me ligjin aktual. 22.3 Zyrtari i prokurimit i autoritetit kontraktues do të jetë përgjegjës që t'i raportojë menjëherë KRPP-n për ndonjë aktivitet prokurimi të autoritetit të atillë kontraktues që janë të paqëndrueshme me ligjin aktual. 22.4 Nëse zyrtari i prokurimit bëhet i papërshtatshëm për ta mbajtur atë pozitë për një arsye të specifikuar në 21.3, autoriteti kontraktues menjëherë do ta largojë atë person nga ajo pozitë dhe do t'i njoftojë IKAP-in dhe KRPP-n për një veprim të atillë. Nëse një zyrtar prokurimi është shërbyes civil dhe një person i atillë bëhet i papërshtatshëm ta mbajë një pozitë të shërbyesit civil sipas ligjit dhe rregullave të shërbimit civil, autoriteti kontraktues do ta njoftojë IKAP-in dhe KRPP-n për papërshtatshmërinë e një personi të atillë. Sidoqoftë, trupi që e lëshoi "certifikatën e prokurimit profesional" të personit të atillë qoftë IKAP-i ose KRPP-n do ta revokojë dhe anulojë menjëherë një certifikatë të atillë."

²⁸

Është anuluar më vonë me Ligjin 03/L-048, të datës 13 mars 2008.

trajnuar dhe të aftë që t'i ushtruar aktivitetet e prokurimit të autoritetit kontraktues në mënyrë efikase, profesionale si dhe në pajtim të plotë me këtë ligj (...)Të gjitha aktivitetet e prokurimit të një autoriteti kontraktues ushtrohen nga Departamenti i tij i Prokurimit, përveç në ato raste kur APP-ja, në përputhshmëri me nenin 91 ose nenin 26 të këtij ligji, ka vendosur se aktiviteti i prokurimit duhet të ushtrohet nga APP-ja ose një komision për dhënien e kontratës(...)Zyrtari i Prokurimit i një autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e

prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen nga Departamenti i Prokurimit dhe në përputhshmëri të plotë me këtë ligj dhe me rregullat e prokurimit publik.”²³.

Në bazë të këtyre dispozitave dhe të atyre në nenet 1 dhe 2 të ligjit të njëjtë (i cituar në shënime e mëparshme më fund të faqes) është e qartë se udhëheqësi i prokurimit, N.K., u desh ta zbatojë dhe t’i përmbahet ligjit mbi prokurimin, detyrat të cilat nuk i përmbushi (përkundrazi...), pasi që kontrata në mënyrë eksplicite ndalon çdo paradhënie, siç është shpjeguar tashmë dhe është autorizuar pagesa që e tejkalon madje edhe situatën që e kishte vulën e kompanisë “N.”, sipas së cilës 50.000 euro duhej të zbriteshin (sipas dokumentit të datuar 21.07.2006, numër 33”, “situacioni i dytë” qartë duke e paraqitur se vetëm 85.278, 20 euro është dashur të paguhen, jo 135.278,20 euro).

Lidhur me detyrat e (ushtruesit të detyrës) zyrtarit certifikues (S.H.) është me rëndësi të merret parasysh se në bazë të Ligjit 2003/02, paragrafi, neni 11, paragrafi 2, “ *sekretari i përhershëm i organizatës buxhetore (...) do ta njoftojë Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkrim duke i specifikuar emrat e individëve të emëruar që të shërbejnë në organizatën buxhetore (...) zyrtar certifikues (...)*” dhe paragrafi 4, “*(...)Zyrtari Certifikues do të përgjigjen para sekretarit të përhershëm të organizatës buxhetore(...)*” dhe sipas nenit 8 të (“Kontrolli brendshëm – Roli i delegatëve kyç) pika 8.6 e Rregullit të Thesarit Financiar – Numër 01 – Kontrolli i brendshëm publik, në fuqi nga prilli 2006, detyrat e zyrtarit certifikues janë: “8.6 Zyrtari certifikues (emërohet nga zyrtari kryesor administrativ në përputhje me Ligjin mbi Menaxhimin Financiar Publik dhe Përgjegjësinë dhe rregullat financiare), 8.6.1 Zyrtari certifikues emërohet nga shefi ekzekutiv në përputhje me ligjin mbi menaxhimin financiar publik dhe përgjegjësinë. Zyrtari certifikues do t’i raportojë shefit ekzekutiv të organizatës buxhetore(sekretari i përhershëm). (...) 8.6.2 Lidhur me shpenzimin e parave publike, para dorëzimit të dokumentit në Thesar për pagesë të shpenzimeve të këtilla, **Zyrtari certifikues do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e dokumenteve lidhur me shpenzimet për të identifikuar ndonjë provë të moszbatimit si vijon:** (a) që prokurimi është zhvilluar në përputhje

²³ Më pas, neni 13 i Ligjit nr. 03/L-048, për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (paragrafi 1, “Çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet të ketë një Zyrtar të Prokurimit, i cili është përgjegjës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit të organizatës buxhetore në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik”).

me Ligjin mbi prokurimin publik , (b) **që kushtet e kontratës janë përmbushur para kryerjes së pagesës**, (c) që kërkesa e pagesës është e koduar me nën-pikën e saktë të shpenzimeve në klasifikimin e shpenzimeve; (d) **një faturë e saktë është pranuar**; (...) ²⁴ [theksimi është shtuar].

Të mos e përmendim që i pandehuri S.H., lidhur me këtë rast ka intervenuar në cilësi të tjera (zyrtar pranues, zyrtar zotues – me çka deri në një masë shtohen detyrat e tij vetëdijesimit), ai nuk i shqyrtoi dokumentet lidhur me pagesën dhe kontratën dhe e vërtetoi procedurën dhe e nënshkroi formularin që do të përdorej për ta zbatuar pagesën.

Sipas nenit 4 (definicionet) të Ligjit 2003/17 ²⁵, sa i përket të pandehurit A.Z., “*zyrtari kryesor administrativ domethënë, sa i përket organizatës buxhetore, (i) sekretari i përhershëm(...) Te rasti i ndërmarrjes publike, këto terme e kanë domethënien e shefit ekzekutiv, drejtorit pse një person tjetër që ka autoritet kryesor të përditshëm administrativ ndaj punëve dhe personelit*”.

Gjithashtu sipas rregullores së UNMIK-ut 2001/19, neni 5 paragrafi 1, “*Sekretarët e përhershëm të ministrive dhe kryeshefat ekzekutivë të agjencive ekzekutive do të emërohen nga Komisioni për emërimin e funksionarëve. Këta zyrtarë duhet të jenë të ndershëm, kompetent dhe me përvojë për të udhëhequr resurset që bien në përgjegjësi të tyre*” dhe paragrafi 4 “(...) Sekretarët e përhershëm të ministrive dhe kryeshefat ekzekutivë të agjencive ekzekutive janë përgjegjës për:(a) **Administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm** të ministrisë apo agjencisë ekzekutive dhe për sigurimin e implementimit të funksioneve që u janë besuar atyre; (d) **Menaxhimin efektiv dhe efikas të**

²⁴ Neni 14, paragrafët 1, 4 dhe 5 i Ligjit 03/L-048 gjithashtu thotë për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë “(...) **Zyrtari certifikues do t’i (...)raportoje Zyrtarit Kryesor Administrativ. Zyrtari Certifikues është përgjegjës që a) të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës; dhe b) të sigurojë që shpenzimi i parave publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me Rregullat e KMF. Zyrtari Certifikues poashtu ushtron të gjitha detyrat të cilat i janë caktuar atij/asaj sipas Rregullave KMF. Zyrtari Certifikues gjithashtu do t’i kryejë detyrat e tjera që kërkojnë nga Zyrtari Certifikues sipas rregullave të KMF-s. Zyrtari Certifikues duhet që të identifikojë dhe menjëherë t’i raportojë me shkrim Zyrtarit Kryesor Administrativ, ZKF dhe cilitdo zyrtar tjetër të rangut të lartë në organizatën buxhetore, agjencinë autonome publike ose ndërmarrjen publike mbi të gjitha rastet e mos-respektimit të këtij ligji. Rastet e mos-respektimit të Ligjit mbi Prokurimin Publik gjithashtu duhet t’i raportohen Auditorit të Përgjithshëm.(...)” (theksimi është shtuar).**

²⁵ Më vonë është shfuqizuar nga neni 1 i Ligjit nr. 03/L-048 Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të datës 13 mars 2008.

resurseve që i janë siguruar ministrisë apo agjencisë ekzekutive; (theximi është shtuar) ²⁶.

Përveç dispozitave tashmë të përmendura, në bazë të pikës 4.2.1 të Rregullit të Thesarit Financiar – Numër 01 – Kontrolli i brendshëm publik i brendshëm, në fuqi nga prilli 2006, “Sipas ligjit mbi menaxhimin publik financiar dhe përgjegjësit, shefi kryesor administrativ është sekretari i përhershëm i organizatës buxhetore në fjalë ose, nëse organizata buxhetore nuk ka sekretar të përhershëm, shefi ekzekutiv i organizatës buxhetore”, dhe sipas pikës 4.2.3 a) dhe d) “ Në bazë të rregullores 2001/19, Sekretarët e përhershëm të ministrive mbajnë përgjegjësi direkte ndaj ministrit përkatës. Kryeshefat ekzekutivë të agjencive ekzekutive mbajnë përgjegjësi direkte ndaj ministrit përkatës apo autoriteteve tjera (të përcaktuara me ligjin përkatës për themelimin e agjencive ekzekutive). Sekretarët e përhershëm (shefat ekzekutiv) të ministrive, sipas ligjit, janë përgjegjës për sigurimin e kontrollit të brendshëm. Si shembull. neni 5.4 i Ligjit thotë se Sekretari i përhershëm (shefi ekzekutiv) është përgjegjës për:

(a) Administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm të ministrisë apo agjencisë ekzekutive dhe për sigurimin e implementimit të funksioneve që u janë besuar atyre; (...) (d) Menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë siguruar ministrisë apo agjencisë ekzekutive (theximi është shtuar). Gjithashtu sipas pikave 7.2.1 dhe 7.2.2, a) dhe c) ”Derisa çdo punëtor ka përgjegjësi për menaxhim të mirë financiar, nga të gjithë shërbyesit civil, shefi kryesor administrativ është përgjegjësi kryesor për rezultatet dhe punën e organizatës buxhetore. Kontrollat e brendshme të sakta dhe një kornizë e drejtë funksionale e

²⁶ Më vonë neni 10 i Ligjit 03/L-048 thotë:”**Zyrtari Kryesor Administrativ ka përgjegjësinë kryesore ligjore për të siguruar që organizata buxhetore, agjencia autonome ekzekutive ose ndërmarrja publike dhe personeli i saj të jenë në përputhshmëri të plotë si dhe të respektojnë dispozitat e zbatueshme të këtij ligji dhe Rregullat KMF.10.2 Zyrtari Kryesor Administrativ, ndër tjera, është shprehimisht përgjegjës për: a) vendosjen e kontrollit të brendshëm në organizatën buxhetore, agjencinë autonome ekzekutive ose ndërmarrjen publike sipas Rregullave KMF; b) delegimin e funksioneve për mbledhjen dhe shpenzimin e parave publike në pajtim me Rregullave KMF; c) vendosjen e një kornize për vlerësimin dhe menaxhimin e performances së personelit të organizatës buxhetore të cilëve u janë deleguar funksionet e tilla; vendosjen dhe zbatimin e masave të brendshme disiplinore”(theximi është shtuar).**

përgjegjësisë (a) e nevojshme për funksionim efikas dhe efektiv dhe (b) i vetmi mekanizëm me të cilin zyrtari kryesor administrativ mund t'i pranojë rreziqet e lidhur me kontrollet e deleguara derisa mbetet përgjegjës për rezultatet(...)7.2.2 Nën autoritetin e këtij rregulli financiar, zyrtari kryesor administrativ është përgjegjës për: (a) implementimin e strukturës së brendshme të kontrollit financiar në organizatën buxhetore e cila **siguron operime efikase dhe efektive, duke i mbrojtur resurset nga humbjet shkaku i humbjeve, keq-menaxhimit, gabimeve, mashtrimit dhe parregullsive të tjera dhe është në përputhje me Ligjin mbi menaxhim publik financiar dhe rregullat aktuale financiare**, përfshirë elementet specifike të theksuara në nenin 2.3 më lart (...) (c) Zhvillimi i një kornize funksionale të përgjegjësisë me (1) implementimin e performansës së brendshme dhe raportimit financiar, (2) zhvillimi i autoriteti të menaxherët dhe (3) me implementimin e sistemeve, trupave dhe proceseve për vlerësimin e performansës së Zyrtarit Kryesor Financiar dhe menaxherëve të tjerë për të **siguruar që objektivat e organizatës buxhetore të përmbushen; përdorimi dhe shfrytëzimi i drejtë i parasë publike, zbatimi i ligjeve relevante dhe rregullave financiare, zbatimi i udhëzimeve për planifikimin e buxhetit dhe ekzekutimit, dhe se përdorimi aktual i parasë publike reflekton se planet buxhetore të miratuar nga Asambleja dhe PSSG(dhe asambleja komunale)(...)**”.

I pandehuri Z. i cili ishte ushtrues detyre i sekretarit të përhershëm, ishte mbi hierarkinë dhe nuk e ndaloi pagesën e autorizuar dhe prandaj bëri shkelje të ligjit dhe të detyrave të tij, dhe prandaj e lejoji. Me më pak intensitet të përgjegjësisë penale (e cila do të shqyrtohet në kohë të duhur), por është përgjegjës edhe i pandehuri S.F. meqë as ai nuk ndërmoi asgjë për ta ndaluar ose raportuar, dhe prandaj e ka lejuar pagesën në fjalë: si udhëheqës i agjencisë për përkrahjen ndërmarrjeve dhe zhvillimin rajonal, meqë ishte i angazhuar në departamentin e zhvillimit të sektorit privat të cilit i përkiste projekti, nuk i kreu detyrat e tij të menaxherit në përket pasi që gjithashtu kishte për detyrë mbikëqyrjen e projektit dhe si të tjerët bëri shkelje të ligjit mbi prokurimin duke mos u kujdesur që shpenzimet e fondeve publike ishin duke u bërë në përputhje me rregullat e aplikueshme, sepse sa i përket parasë publike, “ *Paraja publike do të përdoret vetëm për qëllim të miratuar publike. Asnjë autoritet publik, organizatë buxhetore, person ose ndërmarrje mund ta devijojë, keqpërdorë, ta shpenzojë në mënyrë të gabuar ose ta përdorë parandë publike në mënyrë të gabuar(...)* Një

shpenzim ose përdorim tjetër i parasë publike do të bëhet vetëm nga fondet e caktuara dhe të alokuara dhe vetëm në pajtim me proceset që në përputhje me nenin 35.2 është përcaktuar nga rregullat financiare (neni 15 i të njëjtit ligj) dhe kontrata nuk lejonte asnjë përqindje për paradhënie e cila çon te përfundimi se paraja publike është shpenzuar në mënyrë të paligjshme.

Përsëri gjykata thekson se nëse shumë gjëra dështojnë, subjekti mbikëqyrës “N.” (që gjithashtu u desh të vlerësonte ekzekutimin e punimeve sipas kontratës, por gjithashtu është kontraktuar drejtpërdrejt nga i njëjti subjekt i përfshirë në tender...Ministria e Tregtisë dhe Industrisë), ekzekutimi i gjithmbarshëm dhe mbikëqyrja e kontratës; prokuroria parashtrroi akuzë vetëm për disa fakte dhe vetëm disa nga personat e implikuar.

Përgjegjësia penale është bashkekzistuese me përgjegjësinë civile; nuk është argument të thuhet se nuk ka përgjegjësi penale sepse rasti, nga këndvështrimi civil, është vendosur dhe është bërë i plotfuqishëm dhe kompania “E.” është dënuar për ta kompensuar Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Përgjegjësia civile nuk e pengon vet ekzistimin e përgjegjësive penale pasi që vlera juridike si bazë e veprës penale shkon përtej vet dëmit material. Sistemi penal është gjithmonë *ultima ratio* për Sundimin e Sistemit të Ligjit dhe shkon përtej përgjegjësive civile kur vlerat bazë të shoqërisë rrezikohen dhe shkelen.

Nenin 31 i KPK për bashkëkryerje thotë se ”Kur dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.”

Bashkëkryerja është një koncept shumë kompleks, që është bërë objekt i qasjeve të ndryshme doktrimore; koncepti i përfshirë në nenin 31 të KPP-së është shumë i gjerë²⁷. Në formën më të dukshme, të qartë të bashkëkryerjes, duhet të ketë një marrëveshje të mëparshme dhe të vërtetë, ndërsa në format e tjera kjo

²⁷ Në të njëjtën mënyrë, shih pikën 1 të Komentarit të Nenit 31 të KPK-së për “lidhjen objektive dhe subjektive”, pikat 6 dhe 7 [“6. Lidhja objektive është se çdo bashkëpunëtor duhet të ndërmarrë një veprim me të cilën kontribuon në kryerjen e veprës penale. Të gjitha veprimet që janë marrë nga bashkëpunëtorët, pavarësisht nëse i ndërmarrin në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, duhet të jenë të lidhura mes tyre dhe të drejtuara për të arritur të njëjtin rezultat, me qëllim që të shkaktohet pasoja e specifikuar. Me fjalë të tjera, pasojë e veprës penale duhet të jetë rezultati i përbashkët i veprimeve të të gjithë bashkëpunëtorëve. 7.Lidhja subjektive është se të gjithë

“marrëveshje” mund vetëm të **nënkuptohe**²⁸, por, në të dyja rastet, “pjesëmarrja” ose “kontributi i madh” prapëseprapë duhet të çojë në një kontribut objektivisht të përbashkët për kryerjen e së njëjtës vepre penale²⁹; prandaj kërkohet që në dritën e fakteve është e mundur të arrihet në përfundimin se individët dëshironin të ekzekutonin **të njëjtën** vepër penale, se një **rezultat i dhënë** mund të arrihet si pasojë e veprimit/mosveprimit të tyre.

Për rrjedhojë, nuk ka nevojë për një marrëveshje të përcaktuar shprehimisht, ngase një **bashkëpunim i ndërgjegjshëm** në veprimtarinë e të tjerëve³⁰ për të përmbushur, apo përfunduar, veprën penale do të mjaftonte për bashkë-kryerjen. Ka bashkë-kryerje, pavarësisht nga fakti se nuk ka pasur marrëveshje të përcaktuar shprehimisht, kur rrethanat në të cilat individi ka vepruar apo nuk ka vepruar tregojnë se ka pasur një marrëveshje të nënkuptuar. **Kjo marrëveshje e nënkuptuar është e bazuar në ekzistencën e vullnetit të ndërgjegjshëm për të bashkëpunuar, i vlerësuar në dritën e përvojës së përbashkët [theksimi i shtuar].**

Ky është një rast i “bashkëkryerjes së njëpasnjëshme”, rastet kur një person tjetër i bashkohet një personi i cili është duke kryer veprën penale, dhe, nga veprimet e tij, merr pjesë në kryerjen e asaj vepre penale³¹, por veprat mund të jenë edhe mosveprime, “Bashkëkryerja në veprat penale me mosveprim tregohet në rastet kur dy ose më shumë persona së bashku janë të detyruar të ndërmarrin një veprim, por ata nuk e ndërmarrin atë”³². Kështu është edhe kur veprat përbëhen nga veprime dhe mosveprime, aktet e aprovimit duke nënshkruar (K. dhe H.) dhe

bashkëpunëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm se do të marrin pjesë në kryerjen e veprës penale të caktuar, do të veprojnë së bashku në mënyra të ndryshme (...)].

²⁸ Shih pikën 18A, in fine, të Komentarit të Nenit 31 të KPK-së, “bazuar në këtë rezulton se bashkë-kryerja mund të shprehet edhe në rastet kur nuk ka pasur marrëveshje të mëparshme, por është shprehur në ndërkohë gjatë kryerjes. Lidhur me ekzistencën e bashkëkryerjes ligjvënësi nuk e parashikon marrëveshjen si kusht të nevojshëm.”

²⁹ Shih pikat 15 dhe 16 të Komentarit të Nenit 31 të KPK-së, “(...)së bashku kryejnë veprën e përbashkët të tyre, në të cilën secili prej tyre jep një kontribut të rëndësishëm pa të cilin vepra penale nuk do të arrihej apo nuk do të përfundohej (...) Kontributi i secilit është pjesë e rëndësishme e arritjes së planit kriminal. Kontributi i njëritrealizohet me kontributin e tjetrit dhe të gjithë ata janë përgjegjës për të gjithë veprën penale të kryer”.

³⁰ Shih pikën 19 të Komentarit të Nenit 31 të KPK-së për konceptine “bashkëkryerjes së nevojshme”.

³¹ Shih pikën 22 a) të Komentarit të Nenit 31 të KPK-së

³² Shih pikën 22 c) të Komentarit të Nenit 31 të KPK-së

mosveprimet e përmbushjes së detyrave si zyrtarë, domethënë, të detyrave të sigurimit që çdo pagesë të jetë në përputhje me ligjin dhe kontratën (Z. dhe F.).

Nuk ka nevojë të përsëritet në këtë pikë ajo që u tha tashmë në lidhje me mënyrën se si ata shkelën detyrat e tyre dhe dispozitat ligjore.

Së fundi, kjo lloj procedure, të parapaguash kur kontrata nuk e lejon atë, është e papranueshme pasi minon ndjenjën e përgjegjësisë, e realizimit të interesit publik dhe ligjit mbi prokurimin; ajo gjithashtu mund të thuhet se e bën të tepërt pasjen në kontratë të një detyrimi lidhur me zbatimin e kontratës, garancia prej 10% e vlerës së kontratës (çdo pagese).

- Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi (në kundërshtim me nenin 236, paragrafët 1.2 dhe 2, KPK i Përkohshëm.) – I pandehuri H.B. (akuza 1)

Neni 236, paragrafi 1.2 dhe 2 KPPK parashikon si vijon: *“(1) Personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik i cili ushtron veprimtari ekonomike me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për organizatën e biznesit ose personin juridik në të cilin është i punësuar apo organizatën tjetër të biznesit ose për personin juridik dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet nëse ai kryen ndonjëherë prej veprave të mëposhtme; .2, Me përpilimin e dokumenteve me përmbajtje të rrejshme, me bilance të rreme, me vlerësime apo inventarizim apo me prezentim tjetër të rremë a me fshehjen e fakteve në mënyrë të rreme e prezenton lëvizjen e mjeteve ose të rezultateve të veprimtarisë ekonomike **dhe në këtë mënyrë i vë në lajthim[theksimi i shtuar] organet drejtuese në organizatën e biznesit apo në personin juridik gjatë vendimmarrjes lidhur me punët e qeverisjes; (2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me fitim material në shumën që kalon 100.000 EUR, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.”***

Kjo vepër penale tashmë është e paraparë në nenin 290 të KPK-së; paragrafi 2 mbeti i pandryshuar dhe, pavarësisht nga dallimet e vogla në formulim, elementet që janë përbërëse të veprës penale janë të njëjta. Dënimi, megjithatë, tani është më i rëndë, sepse parashihet gjobë bashkë me burgimin – kufijtë e të cilit mbeten të njëjtë.

Për këtë arsye, dhe meqë Kodi i ri nuk mund të konsiderohet kurrë më i favorshëm, të gjitha referencat do të bëhen për versionin e mëparshëm të veprës penale, në fuqi në atë kohë.

Vlera juridike e mbrojtur me këtë vepër penale është siguria në kryerjen e punëve, që përfshin saktësinë dhe ndershmërinë. Sa i përket kryerësit, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm nga një person i cili është përgjegjës në organizatën e biznesit apo të personit juridik. *Mens rea* është dashja e drejtpërdrejtë për të siguruar dobi pasurore të kundërligjshme; vepra penale nuk mbulon aktet e pakujdesisë së plotë, gabimet e dukshme, pasi është e nevojshme dashja.

Në këtë rast, dhe lidhur me elementet objektive të veprës penale, akuza i referohet të dytës dhe, duke marrë parasysh aktakuzën, referenca është tek modaliteti *“përmes përpilimit të dokumenteve me përmbajtje të rrejshme, me bilance të rreme, me vlerësime të rremë (...)*”.

Dy gjëra vlejné të theksohen: jo vetëm është e nevojshme dashja konkrete dhe e drejtpërdrejtë për të kryer këtë vepër penale, por edhe aktet materiale duhet të jenë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për rezultatin e parashikuar nga kryerësi (tentues), pasi për veprën penale thuhet *“dhe në këtë mënyrë vë i në lajthim organet drejtuese”* [theksimi i shtuar], që do të thotë se jo vetëm mjetet e përdorura duhet të jenë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të çuar në rezultat, pasi ata në parim mjafton të mashtronin, vinin në lajthim në procesin e vendimmarrjes që do të përfundojë në një dëm (i paligjshëm) pasuror për subjektin ose organizatën ekonomike së cilës iu paraqitën dokumentet.

Sa për faktet e vërtetuara (në tekstin e mëtejshëm të përmbledhura në dispozitiv, pavarësisht nga gjithë përshkrimi i mësipërm i tyre), *“gjatë ekzekutimit të kontratës për projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës në parkun industrial në D., Nr. MTi/22/07/2005, në bashkëpunim dhe koordinim me të paktën zyrtarin tjetër të pandehur në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, i pandehuri N.K., si kreu i departamentit të prokurimit dhe nënshkrues i kontratës së datës 07/10/2005, dhe duke mos përjashtuar zyrtarë të tjerë në këtë Ministri, i pandehuri*

B. paraqiti në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në emër të kompanisë së tij “E.”, dokumente me logon dhe vulën e kësaj kompanie, dhe që mbanin firmën e tij, dokumente që deklarorin fakte që nuk ishin të vërteta në lidhje me punët e kryera

dhe koston e tyre, duke e ditur se përmbajtja e dokumenteve të paraqitura ishte e rreme pasi nuk përputhej me realitetin dhe do të përdorej për të mundësuar zyrtarisht paradhënien dhe pagesa të tjera, duke përfshirë ato ku paradhënia do të kthehej duke e zbritur me këste, nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në lidhje me kontratën në fjalë të projektimit dhe ndërtimit të Parkut Industrial në D.. Domethënë, i pandehuri B. ka paraqitur në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dokumentet e mëposhtme: **A)** - datë 31/05/2006, “Situacioni i Parë Avansuas”, që deklaron në rreshtin 6 vëllimin e punës së kryer sipas këtij situacioni: 156.321,80 euro, në rreshtin 7, të zbritura në bazë të marrëveshjes: 15.632,18 euro, në rreshtin 9 për pagesë sipas këtij situacioni 140.689,62; **B)** - “Situacioni i Parë 20/06”, pa datë, nën pikat A, B, C punë në vlerën e 116.339,26 eurove, plus 15% tatim dhe shuma e përgjithshme 135.278,20 euro; **C)** - datë 21/07/2006 “Situacioni i dytë 3/2006”, “dokumenti 33”, që deklaron në rreshtin 6 vëllimin e punës së bërë sipas këtij situacioni: 150.309,11 euro, në rreshtin 7 zbriten në bazë të marrëveshjes: 15.030,11 euro, në rreshtin 8 për pagesë mbeten 135.278,20 euro, në rreshtin 9 avancuara pagesa 140.689,60 euro, në 9A zbriten nga gjendja e tanishme 50.000 euro, në rreshtin 9B paradhënia që mbetet për t’u zbritur 90.689,60 euro dhe në rreshtin 10 për pagesën sipas këtij situacioni 85.278,20 euro, dhe **D)** Fatura 39/06, datë 21/07/2006, e prodhuar në një fletë me kokë “E.”, që kishte dy vula “E.” (njëra në krye dhe tjetra në fund), duke deklaruar punimet në vlerë prej 127.762,74 euro, të shtuara nga tatimi 15% në vlerë 22.546,11 euro, në shumën e përgjithshme të 150.309,11 eurove, duke zbritur prej saj 10% në vlerën 15.030,91 euro, dhe duke pretenduar t’u paguhet shuma totale 135.278,20 euro. I pandehuri u soll në mënyrën e përshkruar më lart, megjithëse ishte në gjendje të kuptonte dhe kontrollonte veprimet e tij, që ai i dëshironte, duke e ditur se veprimet e tij ishin të ndaluara dhe të dënueshme me ligj”.

Siç u përmend më herët, në aktakuzë Prokuroria akuzoi të pandehurin B. për keqpërdorim të autorizimeve në ekonomi (në kundërshtim me nenin 236, paragrafët 1.2 dhe 2, të KPK-së së Përkohshme), por është një element përbërës i veprës penale që nuk përputhet me faktet e vërtetuara (“**dhe në këtë mënyrë i vë në lajthim** organet drejtuese në organizatën e biznesit apo në personin juridik gjatë vendimmarrjes lidhur me punët e qeverisjes” – **theksimi i shtuar**) dhe për këtë arsye vepra penale në fjalë nuk është ajo që u krye, duke pasur parasysh se dokumentet në fjalë të falsifikuara nuk ishin ato që çuan (ose ta themi më mirë, që “**vunë në lajthim**”) pagesat; më tepër, dokumentet ishin mjeti i vetëm i nevojshëm

për të dhënë brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (dhe më vonë në Ministrinë e Financave) përshtypjen se pagesat ishin të ligjshme, në përputhje me ligjet në fuqi dhe posaçërisht në përputhje me kontratën – sipas të cilave nuk lejohej paradhënie pasi përqindja për të ishte 0% dhe 10% duhej të zbriteshin si garanci.

Prandaj, për shkak të mungesës së njërit prej elementëve përbërës të veprës penale të “keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi”, gjykata i rikualifikon faktet (sipas Nenit 360, paragrafi 2 të KPPK, “*Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës*”), veprimet e kryera nga i pandehuri H.B. për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve – në pajtim me nenin 332, paragrafi 1, të KPPK, “*Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal dënohet me gjobë apo burgim deri në një vit*”. Ligji i ri nuk është më i favorshëm, pasi sanksioni i paraparë tani është “*gjobë ose me burgim deri në tre vjet*”, neni 398 i KPK-së.

Duke ardhur në këtë fazë, dhe në bazë të nenit 90, paragrafi 1, nën-paragrafi 6, të KPPK, shohim se afati i parashkrimit është 2 vjet dhe ndalimi absolut për ndjekjen e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve është 4 vjet, sipas nenit 91, paragrafi 6 të KPPK dhe një afat i tillë i 4 vjeç ka kaluar tashmë (në 21/07/2010), pasi dokumenti i fundit i dokumenteve të përmendura më sipër³³ është i datës 21/07/2006; afati në fjalë kishte përfunduar madje para datës në të cilën prokurori nxori aktvendim për fillimin e hetimeve, 10/12/2011.

Prandaj, në përputhje me rrethanat, në bazë të nenit 363, paragrafi 1.3, të KPPK-së, gjykata e hedh poshtë padinë në lidhje me këtë të pandehur në akuzën 1 të aktakuzës.

³³ Ne përmendëm vetëm këto dy dokumente pasi gjykata nuk duhet të shkojë përtej aktakuzës, Neni 360, par. 1, KPPK, “*Aktgjykimi mund t’i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor*”.

- Pranimi i ryshfetit (në kundërshtim me nenin 343.1 të KPK të Përkohshëm) – të pandehurit N.K., S.H. dhe S.F. (Akuza 2)

Në versionin e mëparshëm, Neni 343, paragrafi 1, i KPPK, vepra penale është përshkruar si më poshtë: *“(1) Personi zyrtar i cili kërkon ose merr dhuratë a përfitim tjetër për vete ose personin tjetër ose që pranon premtimin për dhuratë ose për ndonjë përfitim tjetër për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ai nuk duhet ta kryejë ose të mos e kryej një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai duhet ose ka mundur ta kryejë dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet. (2) Personi zyrtar i cili u kërkon ose pranon një dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për vete apo personin tjetër ose që pranon një premtim për një dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një akt zyrtar apo të tjera të cilën ai ose ajo duhet të ketë kryer ose të dështojnë për të kryer një akt zyrtar të cilin ai ose ajo nuk mund të kryejnë, do të dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet. (3) Personi zyrtar i cili pas kryerjes ose moskryerjes së një veprimi nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni kërkon apo pranon dhurata ose ndonjë përfitim për vete apo për personin tjetër në lidhje me kryerjen apo moskryerjen e tillë dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. (4) Dhurata apo përfitimi tjetër që është marrë konfiskohen”.*

Në krahasim me versionin e ri të veprës penale, sipas nenit 428 KPK, ish paragrafët 3 dhe 4 nuk ekzistojnë më. Në lidhje me dy paragrafët e parë, ka pasur ndryshime të vogla në formulimin e përdorur dhe në dënimet e parashikuara; në paragrafin 1 të nenit 428 (Kodi i ri) gjobë aktuale i është shtuar burgut (nga 6 muaj deri në 5 vjet) dhe në paragrafin 2 dënimi është dukshëm më i rëndë, nga 3 vjet deri në 12 vjet burgim (krahas një gjobe), ndërsa më parë në kodin e vjetër dënimi i paraparë ishte vetëm nga 3 muaj deri në 3 vjet burgim, pa asnjë gjobë. Nga ana tjetër, versioni i ri përfshin një rrethanë të re rënduese (paragrafi aktual 3), **“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”.**

Në të dyja versionet, lidhur me kryerësin, ajo është një vepër penale që nuk është e zakonshme, por specifike, që do të thotë se autori duhet të jetë zyrtar, jo çdokush mund ta kryejë këtë vepër penale.

Mens rea (d.m.th. elementi subjektiv) është dashja. Në të dyja versionet vepra penale duhet të kryhet vetëm me dashje direkte.

Në lidhje me mënyrën e kryerjes, kjo vepër penale, në të dyja versionet, mund të jetë kryer nga një veprim ose mosveprim.

Vepra penale mbron vlerën juridike të interesit publik në luftën kundër korrupsionit, “*të gjitha përkufizimet e përkufizojnë korrupsionin si shpërdorim të pushtetit publik, me qëllim që të sigurohet një përfitim i paligjshëm për personin i cili e kryen këtë funksion*”³⁴. Është paraparë që të gjithë zyrtarët në detyrat e tyre zyrtare duhet të marrin parasysh vetëm detyrat e tyre për të mbrojtur interesin publik, dhe asnjëherë interesat e tyre private apo personale.

Vepra penale mund të jetë e duhur apo jo e duhur: jo e duhur nëse veprimi apo mosveprimi i kryesit nuk është kundër detyrimit zyrtarë (paragrafi 1), dhe e duhur nëse është kundër, nëse kjo është një shkelje (paragrafi 2.).

Ligji i ri nuk është më i favorshëm për ndonjërin nga të pandehurit, jo vetëm për shkak se tani përshkruhet gjobë bashkë me burgun, por edhe për shkak se të pandehurit K. dhe F. do të binin, nëse faktet e përmendura në aktakuzë vërtetohen, në kategorinë e rëndë të paragrafit 3 të nenit 428 të KPK-së së re (dhe kjo përmendet për shkak se gjykata nuk është e detyruar me klasifikimet ligjore të bëra nga prokuroria, siç u deklarua tashmë).

Nga faktet e vërtetuara përtej dyshimit të arsyeshëm nuk është e mundur të thuhet se të pandehurit në fjalë kanë marrë dhurata ose përfitime, ryshfet. Ishte e mundur vetëm të vërtetohej se “gjatë ekzekutimit të kontratës së projektimit dhe ndërtimit të parkut industrial në D., një ditë, ndërsa i pandehuri K. ishte së bashku me (tani dëshmitarin) H.Z. duke pirë kafe në Hotel P. në M., me idenë e këtij të fundit, i pandehuri B. shkoi atje pasi i kishte telefonuar K. dhe e kishte pyetur se ku ishin, u ul me ta dhe bisedoi për gjëra të parëndësishme”.

³⁴ Komentari, neni 428, pika 11.

Është e lehtë të kuptohet, dihet se një takim i personit zyrtar me një person të përfshirë në një kontratë të vazhdueshme nuk mund të jetë gjë e mençur, mund të shkaktojë dyshime; thënia e vjetër vlen qartazi për zyrtarët, “kjo mjafton që gruaja e C. të jetë e respektuar, ajo duhet edhe të duket se është e respektuar” ...

- Lidhja e kontratës së dëmshme (në kundërshtim me nenin 237.1 dhe 2 të KPK-së së Përkohshme) – I pandehuri N.K. (Akuza 3)

Neni 237 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës parashikon “(1) *Personi i autorizuar a përfaqësuesi i organizatës së biznesit apo personit juridik që ushtron veprimtari ekonomike dhe lidh kontratë për të cilën e di se është e dëmshme për organizatën e biznesit ose për personin juridik apo lidh kontratë në kundërshtim me autorizimet e tij dhe me këtë i shkakton dëm organizatës së biznesit apo personit juridik dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet. (2) Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 i këtij neni merr rryshfet apo nëse shkakton dëm në shumën e cila tejkalon 100.000 EUR dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet*”.

Në versionin e ri, neni 291 i KPK-së, paragrafi i dytë (rrethanë rënduese nëse veprimi ishte rezultat i një rryshfeti ose në qoftë se dëmi i shkaktuar kalon 100,000 euro) mbajti formulimin, ndërsa në të parin ligjvënësi e ka ndryshuar atë në përkufizimin e kryerësit, duke zëvendësuar fjalët “një përfaqësues ose person i autorizuar i organizatës së biznesit ose personit juridik” me “një person përgjegjës”, - por sanksioni ka mbetur i njëjtë.

Meqë nuk ka ndryshime që, në përputhje me faktet relevante eventuale të përcaktuara, mund të ngrinin çështjen e ligjit më të favorshëm, në tekstin e mëtejshëm të gjitha referencat do të bëhen në versionin në fuqi në atë kohë, Neni 237 i KPPK-së.

Vlera juridike e mbrojtur me këtë vepër penale është ndershmëria në kryerjen e biznesit në emër të një organizate ose personi juridik dhe realizimi i interesit publik.

Sa i përket kryerësit, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm nga një person i cili ka mundësinë të jetë përgjegjës për vendimin në emër të një organizate,

“përgjegjës”, “person i autorizuar”. Prandaj, përsëri, në këtë aspekt, kjo nuk është vepër penale e zakonshme, por e veçantë (në kuptimin shpjeguar më lart).

Mens rea (elementi subjektiv) është dashja, “dijenja” (pasi në këtë vepër të veçantë ligjdhënësi ka përdorur foljen ‘di’) se kontrata e lidhur do të jetë e dëmshme, “kontrata mund të jetë e ndryshme, duke filluar nga **blerja** dhe shitja, cilësia e mallrave, transporti, kontrolli, dërgesa, **ndërtimi**, mirëmbajtja, dhe të tjera, në varësi të natyrës së objektit të kontratës së lidhur” [**theksimi i shtuar**]³⁵. Në lidhje me çështjen e “dijenisë” dhe “dashjes”, vlen të vihet në dukje se koncepti i “dijenisë” duhet të interpretohet në përputhje me pritshmërinë e arsyeshme të një qytetari të zakonshëm, diçka që për shkak të funksioneve dhe detyrave të tij të përditshme, individi duhet të dijë, kështu që ai nuk mund të mbështetet në arsyetimin e mosnjohjes së ligjit – pasi e njëjta vlen për çdo ligj në përgjithësi.

Në lidhje me mënyrën e kryerjes, kjo vepër penale, në të dyja versionet, mund të kryhet vetëm me një veprim, i cili është angazhimi në kontratë, “është detyra e këtyre personave të veprojnë me përgjegjësi dhe të mbrojnë interesat e organizatës ose personit juridik që lidh një kontratë. Kontrata duhet të jetë në interes të palës kontraktuese; përndryshe organizata e biznesit nuk do të kishte ndonjë interes në lidhjen e kontratës. Pra, kontrata nuk duhet të jetë e dëmshme për një palë, përndryshe ajo do të ishte në kundërshtim me bazat dhe parimet e organizimit të biznesit ³⁶. (...) Në qoftë se ata veprojnë **në kundërshtim me autorizimin e caktuar** dhe kontrata lidhet në dëm të organizatës ose personit juridik, atëherë ajo merr karakterin e aktit të rrezikshëm për të, në interes të së cilës është lidhur kontrata, për rrjedhojë ajo parashikohet si vepër penale [**theksimi i shtuar**]³⁷³⁸. Në fakt, “kjo vepër penale është e ndarë në dy forma: a) si lidhja e kontratave të dëmshme dhe b) **të lidhja e një kontratë në kundërshtim me**

⁴⁴ dhe vlen të përmendet se “dëmi nuk është **autorizimet**” [**theksimi i shtuar**]

³⁵ Komentari, pika e parë 1.

³⁶ Komentari, pika e parë 2.

³⁷ Komentari, pika e parë 3.

³⁸ Komentari, pika e parë për analizën e veçantë të paragrafit 1.

gjithmonë pasuror, ai mund të jetë edhe jo pasuror”³⁹; “forma tjetër e kësaj veprë penale është kur autori lidh kontratë nëkundërshtim me autorizimet e dhëna. Për këtë formë nuk është e nevojshme që autori duhet të dijë se kontrata është e dëmshme për organizatën apo personin juridik”⁴⁰, dhe “Pasojë e veprës penale është dëmi që i është shkaktuar organizatës ose personit juridik. Kjo pasojë duhet të ketë lidhje shkakore me kontratën e lidhur, çka do të thotë, nga momenti i lidhjes së kontratës së dëmshme ajo për pasojë rezultoi në shkaktimin e veprës. Dëmi mund të jetë pasuror ose jo pasuror i shkaktuar organizatës ose personit juridik për llogari të të cilit është lidhur kontrata.”⁴¹

Ligji gjithashtu përshkruan një mënyrë të ndryshme të kryerjes së veprës penale (*e dëmshme për organizatën e biznesit apo personin juridik, ose lidh një kontratë në kundërshtim me autorizimet e tij dhe në këtë mënyrë i shkakton dëm organizatës së biznesit*); në qoftë se është një kontratë **në kundërshtim me autorizimet** (e parashikuara në ligj) [**theksimi i shtuar**], atëherë duhet të ketë një dëm që është i konkretizuar (“*dhe me këtë i shkakton dëm*”); nuk është e mjaftueshme të thuhet se ka pasur dëm, duhet të ketë prova të sasisë së tij. Prandaj, në një mënyrë të tillë të kryerjes së veprës penale, pra, duke tejkalluar autorizimet (d.m.th. ato të parashikuara në ligj...), ose duke vepruar “në kundërshtim” me to, një sasi konkrete dëmi është e nevojshme. Në këtë rast asnjë sasi dëmi nuk u konkretizua apo përcaktua.

Gjykata nuk është e lidhur me klasifikimin ligjor të bërë nga Prokuroria në lidhje me aktet, faktet, siç parashikon neni 360, paragrafi 2, KPP dhe sic u tha më herët në analizën e veprës së tillë penale, zbatohet këtu.

Në këtë akuzë po diskutojmë për aneks kontratën (i pari nga dy...) dhe gjykata shënon në radhë të parë, së kontrata e tillë e bërë nga i pandehuri N.K. në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së bashku me dhe Kompaninë“E.” nuk bën asnjë lloj reference në ndonjë dispozitë ligjore apo në ndonjë bazë ligjore që do ta lejonte atë.

Për më tepër, trupi gjykues, gjykata, është e mendimit se paligjshmëria e

³⁹ Komentari, pika e tretë, *in fine*, për analizën e veçantë të paragrafit 1.

⁴⁰ Komentari, pika e pestë, *in fine*, për analizën e veçantë të paragrafit 1.

⁴¹ Komentari, pika e gjashtë, *in fine*, për analizën e veçantë të paragrafit 1.

“aneks-kontratës” së tillë është aq e hapur se nuk ka marrë një përshkrim të ndërlëkuar për ta parë atë dhe se si abuzimi i autoritetit zyrtar, se si kufijtë e autorizimeve (ligjore) u tejkaluan nga i pandehurit N.K. në lidhje me projektin dhe ndërtimin e parkut industrial në D. në përfitim të Kompanisë “E.” nëpërmjet aneks-kontratave, pa respektuar ligjet për prokurimin, pa ndonjë tender (tjetër) ose, me fjalë të tjera, për të transformuar një kontratë në shumën 144.000 Euro / 69.825,25 euro çmimi për njësi [por ... pa përmendur numrin e njërive dhe përkundër referencës në kontratë, pika 6 e nenit 4, “kjo do të jetë një kontratë e bazuar në çmimin për njësi dhe çmimin e ofruar për shumën e përgjithshme të projektit (...)”] në një kontratë në shumën 1.730.000 euro dhe parashikon një “kontratë aneks” në shumën 14.580 euro (shih nenet 1 dhe 2 të aneks-kontratës në fjalë të datës 20/07/2006). E gjithë kjo, kur, në pajtim me nenin 34.2 d) të Ligjit për Prokurimin 2003/17 dhe vetëm nëse plotësoheshin të gjitha kushtet e përcaktuara..., kontrata fillestare mund të arrijë në 10% më shumë, 144.000 euro + 14.400 euro = 158.400 euro.

Përkundër faktit se gjykata nuk ka nevojë të trajtojë çdo argument të vetëm të përdorur nga ana e mbrojtjes, ajo që ndodhi është kundër logjikës themelore të prokurimit, qeverisjes së mirë, përdorimit të fondeve publike në mënyrë transparente: edhe të ashtuquajturat projekte të projektimit dhe ndërtimit që i pandehuri Krasniqi trajtoi në deklaratat e tij përmbyllëse kanë një shumë të përgjithshme si njërin nga elementet e kontratave të tilla (“struktura e çmimeve dhe pagesës së kontratës është e bazuar në një shumë të përgjithshme me faza të ndërmjetme ose pagesa periodike”, shih, për shembull, “Kontrata e Dizajnit dhe Ndërtimit”)⁴² dhe në asnjë mënyrë, kur është fjala për fondet publike, nuk i shmang ligjet e zbatueshme për prokurimin. Kontratat nuk mund të bëhen kundër ligjit, ose në një mënyrë të veçantë të krijojnë pamjen se janë të ligjshme; të gjitha elementet

⁴² “• Mund të përdoret në projekte të mëdha apo më të vogla, por në përgjithësi kur dispozita të hollësishme janë të nevojshme. • Kontraktori është përgjegjës për përfundimin e dizajnit, si dhe kryerjen e punimeve, dhe punëdhënësi duhet të sigurojë dokumente të hollësishme për të përshkruar kërkesat e tyre. • Struktura e çmimit dhe pagesës së kontratës bazohet në një shumë paushall me fazë të ndërkohshme ose pagesa periodike. • Janë përfshirë dispozita për punë bashkëpunuese, qëndrueshmëria, paradhënie, obligacione (paradhënie, materiale jashtë kantierit, ruajtje), të drejtat e palëve të treta dhe garancitë kolaterale. • Për përdorim në të dy projektet e sektorit privat dhe publik. Shih gjithashtu Plotësues i Sektorit Publik. • Marrëveshja e Shërbimeve të Para-ndërtimit (Kontraktori i Përgjithshëm) (PCSA) dhe Specialisti i Marrëveshjes së Shërbimeve të Para-ndërtimit (PCSA / PS) mund të përdoren me këtë kontratë. • Kjo kontratë mund të përdoret me Marrëveshjen Kornizë (MK)” - Në <http://www.jctltd.co.uk/category/design-and-build-contract>

duhet të jenë atje (si “numri i njësisive”, “vlera totale e projektit”, qoftë ashtu, dhe objekti i saj duhet të jenë të qarta dhe transparent që nga fillimi, me qëllim që aplikantët të mund të paraqesin oferta të duhura për vlerësim...). Nuk ka *carte blanche* apo “fre të lirë”, kur është fjala për përdorimin e fondeve publike... Zyrtarët duhet të veprojnë në përputhje me ligjin.

Çdo kontratë është nga natyra një përfitim material për një kompani (“përfitimi pasuror” dhe “fitimi” janë koncepte të ndryshme dhe “përfitimi pasuror” ishte ai i përdorur nga ligjvënësi), për një ndërtues, dhe kontratat që lidhen nga një subjekt publik rregullohen me Ligjin e Prokurimit.

Gjykata bën një pyetje retorike, si mund të jetë e ligjshme, e mundur të ketë një tender (me të gjitha detajet dhe procedurat që nënkupton) për një kontratë në shumën 144.000 euro (dhe çmimin për njësi 69.825,25 euro, pavarësisht se nuk përmendet asnjë numër njësisish...) dhe të ketë një të tillë në shumën 1.730.000 euro (ose, nëse zbritet 144.000 euro, 1.586.000 euro, apo edhe 1.571.600 euro, nëse në vend që të zbritet shuma e ofertës fituese, kontrata fillestare me 144.000 euro, u zbrit shuma 158.400 eurove) pa tender (dhe njoftimi për kontratë në procedurë të hapur nuk përmendte asnjë njësi), të vendosur nga një person i vetëm i cili merr vendimin dhe e nënshkruan atë? Kjo kontratë ishte për leverdi të kompanisë “E.”, pasi u bë pa ndonjë tender dhe shteti u privua nga dijenia se çfarë propozimesh të tjera mund të ekzistonin. Cili ishte qëllimi i të pasjes së një komisioni, jo një individ, që të vlerësonte ofertat fillestare?

Ligji për Prokurimin 2003/17, në fuqi në atë kohë, u injorua tërësisht dhe qëllimi i tij u shkel haptazi nga i pandehuri, pasi Ligji në fjalë për Prokurimin përcakton në Nenin 1 qëllimin e tij: ***“1.1 Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. 1.2 Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, shërbyesit civil dhe personat e tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet***

të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, janë të lirë të ndonjë interes personal, karakterizohen me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës, dhe janë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. 1.3 Së fundi, ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të paanshme, etike dhe materialisht pa interes profesionalizmit në mesin e të gjithë zyrtarëve publikë, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë që kryejnë ose të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga këta individë për të kryer veten në një mënyrë që është informuar vetëm nga objektivin e arritjes përdorimin më efikas, me kosto efektive, transparente dhe të drejtë të fondeve publike dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji” [theksimi i shtuar].

Sipas Nenit 2 të të njëjtit Ligji, në fushëveprimin e tij, **“1. Ky ligj zbatohet për aktivitetet e prokurimit të autoriteteve kontraktuese dhe koncesionerëve të punëve, ashtu si përcaktohen këto terme në këtë ligj. Autoritet kontraktues dhe koncesionerët kërkohet që, gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre të prokurimit, t’i respektojnë dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. 2.2 Ky ligj vlen edhe për të gjithë personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, siç përcaktohen këto terme në këtë ligj, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në aktivitete prokurimi të rregulluara me këtë ligj; personat e tillë, operatorët, dhe ndërmarrjet poashtu kërkohet që t’i respektojnë dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji” [theksimi i shtuar].**

Mund të jenë cituar shumë dispozita të tjera, por do të përmenden vetëm ato dispozita të tjera që nuk u respektohen. Situata e tanishme nuk bie në ndonjërin nga përjashtimet e përcaktuara në nenin 3 dhe përkufizimet përkatëse janë të vendosura në nenin 4.

Neni 5 sqaron konceptet e efektivitetit të koston dhe efikasitetit, pasi “të gjitha autoritetet kontraktuese (...) janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”. Është e rëndësishme të sjellim në vëmendje konceptin e **kontratave me vlera të mëdha**, sipas nenit 18, paragrafi 1, b), **“18.1 Kontratat në vijim konsiderohen” kontrata me vlerë të**

madhe: (...)kontrata për punë ose pronë të paluajtshme, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritet të jetë e barabartë me ose më e madhe se 250,000 euro” – në mënyrë të konsiderueshme më të ulëta se shumatat e diskutuara në këtë lëndë...

Për të vepruar në pajtim me nenin 24, paragrafi 1, i pandehuri Krasniqi, si kreu i departamentit të prokurimit në MTI, nënshkroi aneks-kontratën në fjalë.

Neni 27 thotë qartë se *“Për secilën kontratë publike të propozuar, përveç një kontrate me vlerë minimale, autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kritere të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti (...)”* dhe përkufizimi i “kontratës publike” mund të shihet në nenin 4 dhe përkufizimi i “kontratës me vlerë minimale” është parashikuar në nenin 18, paragrafi 4, ai është *“(...) Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është më e vogël se, ose me arsye pritet që të jetë më e vogël se 500 Euro”*.

Faktet nuk bien në fushëveprimin e nenit 31 (procedurave e përgjithshme të kufizuara), dhe në çdo rast nuk u plotësuan kushtet, në të njëjtën mënyrë neni 32 nuk zbatohet.

Gjithashtu, kërkesat ligjore të nenit 33 nuk u respektuan, po ashtu si ato të përcaktuara në nenin 34, sipas paragrafit 2 d) (i) *“Autoriteti kontraktues mund të kërkojë një autorizim për përdorimin e procedurave të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e (...) një kontrate të shërbimeve ose punëve: për zbatimin ose ekzekutimin e shërbimeve ose punëve shtesë që nuk ishin përfshirë as në konceptimin fillestar të një projekti të punëve të dhënë më parë dhe as të paraqitura në kontratën përkatëse të punëve që është përmbyllur më parë, por të cilat, përmes rrethanave të paparashikuara, janë bërë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve ose punëve të përshkruara në projektin ose kontratën e tillë.. Me kusht që ky nen 34.2.d (i) të mund të shfrytëzohet vetëm nëse (a) kontrata që i mbulon shërbimet ose punët e tilla shtesë ti ipet operatorit ekonomik që është duke i ekzekutuar shërbimet ose punët fillestare dhe (b) shërbimet ose punët e tilla shtesë,*

teknikisht ose ekonomikisht nuk mund të ndahen nga kontrata kryesore pa i shkaktuar dëme autoritetit kontraktues. Më tutje, me kusht që, ky nen 34.2.d(i) të mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për shërbime ose punë shtesë që vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës fillestare.”[theksimi i shtuar].

Nuk është e mundur të thuhet në një moment, sepse është e përshtatshme, se projekti (tenderi) ishte vetëm për “dizajnin”, dhe për këtë qëllim do të thotë se ishte “dizajni dhe ndërtimi” – pasi në këtë rast prapëseprapë nuk do të kishte ndonjë rrethanë të paparashikuar; por, edhe sikur të mos ishte kështu, prapëseprapë kufiri 10% i shumës së kontratës fillestare nuk mund të injorohet dhe shkelet...

Megjithatë, në qoftë se e gjithë kjo nuk ishte e mjaftueshme, fakte të tjera flasin vetë: data e kërkesës në Agjencinë e Prokurimit Publik për të hyrë në procedura të negociuara sipas nenit 34 ishte 20/06/2006 dhe shuma e kërkuar ishte 14.580 euro për punime shtesë, duke pretenduar se vlera e kontratës ishte 1.700.000 euro përafërsisht; më 20/07/2006 kontratës së vetme ekzistues deri në atë datë, ajo e datës 07/10/2005, iu ndryshua vlera nga 144.000 euro, çmimi për njësi (megjithëse nuk ceket asnjë herë të vetme në ofertë dhe më vonë në kontratën e nënshkruar se sa njësi do të kërkonte projekti...) 69.825,25 euro, deri në 1.730.000 euro dhe në fund punimet shtesë në shumën 14.580 euro të përmendura në kërkesën e datës 20/06/2006 nuk u përfshinë në aneksin e parë të Kontratës që pasoi, më datë 20/07/2006, por vetëm në aneksin e dytë të kontratës, datë 28/09/2006 ...

Megjithëse nuk trajtohet drejtpërdrejt në këtë akuzë, është e rëndësishme të përmendet radha e zotimit të fondeve dhe pagesave që ndodhën përgjatë muajve në fjalë, sipas fakteve të vërtetuara, që do të thotë se, sipas mendimit të trupit gjykues kryeja e kontratave publike në këtë mënyrë është krejtësisht e papranueshme, është njëllë sikur të mos kishte (pothuajse) fare ligj për prokurimin; çdo gjë ishte e gabuar dhe duket se po bëhej pothuajse gjithçka, përfshirë punën shkresore (“dokumentet”...), vetëm për të krijuar një iluzion se gjërat po bëheshin në përputhje me ligjin. Çfarë ndodhi në këtë rast shtron edhe pyetjen retorike se për

çfarë ishin procedurat fillestare të prokurimit, çfarë ishte dobia e ofertave që u vlerësuan nga komisioni për dhënien e tenderit...

Qëllimi i legjislacionit të prokurimit është të sigurohet që kjo lloj situatë të mos ndodhë dhe paratë e publikut të shpenzohen si duhet. Me fjalë të tjera, në qoftë se ligji përcakton një prag mbi të cilin duhet të ekzistojë një ftesë e re për tenderim (në këtë rast ai është 10%), arsyeja është pikërisht për të siguruar që paratë publike të shpenzohen mirë dhe kontratës t'i jepet oferta më e mirë. Në këtë drejtim, ne tani citojmë *a fortiori* Nenin 6.6 të Ligjit 2003/17, dhe themi *a fortiori* pasi këtu nuk kishim asnjë prokurim të ri, procedurë të hapur që do të çonte në një tender: “6.6 Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të marrin masa të arsyeshme dhe të nevojshme **për të garantuar; (i) pjesëmarrjen sa më të gjërë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënje, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse” [theksimi i shtuar].**

Duke pasur parasysh gjithçka që u tha, të gjithë elementët përbërës të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar janë të pranishëm dhe i pandehuri N.K. e kreu atë edhe në këtë akuzë.

Bashkimi i veprave penale

Në rastin e të pandehurit N.K.t është e rëndësishme të sqarohet se ai ka kryer dy vepra penale të shpërdorimit të pozitës ose autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 të KPK-së, jo vetëm një në vazhdimësi.

Sipas nenit 81 të KPK-së, **“Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim: 1.1 viktimës së njëjtë të veprës penale; 1.2 objekti i njëjtë i veprës; 1.3 shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore; 1.4 vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; dhedashja e njëjtë e kryesit”**.

Duke pasur parasysh faktet e vërtetuara nuk është e mundur të përfundohet se i pandehuri kreu vetëm një vepër penale, si të tërë; vetëm kushti i “dashja e njëjtë e kryerësit” është plotësuar, për të siguruar përfitim pasuror të kompanisë “E.”, dhe ligji kërkon që së paku dy nga këto kushte janë plotësuar.

Qasja e përgjithshme doktrimore ndaj bashkimit të veprave penale është se, si rregull, numri i veprave penale përputhet me numrin e veprave penale të kryera; përjashtim është kur veprat penale të shumta (të paktën dy) janë kryer në një mënyrë që përputhet me kushtet e vendosura në ligj, kur mënyra e kryerjes është identike, situata ose korniza e përgjithshme është në thelb e njëjtë, në mënyrën që është e mundur të pohohet se fajësia e kryesit është zvogëluar ndjeshëm. Për të vlerësuar këtë zvogëlim të fajit, përdoren kushtet e vendosura në ligj; me pak fjalë, vepra penale në vazhdim ekziston vetëm kur për individin (kryerësin) mund të bëhet vetëm një gjykim fajësie, jo më shumë, që nuk është kështu, edhe për shkak se mënyra e kryerjes së veprës së dytë ishte dukshëm më e ndryshme; është një vepër penale tjetër, jo një përsëritje, si të thuash, e të mëparshmes (kjo do të ishte kështu, për shembull, në lidhje me pagesat e tjera të paligjshme të tjera se sa ato të përmendura në akuzën një).

Arsyeja pse ligji parashikon dënim më të butë të veprave penale në bashkim është t’i sigurojë gjykatës mjetet ligjore për ta lejuar atë të jetë e drejtë në dritën e fajit të zvogëluar, jo t’i japë kryerësit një zbritje pse ka praktikuar më shumë se një vepër penale.

Referencat e shkurtra tek format e pafajësisë: për shkak të provave të të qenit i pafajshëm dhe lirimit për shkak të prezumimit të pafajësisë

Një çështje e fundit që duhet trajtuar janë dy mënyra për t'u liruar. Vendimi i pafajësisë mund të arsyetohet në dy mënyra: ose për shkak se është vërtetuar se i akuzuari nuk i ka kryer faktet me të cilat ai është akuzuar, ose sepse nuk ishte e mundur të vërtetohej se çfarë saktësisht mund, ose nuk mund të ketë ndodhur, që ndodh kur faktet kryesore mbeten të paqarta dhe vetëm një pjesë e fakteve mund të vërtetohej. Kjo e fundit mund të ndodhë për shkak të mungesës së plotë të provave ose sepse provat nuk janë prodhuar në një mënyrë që e lejon trupin gjykues për t'i vërtetuar ato përtej dyshimit të arsyeshëm. Kur pas paraqitjes së provave, gjykata është ende në dyshim, ose të paktën nuk është përtej dyshimit të arsyeshëm, zgjidhja ligjore është të marrin parasysh faktin që nuk është vërtetuar – pasi çdo dyshim duhet vlerësuar në dritën e parimit *in dubio pro reo*.

Natyrisht është më mirë për të pandehurin i cili po lirohet nga akuza që ta bëjë gjykatën të shqiptojë pafajësinë, dhe jo thjesht të deklarojë se nuk ishte e mundur të provoheshin faktet përtej dyshimit të arsyeshëm dhe, prandaj, se ai po lirohet nga akuza si pasojë e drejtpërdrejtë e parimit *indubio pro reo*.

Caktimi i dënimit

Akuza 1 (të pandehurit N.K., A.Z., S.H. dhe S.F.): keqpërdorim i pozitës zyrtare, nga neni 422 i KPK-së, lidhur me nenet 3, paragrafi 2, dhe 31 të KPK-së, lidhur me nenet 41, 45 dhe 73 të KPK-së.

Sipas Nenit 41 të KPK-së, “qëllimet e dënimit janë: **të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; 1.2. të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; 1.3. të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe 1.4. të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit**”.

Vepra penale e keqpërdorimit të pozitës ose autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 të KPK-së, dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet, ndërsa, duke pasur

parasysh faktet e vërtetuara, do të zbatohet paragrafi 3 i nenit 339 të KPPK-së, sipas të cilit “Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumën 5.000 EUR, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet”. Në këtë situatë, sipas Nenit 3.2 të KPK-së, që përfshin parimin e ligjit më të favorshëm, **“Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm”**. Prandaj, pasi që si burgimi minimal, ashtu dhe ai maksimal të përcaktuar në ligj janë më të ulët në kodin e ri, është e qartë se ligji i ri është më i favorshëm, neni 422 i KPK-së, **“burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet”**. Dënimi me burgim, sipas nenit 45, paragrafët 1 dhe 2, të KPK **“(…) nuk mund të jetë më pak se tridhjetë (30) ditë ose më shumë se njëzet e pesë (25) vjet. (…) Dënimi me burgim shqiptohet në vite dhe muajt të plotë (…)”**.

Në bazë të nenit 73, paragrafët 1 në 3, të KPK-së, **“(1). Kur cakton dënimin për veprë penale, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë veprë penale. Gjukata pastaj duhet të merr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin. (2). Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit. (3). Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme: 3.1. shkallën e përgjegjësisë penale; 3.2. motivet për kryerjen e veprës; 3.3. intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; 3.4. rrethanat në të cilat është kryer vepra; 3.5. sjelljen e mëparshme të kryesit; 3.6. pranimin e fajit; dhe 3.7. rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale”**. Këta janë faktorë që gjykata do t'i marrë parasysh, me përjashtim të nën-paragrafit 3.6, i cili nuk zbatohet këtu; përkundrazi, asnjëherë të pandehurit nuk e pranuan fajësinë e tyre, ndonëse në mënyra të ndryshme.

Prandaj, minimumi dhe maksimumi janë 6 muaj dhe 5 vjet, përkatësisht, përveç nëse gjykata e përkeqëson apo e zbut dënimin, në pajtim me nenin 74. Në aspektin e rrethanë rënduese, pasi që ky është dënimi i parë i të pandehurve, gjykata vendos të mos e zbatojë rrethanën rënduese nga neni 74, paragrafi 2.9, **“çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale”**, pasi ajo është thelbi i vetë veprës penale dhe, siç u vu në

dukje, ky është dënimi i parë. Sa u përket rrethanave lehtësuese, paragrafi 3 i të njëjtit neni, gjykata mund të marrë parasysh, në lidhje vetëm me të pandehurin Zogjani, faktin që po të mos kishte qenë auditimi dhe raportimi i tij, ndoshta këto fakte nuk do të ishin hetuar. Sipas nenit 75, paragrafi 1.2, **“kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë”**. Megjithatë, vlejné të theksohet se vetëm pjesët e zbuluara të fakteve dhe se ai kurrë nuk e pranoi fajin e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor në lidhje tërësinë e fakteve, duke pasur parasysh se ai ishte duke vepruar sekretar i përhershëm.

Neni 73 i KPP-së jep kriteret për të përcaktuar dënimin në bazë të fakteve: N.K. tregoi një intensitet të lartë të rrezikut, dëmtimit të vlerave të mbrojtura, pasi ai është zyrtari i prokurimit, lidhi kontratat fillestare dhe aneks-kontratat, duke shkelur hapur normat e zbatueshme dhe fajësia, dashja e tij, është intensive në të dy rastet; A.Z. ishte sekretar i përhershëm dhe si i tillë ka përgjegjësinë më të madhe në mbikëqyrjen e procesit si zyrtari kryesor administrativ, por gjykata konsideron gjithashtu se ai ishte personi që mundësoi hetimin e fakteve; S.H. ka në favor të tij faktin se ai vetëm po zëvendësonte zyrtarin certifikues (i cili për akte identike, për të mos thënë më keq, as u akuzua), dhe në fund S.F. ka disi një nivel më të ulët të përgjegjësisë penale, kur krahasohet me të pandehurit e tjerë dhe rolet e tyre (duke marrë parasysh detyrat kontraktuale të kompanisë “N.” dhe gjithashtu detyrat e të pandehurve të tjerë). Nëse nga njëra anë asnjëri prej tyre nuk ka dosje penale, nga ana tjetër ata janë persona që mbajnë diploma universitare (dhe në rastin e N.K.t dhe S.H. profesionet e tyre aktuale, pasi ata janë ende shërbyes publikë që punojnë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe inspektimet e brendshme të PTK-së, përkatësisht) dhe parandalimi i përgjithshëm i këtij lloji të veprave penale në Kosovë nuk mund të ishte më i lartë, pasi qytetarët presin që zyrtarët të veprojnë në përputhje me ligjin dhe puna e tyre synon përfitimin e vendit dhe të qytetarëve, askush apo asgjë tjetër.

Duke marrë parasysh gjithçka të deklaruar deri tani, faktet e vërtetuara, normat dhe parimet, gjykata përcakton dënimet e mëposhtme të burgimit: N.K. 12 muaj burgim, A.Z. 10 muaj burgim, S.H. 8 muaj burg dhe S.F. 7 muaj burgim.

Akuza 3 (i pandehuri N.K.): keqpërdorim i pozitës zyrtare, nga Neni 422 i KPK-së, lidhur me 3, paragrafi 2, dhe 31 i KPK-së, lidhur me nenet 41, 45, dhe 73 të KPK-së.

Duke ndjekur normat parimet, faktet dhe kriteret e njëjta, të përmendura më lart, gjykata zbaton dënimin me burgim prej 18 muajsh ndaj të pandehurit N.K..

Dënimi unik (i pandehuri N.K.)

Dënimi unik i të pandehurit N.K. duhet të përcaktohet në pajtim me nenin 80 të KPK-së. *“Nëse kryesi me një apo me më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpall dënime për secilën nga këto vepra, e pastaj për të gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik.”* (Neni 80, paragrafi 1, KPK), dhe *“gjykata shqipton dënimin unik sipas këtyre rregullave (...) nëse për secilën prej veprave penale gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim, por dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantëpor dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara (...)”* (Neni 80, paragrafi 2.2. i KPK).

Në bazë të nenit 80, paragrafi 2.2. të KPK-së, dënimi duhet të përcaktohet midis jo më pak se 18 muaj burgim dhe jo më shumë se 30 (12 + 18) muaj burgim dhe këtu vendoset në 26 muaj burgim për kryerjen e dy veprave penale të shpërdorimit të pozitës ose autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 të KPK-së.

Ekzekutimi i menjëhershëm kundrejt pezullimit të dënimeve

Dënimet me burgim mund të pezullohet në pajtim me nenet 50 deri në 52 të KPK-së, *“Qëllimi i dënimet me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimet është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale”*. Kërkesat për pezullimin e dënimet me burgim janë vendosur në nenet 51 dhe 52, *“Gjykata mund t’ia shqiptojë kryesit dënimin me kusht në përputhje me dispozitat e këtij Kodi”*, domethënë, *“Me dënimin me kusht, gjykata ia cakton kryesit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse*

personi i dënuar nuk kryen veprë tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit dhe as më e gjatë se pesë (5) vjet” (neni 51, paragrafi 2, KPK) dhe *“dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet (...) dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nëse gjykata shqipton dënimin me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet, qoftë për një veprë penale ose për disa vepra në bashkim”* (neni 52, paragrafët 1 dhe 3, KPK) dhe *“me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale”* (neni 52, paragrafi 4, KPK).

Pavarësisht pesha e rëndë e kësaj lloji veprë penale, kërkesat e paraqitura nga parandalimi i përgjithshëm, siç u shpjegua më lart, dëmtimi ndaj qeverisjes së mirë dhe shoqërisë në tërësi, që çojnë në një nevojë shumë të lartë për parandalimin e recidivizmit apo kryerjes së veprave penale të njëjta nga individë të tjerë, nga njëra anë, dhe nevoja e lartë e dënimit, nga ana tjetër, është gjithashtu e vërtetë se faktorë të tjerë duhet të merren parasysh në lidhje me të pandehurit A.Z., S.H. dhe S.F. (lodhur me të pandehurin N.K. nuk është e mundur të merret parasysh dënimi me kusht, pasi dënimi i tij me burgim është më i lartë se 2 vjet).

Ndër këta faktorë mund të theksojmë se shumë vite kanë kaluar që nga kryerja e fakteve dhe deri në këtë moment nuk ka asnjë njoftim se ata kanë kryer në ndërkohë vepra të tjera penale; ky është konfrontim i tyre i parë me sistemin formal të kontrollit, që është ligji penal.

Një faktor për t’u vlerësuar këtu është veprimtaria e tyre aktuale profesionale, pasi H. (i diplomuar në ekonomi) ende mban një pozitë si nëpunës publik, siç u tha (në inspektimet e brendshme të PTK-së). Megjithatë, i pandehuri Z., në këtë drejtim, është aktualisht ekonomist, auditor dhe mësim-dhënës universiteti, por ky i pandehur, dhe i pandehuri F. është konsulent i lirë.

Kushtet e tyre personale dhe familjare gjithashtu duhet të merren parasysh; në rastin e të pandehurit H. ai ka edhe ... fëmijë të vegjël (... vit e ... muaj dhe ...

vjeç) dhe gjithashtu F. është baba i ... fëmijëve (... dhe ... vjeç), të cilët kanë nevojë për një baba për t'i rritur ata. Fëmijët e të pandehurit Z. janë të rritur (... , ... , ... vjeç).

Qëllimi kryesor i sistemit penal është të parandalojë, të shmangë (ri)kryerjen e veprave penale dhe të edukojnë, të rehabilitojnë, dhe jo të ndëshkojë, *stricto sensu*, kryesit. Meqë gjykata beson se qëllimet kryesore të vendimit mund të arrihen edhe me dënim me kusht, gjykata do të shqiptojë dënime me kusht, në pajtim me nenin 52, paragrafi 2, të KPK-së, dhe dënimet nuk do të ekzekutohen nëse personat e dënuar nuk kryejnë ndonjë veprë tjetër penale për kohën e verifikimit. Gjykata cakton periudhën e verifikimit në 2 vjet për të tre të pandehurit.

Në bazë të neneve 52, paragrafi 3, dhe 59 të KPK-së, pezullimi përfshin edhe detyrimin e mosndryshimit të vendbanimit pa informuar shërbimin e sprovës.

Gjykata nuk zbaton edhe detyrimin e kompensimit, pasi neni 59.1.12 i KPK-së nuk lejon kompensimin për një subjekt të tretë (si zjarrfikës, një shtëpi për fëmijë të braktisur, etj.), vetëm për viktimën (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, buxheti i Kosovës) – pasi përfitimi pasuror (që të shpie në konceptin e “kthimit”) u vërtetua se ka ndodhur për kompaninë “E.” (jo për vetë të pandehurit) dhe vendimi civil që e dënon “E.” (në pronësi të H. B.) në shumën 45.000 euro plus interesin është bërë i formës së prerë.

Dënim(et) plotësues(e)

Në lidhje me një dënim plotësues për të pandehurin N.K. (dënimi i të cilit nuk është pezulluar), gjykata vendosi të mos caktojë dënimin plotësues të paraparë në nenin 62, paragrafi 2.1, lidhur me nenin 65 të KPK-së “*Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik*”.

Konfiskimi i objekteve

Nuk ka objekte të listuara në aktakuzë që të bëhen objekt konfiskimi.

Kërkesa pasurore juridike

Pasuria e kërkuar, kompensimi për dëmet, e paraqitur në Gjykatë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në 22 maj 2012 u bazua në lidhje me të "pandehurit që me veprimet e tyre i shkaktuan dëm MTI-së, kërkonte që gjykata të caktojë kontributin e secilit prej të pandehurve dhe në përputhje me këtë kontribut të caktojë nivelin e dëmit për t'u kompensuar. Megjithatë, në qoftë se nuk mund të vërtetohej dëmi konkret individual, atëherë të pandehurit duhet të mbahen si debitorë të përbashkët dhe të kompensojnë MTI-në në shumën 45.000 euro, në përgjegjësi të përbashkët".

Kjo kërkesë pasurore-juridike duhet të refuzohet pasi shuma në fjalë ishte objekt i një padie civile që është gjykuar tashmë, me vendim të formës së prerë.

Më 22 maj 2012 paditësi nuk mundi të injorojë se në lëndën numër 164/2008, me aktgjykim të datës 04/05/2011, Gjykata Supreme e Kosovës refuzoi si të pabazuar ankesën e të paditurës Kompania "E." dhe la në fuqi aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut të Prishtinës, lënda numër 272/2007, datë, 18/06/2008, në të cilën paditëse ishte edhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në Prishtinë, kundër të paditurës NNP "E." dhe gjykata vendosi në favor të paditëses dhe si pasojë e paditura "E." u dënua për t'i kthyer paditëses shumën 45.000,00 euro me interes vjetor 2,5%, duke filluar nga data 19/04/2007, deri në pagesën përfundimtare në afat prej 8 ditësh, nga dita që aktgjykimi do të bëhej i formës së prerë (04/05/2011); nëse nuk e bën këtë, do të kishte ekzekutim të detyrueshëm. Paditësja nuk mund të pretendojë në procedurën penale të njëjtën shumë që tashmë ka kërkuar në gjykatën civile dhe tashmë e gjykuar me aktgjykim të formës së prerë.

Shpenzimet e procedurës

Në bazë të nenit 450 të KPP-së, shpenzimet e procedurës do të paguhen nga të pandehurit të cilët u dënuan. Në bazë të nenit 450, paragrafi 2.6, shumat e planifikuara janë 150 euro për secilin nga të pandehurit, në vlerë të përgjithshme prej 600 eurosh.

Përfundimtare

Gjykata, sipas detyrës zyrtare, nuk sheh ndonjë nevojë për shpalljen e këtij aktgjykimi (dispozitivit) në shtyp, në radio apo televizion, neni 365, paragrafi 1.1.6, i KPPK-së, për të mbrojtur vlerat e Drejtësisë dhe Interesit Publik.

Deri në përmbylljen përfundimtare të procedurës, çdo ndryshim në adresën e çdo pjesëmarrësi duhet të raportohet në gjykatë, në bazë të nenit 368, paragrafi 3, të KPPK-së.

Procedohet në përputhje me procedurën e parashikuar në nenet 474, paragrafi 3, dhe 369, paragrafët 3 dhe 4, të KPPK-së.

Këshillë juridike: Në bazë të neneve 374, paragrafi 1.1, dhe 380, paragrafi 1, ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet brenda 15 ditëve nga dita që kopja e tij u dorëzohet palëve. Ankesa duhet t'i drejtohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Bërë në anglisht (gjuhë e autorizuar), në Prishtinë më 21 shtator 2015,

Kryetar i trupit gjykues

(Gjyqtari i EULEX-it Jorge Martins Ribeiro)